SHPETIMI NE SHQIPERI

NJE QINT PERQINT E HEBREJVE

NE SHQIPERI

TE SHPETUAR NGA HOLOKAUSTI

Përkthyu nga anglishtja

Mil Berisha

SHPETIMI NE SHQIPERI

NJE QINT PERQINT E HEBREJVE

NE SHQIPERI

TE SHPETUAR NGA HOLOKAUSTI

SHPËTIMI NË SHQIPËRI

Historia e patreguar e Fisnikëve Shqipëtar

të cilët i shpëtuan hebrejte

nga Holokausti

Shkruar nga

Harvey Sarner

Edhe para se të fillonte Lufta e Dytë Botërore Shqipëria ishte nje parajsë për hebrejtë të cilët përpiqeshin të shpëtonin nga kthetrat e nazistëve. Janë me mijëra ata që mundën të merrnin visa për të kaluar nëpër Shqipëri, ose edhe për të qëndruar, sipas dëshires. Hebrejtë gjëndeshin në Shqipëri që në fillim të erës së re, duke u shtuar në prurjet më të mëdha në shekulline XIX - të. Kur nazistët i kërkuan listat e hebrejve më 1943, qeveria shqiptare kundërshtoi t'i dorëzonte ato. Si përgjigje ndaj kësaj, populli shqiptar, musliman apo kristian pa dallim, iu dha strehe, bukë e mbrojtje dhe bëri që asnjë prej tyre të mos bëhej pre e Holokaustit. Deri vonë, Shqipëria, vendi i mbyllur i Ballkanit ndoqi një politikë izoluese, kështu që askush nuk mundi t'i bënte te njohura veprimet e fisnikëve shqiptarë. Ne vitin 1991, shumica e bashkësisë hebreje u vendos në Izrael. Atasollën me vete dokumente të cilat tregonin se si shqiptarët i kishin shpëtuar duke rrezikuar veten e tyre e që pikërisht ky akt i madh unik, njerzor duhej të gëzonte nderin që i takonte.

Harvey Sarner

SHPETIMI NE SHQIPERI

NJE QINT PERQINT E HEBREJVE

NE SHQIPERI

TE SHPETUAR NGA HOLOKAUSTI

Përktheu nga anglishtja

Mal Berisha

Botimi shqip i librit është bërë nën kujdesin e Lidhjes Qytetare Shqiptaro - Amerikane në Nju Jork dhe personalisht nga Presidenti i saj, ish Kongresmeni **Joe DioGuardi**

Shtypur në Shtëpinë Botuese KOHA, Tirane 1998.

Copyright C 1997 prej Brunswick Press. Gjithçka i takon autorit. Asnjë pjese e librit nuk mund të riprodhohet në asnjë formë të saj pa leje me shkrim nga botuesi.

Një libër xhepi i titulluar, "Hebrejtë e Shqipërisë" është publikuar në vitin 1992 prej të njejtit autor dhe botues, kështu që pjesë të tij janë përmbledhur në këtë botim.

Numri i kartes së katalogut te Bibliotekës së Kongresit është 96-08023

Shtypur në Shtetet e Bashkuara te Amerikës

Botimi i Parë

1997

Published by Brunswick Press

Po. Box. 2244 Cathedral City, CA 92235

Co-published by the Frosina Foundation

LIDHJA QYTETARE AMERIKANO - SHQIPTARE

Në tërë historinë e tyre të gjatë, shqiptarët e kanë dashur dhe inkurajuar paqen dhe bashkëpunimin midis popujve. Ata i kanë mirëpritur vizitorët e huaj ne brigjet e tyre duke shpalosur shpirtin e tyre miqësor. Kur refugjatet hebrej e

gjetën rrugën e shpëtimit nëpër Shqipëri, populli shqiptar iu dha atyre strehë dhe mbrojtje pa marrë parasyshë rrezikun që sillte ky veprim.

Gjate pushtimit fashist ne Shqipëri, sikundër edhe ne vendet e tjera te pushtuara gjatë Luftës së Dytë Botërore, autoritetet naziste e mbajtën nën vëzhgim të rreptë popullatën hebreje duke u përpjekur të rregjistronin secilin prej tyre qoftë vendas apo i ardhur. Hebrejtë në Shqipëri lëviznin sa në një qytet në një tjetër por më së shumti në Vlorë dhe Durrës për vetë rëndësinë strategjike që kishin këto qytete. Në një kohë kur nazistët i kërkonin hebrejte jo-shqiptar, shqiptaret pa marrë parasysh asnjë rrezik i ndihmuan ata fshehtas që të mos dorëzoheshin e më pas të dërgoheshin në kampet shfarosëse naziste.Në shtëpitë shqiptare ata gjetën bukë, strehë, mjete jetese e ngrohtësi familjare njerëzore.

Janë të shumta rastet kur familjet hebreje për t'i shpëtuar rrezikut kalonin nga një familje tek tjetra, nga një fshat në një tjetër dhe nga një qytet tek tjetri. Disa herë atyre iu siguruan pasaporta false nga mikëpritësit e tyre shqiptar. Ata provuan të veshnin edhe rrobet e fshatarëve shqiptarë te cilat ata vetë ua jepnin vetëm e vetëm për të mos i lëshuar në duart e nazistëve. Në këto përpjekje mbinjerëzore, shqiptarët jo rrallë u bënë pre e ndjekjeve, persekutimit e rrezikut për jetën e tyre.

Liga Civile Amerikano - Shqiptare u themelua në Janar të vitit 1989 për të shprehur vullnetin e 400.000 shqiptaro-amerikanëve për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe shqetësimin për gjendjen e shtatë milionë shqiptarëve të cilët jetojnë ndamas në atdheun e tyre Ballkanik, Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë Perëndimore, Serbinë Jugore, (Preshevë), Veriun e Greqisë (Çamëri) e në Mal të Zi.

Si antar i Dhomës së Përfaqësuesve nga viti 1985 deri më 1989 dhe si kryetar i Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane, që në atë kohë e kam ngritur alarmin në mënyrë të përsëritur rreth trajtimit brutal që Sllobodan Milosheviç i bën popullit shqiptar në Kosovë dhe në pjesë të tjera të Ballkanit të influencuara prej tij. Gjate shumë udhëtimesh në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri kam drejtuar delegacione kongresmenësh, aktivistësh të Drejtave të Njeriut si dhe gazetarësh, për të vënë në pah kushtet e tmerrshme nën të cilat shqiptarët kanë qenë të detyruar të jetonin - nën komunizëm në Shqipëri për pesëdhjetë vjet që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore dhe nën regjimin armiqësor sllav në ish - Jugosllavi.

Udhëtimin tim të parë në Shqipëri e kam bërë në qershor të vitit 1990 së bashku me kongresmenin Tom Lantosh, një hebre hungarez i shpëtuar nga Holokausti. Gjatë këtij udhëtimi na u dha mundësia që të shtinim në dorë një dosje e cila

përmbante dokumente mbi veprat heroike të shqiptarëve, deri atëherë të papublikuara, ku bëhej fjale për shpëtimin e hebrejve gjatë luftës së Dytë Botërore. Në të vërtetë, ishte vetë presidenti i atëhershëm komunist i cili e ndjente frikën e ndryshimeve të detyrueshme, ai që ia dorëzoj zotit Lantosh dosjen, me synim qe të fitonte simpatinë e tij. Më tej, mbas kërkimesh të pandërprera u arrit që Yad Vashemi të njihte kombin shqiptar për veprimet e tij unike si një komb fisnik i cili kishte ditur dhe guxuar të mbronte jo vetëm hebrejtë e vet por gjithashtu edhe te gjithë ata që i kishin ikur nazizmit nga Europa dhe ishin strehuar në Shqipëri. Ky liber dëshmon qartë se sa të shtrenjte e ka populli shqiptar lirine, jo vetëm për veten e tij por edhe për të tjerët. Vepra e fisnikëve shqipëtar bën që të krenohemi përpara botës së qytetëruar por edhe të kërkojmë prej saj që të mbajë të njëjtin qëndrim ndaj kërkesave tona të ligjshme humane e kombëtare.

Botimi i këtij libri është homazh ndaj virtytit shqiptar deri tani jo dhe aq të njohur. Në të njejtën kohë ai ka filluar te kete ndikim te madh tek njerezit qe e lexojne duke i sensibilizuar ndenjat e tyre ndaj nje kombi te tille.

Por qëllimi tjetër po kaq i madh është që tu tregojë shqiptarëve kudo në botë se kombet e forta mund të ngrihen edhe pas dymijë vjet përpjekjesh mbinjerëzore. Që të arrihet deri aty më së pari duhet kontributi i çdo individi të kombit, i harmonizuar me veprimet kolektive. Në këtë drejtim çdo shqiptari, kudo që ndodhet i bie barra të mendojë për të ardhmen e kombit tone.

Me rastin e botimit shqip të këtij libri dëshiroj të falenderoj të gjithë miqtë e mij të Lidhjes Qytetare Shqiptaro - Amerikane, shumë miq të mij hebrej në ShBA dhe në botë si dhe përkthyesin, mikun tim Mal Berisha, për dëshiren që shfaqi për ta sjellë tek shqipëfolesit këtë histori për të cilën çdo shqiptar duhet të ndjehet krenar.

Hon. Joseph DioGuardi

Lidhja Qytatare Shqiptaro - Amerikane

61 Central Ave

Ossining,NY10562

Tel: (914) 762-5530

KONGRESI I NJEQINTE E PESTE

KONGRESI I SHTETEVE TE BASHKUARA

KOMITETI I MARDHENJEVE NDERKOMBETARE

DHOMA E PERFAQESUESVE

Uashington D.C 20515

Shpëtimi në Shqipëri, shkruar nga Harvey Sarner, një filantrop amerikano - hebrej, është një pasqyrë historike shumë e veçantë ku tregohet se si shqiptarët e rrezikuan jetën e vet për t'i mbrojtur hebrejtë shqiptarë dhe ata të huaj gjatë kohës së Holokaustit.

Raportet se si danezët dhe bullgarët morën mbi vete rrezik të madh për t'i shpëtuar bashkëqytetaret e vet hebrej, janë të mirënjohura nëpërmjet të studimeve historike dhe dokumentare. Mbetet të ndriçohet e njëjta histori e guximit dhe humanizmit të shumë shqiptarëve gjatë ditëve të errta të Luftës së Dytë Botërore e cila është e panjohur për shumicën e amerikanëve, pasi asnjë kërkim ose studim i njëmendtë shkencor nuk është bërë mbi këtë temë.

Pra kjo është një histori që duhet të tregohet dhe një histori e tillë prej së cilës na nevoitet të mësojmë shumë e më shumë. Harvey Sarner i ka bërë një shërbim të madh kësaj çështje, duke i mbledhur episodet e historisë së sakrificës dhe humanizmit të popullit shqiptar për mbrojtjen e jetëve të hebrejve.

Ky libër përshkruan gjithashtu shumë shembuj, në të cilët shqiptarët demonstruan angazhimin e tyre ndaj paqës dhe drejtësise. Në fillim të kësaj dekade populli shqiptar i hoqi qafe prangat e komunizmit dhe përqafoi demokracinë. E megjithate për shkak të mosnjohjes së rrugëve që të çojnë në demokraci, ligjeve të ekonomisë së tregut të lirë, Shqipëria është ballafaquar përsëri me trazira politike, ekonomike dhe sociale te epokës post - komuniste.

Përtej kufijve të shtetit shqiptar jeton një popullatë e madhe, etnikisht shqiptare, ne Kosove dhe Maqedoni. Ndërsa këta shqipëtar flasin të njejtën gjuhë, kanë të njëjten kulturë, vlera dhe angazhime ndaj drejtësisë si dhe të afërmit e tyre që jetojnë brenda kufijve të Shqipërisë, ata janë ballafaquar me një situatë tjetër të ndryshme në tokat e tyre stërgjyshore.

Shqiptarve të Kosovës u janë mohuar edhe të drejtat më elementare. Autonomia që ata gëzonin më parë në ish - Jugosllavi, është kufizuar sistematikisht e më pas është shkatërruar nën një rregjim të ashpër nacionalist serb i cili ka ardhur duke u bërë gjithnjë e më agresiv gjatë dhjetë vjetëve të fundit. Shqiptarët të cilët kërkojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre themelore civile, u janë nënshtruar

arrestimeve sistematike, rrahjeve, torturave dhe, edhe më keq se kaq, kohëve të fundit janë bërë objekt i veprimeve të dhunshme ushtarake dhe spastrimit etnik prej autoriteteve serbe.

Shqiptarët në Maqedoninë fqinje janë të ballafaquar gjithashtu me diskriminimin. Përpjekjet për të hapur një universitet me një program mësimor në gjuhën shqipe dhe për të ngritur një flamur shqipëtar përkrah me atë maqedon në Gostivar, janë ndaluar me dhunë policore.

Eshtë një ironi tragjike që fëmijët, nipërit dhe mbesat e shqiptarëve të cilët i ndihmuan hebrejtë në Shqipëri që të shpëtonin gjatë Luftes së Dytë, tani ballafaqohen me diskriminim e dhunë në Kosove e Maqedoni. Eshtë e rëndësishme që të kuptohet se pikërisht e kaluara e shqiptarëve është një ndër arsyet që ne ju ftojme që të gjeni kohë për të lexuar librin "Shpëtimi në Shqipëri". Kjo është një histori prej së cilës mund të fitojë çdo njeri prej nesh. Në të njejten kohë ne duhet të angazhohemi për të parë se si fëmijët, nipërit dhe mbesat e atyre heronjëve trima, historia e të cilëve përshkruhet në këtë botim, na thërret që të mos bëhemi viktima të forcës së të keqes dhe shtypjes e cila në çdo kohë punon për të shtypur liritë njerzore.

Tom Lantosh Benjamin A. Gilman

Antar i Kongresit Antar i Kongresit

Kaliforni Nju Jork

Të përmendësh Holokaustin do të thotë të evokosh errësirën, imazhin e pashpresë. Edhe në ato kohëra të terrorit, tiranisë, torturës, vdekjes dhe pashpresës, gjëndej një dritë që regëtinte, një dritë që kurrsesi nuk donte të shuhej. Si një fëmije i Holokaustit - *një fëmije i fshehur* - unë i shpëtova makines vrasëse naziste, sepse dikush më ndihmoi që të mbetesha një dritë e ndezur.

A ishte një përson i vetëm, apo një grup i një lloji të veçantë njerëzish që u ndihmuan hebrejve? Për më të shumtët e njerëve ishte më lehtë tua kthenin krahet, të shikonin hallet e tyre dhe të mos përziheshin ne punë aq të rrezikshme të atyre kohëve të vështira.

Sidoqoftë ishin ata të paktë njerëz trima të cilët guxuan të ndihmonin hebrejtë, bile edhe kur vetë jetën e vet dhe të fëmijëve e vunë në rrezik. Shpirtra të tillë përbëjnë larminë e rracës njerëzore. Ata vinin prej të gjitha udhëve të jetës - puntorë fabrikash dhe fermash, mjekë dhe juristë, priftërinjë dhe murgesha. Ata vepruan here here individualisht, e here here si pjesë e grupeve të padukshme.Por pat raste kur ata vepruan si komb edhe pse për vete ishin të pushtuar nga nazizmi:

Shumë prej ketyre akteve të guximshme janë tashmë të njohura. Oskar Schinder dhe "lista" e tij e famshme në Gjermani; murgeshat në manastiret e Belgjikës e të Francës; Populli i Danimarkes i cili nën udhëheqjen e mbretit të vet me përpjekje të guximshme mundi t'i shpëtonte hebrejtë e vet përveç katërqintve që ishte e pamundur; Bullgaria dhe Finlanda të cilat kundërshtuan me vendosmëri kërkesat e nazistëve për dorëzimin e hebrejve.

Dhe tani le t'i kthehemi një historie ende të pa treguar.

Ajo përmban faktin e spikatur që populli shqiptar, shumica e të cilit përbëhet prej muslimanesh, e mbrojti dhe e ruajti të tërë popullsinë hebreje. Ky komb i vogël, jo vetëm që i mbrojti "hebrejtë e vet" por nuk lejoi asnjë hebre tjetër i cili fatmirsisht kishte arritur në këtë vend, të dorëzohej tek nazistet. Rrjedhoja e një përpjekje të ngjashme me atë të Davidit nuk mund të neglizhohet vetëm pse numri i hebrejve ne Shqipëri nuk i kalonte të njëmijët

Çdo jetë njeriu e shuar përmban historinë e një trashëgimie të jashtëzkonshme. Pa marrë parasyshë rreziqet me pasoja të pallogaritshme, shqiptaret i bënë ballë forcës kryqëzuese të nazistëve dhe me këtë ata i bëne vend vetes në histori si një komb midis kombeve fisnike.

Në mbarim të vitit 1944, Enver Hoxha e shpalli Shqipërine një shtet komunist dhe vet u kthye në një diktator absolut. Historia se si shpëtuan hebrejtë në Shqipëri ka qenë e varrosur për dekada të tëra për shkak të politikës së tejskajshme izolacioniste të udhëheqjes totalitare të Shqiperisë. Megjithatë, e drejta nuk humb kurrë. E kur është fjala për Holokaustin, kjo fjalë e urtë merr një vlerë të re: Përpjekjet heroike të shqiptarëve Fisnike duhet t'i behën të njohura njerëzimit.

Pa u zgjatur, historira si kjo tregojnë qartë se brenda vetvetes njerëzimi përmban raste nga më të ndryshmet. Rasti i Shqiperise përbën një model që mund të frymezojë luftën kundër fanatizmit të sëmure dhe shtypjes... të cilat fillojnë gjithmonë si pa u ndjerë, për të patur përfundime të tmerrshme. Kjo e riforcon besimin se njerëzimi nuk do ta kërkojë forcën tek e keqja por tek heronjtë e vet. Shqipëria përbën një shembull për këtë..

Abraham H. Foxman.

Drejtori Kombëtar

i Lidhjes se për Mbrojtjen e

Hebrejve

PERMBAJTJA

Joe DioGuardi, President i Lidhjes Qytetare Shqiptaro - Amerikane në Nju Jork III

Kongresmenët, Tom Lantosh (Kaliforni) dhe Benjamin Gilman, (Nju Jork).....VI

Lidhja e Anti - Defamacionit.....VIII

Harvey Sarner.....1

Hartë.....30

Bibliografi.....95

Fotografi.....97-105

****

Kapitulli i Parë

Shqipëria në luftë.....4

Greqia

Lufta civile

Kapitulli i dytë

Emigrimi.....8

Vala e Parë

Vala e Dytë - Nga Selaniku dhe Spanja.

Vala e Tretë - Nga Janina ne Vlore

Romaniotët

Vlora

Kapitulli i Tretë

Ambasadori Bernshtain dhe Mesia fallse.....16

Mesia fallse

Kapitulli i Katërt

Muslimanët shqiptar gjatë periudhes osmane.....20

Lëvizja për pavarsi

Sistemi i Miletit

Hebrejte në Ushtrinë Osmane

Korfzi

Kapitulli i Pestë.

Periudha midis luftrave.....26

Janina

Katër Vilajetet

Harta e Katër Vilajeteve

Kapitulli i gjashtë

Refugjatët hebrej.....32

Qeveria shqiptare

Mbështetja financiare dhe ndihma te tjera

Italia dhe pushtimi italian

Territoret e aneksuara

Kapitulli i shtatë

Gjermanët.....42

Kërkesat për listat e hebrejve

Bisedimet.

Kapitulli i tetë

Fisniket dhe Holokausti.....45

Historia e Mihal Lekatarit

Familjet Veseli dhe Mandili

Atif e Ganimet Toptani

Familja Nosi, Vasili dhe motra e tij Adelina

Beqir Qoqja

Metin, Azis dhe Shpresa Ruli - Ali Kuci

Familja Budo

Besim dhe Aishe Kadiu

Shyqyri Myrto

Fisnikë të tjerë jo-hebrej

Kapitulli i Nentë

Te mbijetuarit tregojnë historitë e tyre.....58

Johana Jutta Neumann

Tregimet e Dr. Ana Kohen

Irene Grunbaum

"Perse?"

Kodi moral i shqiptarëve

Kapitulli i Dhjetë

Pas Luftes se Dytë.....66

Hebrejtë pas luftes

Nën komunistët

Izraeli

Shteti ateist

Jeta e hebrejve para dhe pas periudhës ateiste

Varrimet

Rabinët

Synetet

Sinagoget

Martesat

Kosher

Festat

Gjuha hebreje

Shtëpite

Anti-semitizmi

Tregtia dhe profesionet

Asimilimi dhe shndrrimi në fe tjera

Emrat

Parate për të blerë tokë në Izrael

Emigracioni nga Shqipëria përpara vitit 1991

Kapitulli i Njëmbëdhjetë

Fisnikët midis kombeve.....84

Programi për fisnikët jo-hebrej.

Fisnikët jo-hebrej vizitojnë Izraelin

Eksodi i viti 1991

Emigracioni, 1991

Shqipëria sot.

.....

Ky liber i kushtohet

Kujtimit të Josef Jakoel

Një Mose
i Shekullit të XX - të
i cili iu priu bashkëatdhetarëve të tij drejt
Tokës së Premtuar

.....

Hyrje

Ky liber nuk është një histori e plotë e Shqipërise, bile as një histori e hebrejve në Shqipëri. Ajo që e ka nxitur shkrimin e tij ka të bëjë me tërheqjen e

vëmëndjes së atyre njerëzve të cilët nuk kanë dëgjuar për veprën e mrekullueshme që populli shqiptar bëri ndaj hebrejve, qofshin ata vendas apo të huaj për t'i mbrojtur nga Holokausti. Fakti që kjo histori e mrekullueshme nuk është rrëfyer deri më sot, lidhet drejtpërsëdrejti me izolimin e thellë që e shoqëroi Shqipërine, nën diktaturën komuniste që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore e deri ne fillim te viteve '90.

Shqipëria është i vetmi vend në Europën e pushtuar nga fashizmi, ku hebrejte nuk u bënë viktima të makinës vrastare naziste.(1) Për të kuptuar se si kanë shpëtuar hebrejtë në Shqipëri, është e nevojshme të dihet se si shkuan dhe kur shkuan ata në atë vend.

Përpara se të merresha me "Fisnikët" me kombësi jo-hebreje,(2) e vetmja dijeni që kam patur për Shqipërine ka qenë një shënim i bërë në pasaportën time ku ajo përcaktohej si një ndër katër vëndet ku pasaporta ime ishte e pavlefshme. Gjithashtu kisha mësuar se Shqipëria ishte vendi më i varfer i Europës dhe vendi i vetëm me shumicë muslimane në atë kontinent. Muslimanet përbëjne rreth 70% të popullsisë dhe i mbrojtën hebrejte jo me pak se ç'bënë kristianët.

Unë kisha mësuar gjithashtu faktin befasues se Shqipëria ishte nje vend që ishte pushtuar nga fashistët por që e shmangu persekutimin gjerman ndaj hebrejve duke mbajtur rekordin 100% të shpëtimit të tyre. Po ashtu isha befasuar nga fakti se në fundin e Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte i vetmi vend që kishte më shume hebrej se sa kishte patur në fillim të saj.

Një hebre amerikan, Herman Bernshtain, kur shërbente si Ambasadori i SHBA - ve në Shqipëri, në vitet '30 e ka vlerësuar popullin shqiptar si populli më pak anti - semitist në bote.

1

.....

Arsyeja e dytë që e ka nxitur shkrimin e këtij libri është dëshira për të vënë në pah përpjekjet heroike të Josef Jakoelit (3) dhe vajzës së tij Feliçita të cilët realizuan emigrimin e thuajse të tërë hebrejve nga Shqipëria në Izrael, në vitin 1991. Josef Jakoel jetoi mjaft gjatë sa të shihte eksodin për në Izrael dhe i kaloi muajt e fundit të jetës së tij në Eretz Izrael, toka e Izraelit. Ai ishte me të vërtete një Mose që i drejtoi njerëzit drejt tokës së tyre të premtuar.

Që nga viti 1967 deri në fund të vitit 1990, Shqipëria ishte një shtet ateist dhe një shoqëri e mbyllur, në të vërtetë aq e mbyllur sa që vlerësohej si një krim po të lexoje literaturë të huaj dhe aq ateist sa njeriu nuk mund t'i vinte emër fetar ose biblik fëmijës së tij. Ndryshimet që bëri Shqipëria duke kaluar nga një vend i mbyllur dhe shoqëri ateiste në një vend që po shkonte drejt demokracisë dhe tregut të lire u bënë në të njëjten kohë me emigracionin e hebrejve drejt Izraelit.

Jakoel i karakterizon hebrejtë shqipëtar si pasardhës të "romaniotëve", trashëgimtar të një kulturë të lashtë hebreje. Shumë pak shkruhet në Enciklopedinë Hebreje rreth romaniotëve, bile sipas Jakoelit edhe ato që shkruhen nuk i afrohen aq shumë të vërtetës. Romaniotët dallohen nga zakonet, por nuk ka asnjë dyshim se ata janë hebrej.

Ç'është e vërteta, shpesh kemi të bëjmë me të dhëna kontradiktore. Me dëshirën e mirë për t'i çuar ato drejt një minimumi të mundshëm, le të kthehemi tek qëllimi ynë kryesor: Çfare ka ndodhur me hebrejtë në Shqipëri dhe sa ka qenë numri i tyre ndër kohra?

Harvey Sarner

Palm, Springs, California.

.....

Shënime:

1.- Familja hebreje Ardet është vrarë prej nazistëve pasi ishin arrestuar si familje partizane e jo si hebreje.

2.- "Fisnikë jo hebrej" quhen ata persona të cilit kanë rrezikuar jetën e tyre për të strehuar hebrejtë gjatë kohës së Holokaustit.

3.- Josef Jakoel është lindur në Vlorë në vitin 1922. Eshtë arsimuar në Shkollen Teknike Tregtare Italiane dhe ka kryer Universitetin Shtetëror të Tiranës. Dhjetë vitet e fundit të jetës ai punoi si lektor ekonomie në Institutin e Lartë Bujqësor në Kamëz. Pjesa më e madhe e këtij libri është shkruar në bazë të letrave, shënimeve dhe bisedave me të.

.....

Kapitulli i Parë

Shqipëria në Luftë

Me 7 prill 1939, Shqipëria u sulmua prej forcave të ushtrise italiane dhe një javë më vonë i gjithe vendi u shkel prej ushtarëve italianë. Italianët i zunë portet shqiptare pa hasur në ndonjë rezistencë të madhe. Mbreti italian e uzurpoi kurorën mbretërore shqiptare duke ia bashkëngjitur atë Perandorisë së tij.

Pushtimi i Shqipërise nuk ishte pa rrezik për italianët. Natyra malore e vendit dhe mundësia e armatosjes së popullsisë nga ana e mbretit Zog, paraqiste një rrezik për luftë të gjatë guerrilase.

Mbreti Zog dhe shumica e oborrtarëve të tij ikën në fillim në Greqi dhe më pas në Angli. Ai ishte i pasuksesshëm në përpjekjet e tij për të formuar një qeveri në mërgim si ato që u krijuan prej qeverive të tjera të vendeve të pushtuara.

Greqia

Për italianët, Shqipëria ishte rruga për në Greqi, një rrugë në të vërtetë e vështire. Me 28 Tetor 1940, italianët pasi kishin pushtuar Shqipërinë, e kaluan kufirin greko - shqiptar dhe i ranë Greqise. Grekët i mposhtën italianët brenda jo më shumë se dhjetë ditëve. Që prej 22 nëntorit, në Greqi nuk gjëndej më asnjë këmbë italiani.

.....

Grekët kaluan në ofensivë dhe kapen njërën prej bazave detare italiane si dhe mbajtën pikën kyç, Korçën, derisa gjermanët hynë në luftë në Prill te vitit 1941. Pushtimi gjerman shkaktoi tërheqjen e forcave greke nga Shqipëria.

Asnjëra palë nuk ishte e qartë rreth ushtrisë shqiptare. Grekët kishin të dhëna se 3.000 shqiptarë të armatosur luftonin kundër italianëve por megjithatë nuk bashkëpunonin me ta. Aty nga viti 1942, partizanët shqipëtar e rriten

veprimtarinë e tyre dhe në fund të po atij viti, pjesë të vendit kishin dale nga kontrolli italian.

Nuk mund të mohohet fakti që edhe në Shqipëri, si në shumë vende te tjera europiane, kishte kuislingë, se kishte po ashtu një parti fashiste e cila bashkëpunonte me ta. Kolaboracionistët ishin vetëm një grusht ndërsa partizanët numëroheshin me mijëra. Nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se partizanet iu kanë kushtuar ndonjë vemendje të veçantë hebrejve.

Në Shqipëri kishte plot njerëz të cilët e admironin kulturen dhe arsimin gjerman por që nuk e lidhnin atë me nazizmin. Perkundrazi, ata ushqenin urrejtje të thellë ndaj tij. Kishte familje që i kishin dërguar fëmijet që përpara luftës në Gjermani apo Austri për t'i arsimuar por ata nuk kishin lidhje me ideologjinë naziste dhe as me pushtuesit nazistë.

Në prag të pushtimit numëroheshin 33 familje të njohura hebreje shqiptare. Pjesa më e madhe e tyre (15 familje) jetonin në Vlorë. Pjesa tjetër gjëndej e shpërndarë në të gjithë vendin.

Ka patur gjithashtu një numër të panjohur hebrejsh të huaj, shumica e të cilëve kalonte tranzit. Ky grup i dytë ndryshonte numerikisht nga dita në ditë por mbetej gjithnjë me tre shifra.

.....

Hebrejtë nuk ishin të zgjedhshëm për t'u bërë anëtar të partisë fashiste, dhe as që mund të thuhet në se ndonjëri do t'i ishte bashkuar asaj edhe në se do të ftohej. Hebrejtë nuk pranoheshin të shërbenin në ushtrinë shqiptare gjatë atyre viteve.

Hebrejtë shqiptarë shërbyen më së shumti përkrah shqiptarëve në luftën partizane. Pepe Biro Kantos doli partizan dhe qëndroi në ushtrinë shqiptare edhe pas luftës duke marrë edhe grada të larta. Dario Zhak Artiti, David Kohen, Ruben Zhak, Josef Bivas gjithashtu dolën partizan.

Në gusht të vitit 1943, aleatet po përgatitnin pushtimin e Shqipërise në bazë të një plani të bërë përpara dhe gjatë pushtimit italian. Situata ndryshoi me shpejtësi me kapitullimin e Italise. Ushtarët e mbetur italianë u ndanë pjesë, pjesë: Disa kaluan në anën e partizanëve shqiptarë ndërsa pala tjetër u rreshtua përkrah gjermanëve.

Gjermanët arritën në Shtator, 1943. Me të arritur ata zevendësuan qeverinë e mëparshme me një rregjencë të përbëre prej katër vetësh të drejtuar nga Mehdi Frashëri, Kryeminister.

Rregjenca veproi në përputhje më një marrëveshje me nazistët gjermanë e cila lejonte lëvizjen e këtyre të fundit në tërë territorin e vendit. Si shpërblim ndaj kësaj, gjermanët nuk do të ndërhynin në punët e brendshme të qeverisë. Kjo fraze "punët e brendshme" mori një rëndësi të posaçme për fatin e hebrejve, kur gjermanët i kërkuan regjences që tu dorëzonte listat e tyre në tërë Shqipërinë.

Marrëveshja nuk u përfill nga partizanët. Ata ndërmorën aksione kundër gjermanëve të cilat disa herë patën kundërveprime më pasoja të tmerrshme. Në korrik të vitit 1943, partizanët shqipëtar goditën një autokolonë gjermane duke lënë të vrarë 60 ushtarë gjerman. Gjermanët u hakmoren duke djegur thuajse tërësisht një fshat e duke vrarë 107 veta, midis tyre edhe gra e fëmijë.

.....

Më 17 Nëntor 1944, Tirana i çirua. Me 28 Nëntor u krye çlirimi i plotë nga gjermanët dhe vendi ra në duart e komunistëve.

Lufta civile

Ekzistonin filozofi të ndryshme sociale dhe politike midis antifashistëve të cilat e mjegullonin pamjen edhe ashtu komplekse të Shqipërisë. Ka dy gjëra të cilat duhen vënë në dukje: E para, lufta ndaj kolaboracionistëve që bënë partizanët dhe e dyta, ardhja në fuqi e komunistëve, si forcë politike. Periudha e demokracisë, mbretërise dhe okupacionit kishin marrë fund. Qeveria regjente fashiste u zevendësua me një diktaturë vendase e cila zgjati pothuajse një gjysëm shekulli. Në horizont dukej një luftë midis tre forcave politike. Ushtria Nacional Çlirimtare e njohur si komuniste, Balli Kombëtar, dhe Partia e Legalitetit. E para prej këtyre të triave kishte pozita shumë më të forta.

Në një kohë kur te tria këto forca, si komunistet, ashtu edhe nacionalistet dhe rojalistet ishin përfshirë ne luftën kundër pushtuesve, të parët kishin filluar të mendonin për pas-luftën. Komunistët kishin një avantazh të madh: gëzonin mbështetjen e Titos dhe të partizanëve Jugosllave.

Komunistët vendosën që t'i likujdonin nacionalistët ndaj vendi u ballfaqua me një vit luftë midis komunistëve dhe ballistëve derisa këta të fundit pushuan së

qeni një forcë e rrezikshme për komunistët . Mbasi i qëruan hesapet me ballistët në jug, komunistët iu kthyen monarkistëve duke i eleminuar ata qoftë si forcë politike ashtu edhe ushtarake brenda disa javëve.

.....

Kapitulli i dytë

Emigracioni

Vala e parë

Legjenda thotë se 2.000 vjet më parë një anije e nisur drejt Romës me një ngarkesë plot e përplot me skllav- hebrej nga Palestina e kishte ndryshuar drejtimin, e detyruar nga stuhia e detit, duke i lëshuar ata në brigjet e Ilirisë. Romakët nuk bënë përpjekje për ti kapur skllavet hebrej të ikur dhe menduan se ata do të zhdukeshin sa prej kushteve natyrore aq edhe prej kafshëve të egra. Në të vërtete romakët e gjetën më të udhës të merrnin një garniturë tjetër skllavësh hebrej se sa të përpiqeshin t'i kapnin ata që tashmë e kishin marrë arratinë.

Sipas legjendës, hebrejtë nuk u zhduken prej bishave siç menduan romaket. Vendasit (1) megjithëse ishin përfshirë në luftra kundër romakëve iu ndihmuan të sapoardhurve. Kjo mendohet të këtë ndodhur në Iliri, një vend që nuk gjëndet në hartën moderne. Iliria është emri i vjetër i Shqipërise. Në se ky emër tingëllon si i njohur, kjo i atribuohet Shekspirit i cili e përmend Ilirinë si vendin e anijeve të mbytura në dy prej veprave të tij.

Enciklopedia Hebraike (2) nuk e përmend legjendën e anijes së humbur, bile nuk i përmend as romaniotët si pasardhës të "Valës së Parë" Me përjashtim të kësaj legjende, asnjë fakt tjetër nuk gjëndet për të lidhur "Romën" me "Romaniotet". Kjo kërkon që të gjëndet në se emri rrjedh prej legjendës apo legjenda prej emrit.

Nuk dihet numri i hebrejve në atë zonë gjatë periudhës së herëshme por kurrsesi nuk mund të mohohet fakti që ata gjëndeshin atje, sidomos po t'i referohemi historianit hebrejo - romak, Flavius Josefus. Janë disa fshatra në Shqipëri të cilat në kohët antike kanë patur vetëm popullsi hebreje dhe disa që kishin emra hebrej si bje fjala Palasa - Palestina, ose Orikum - Jericho.

.....

Arkeologët kanë gjetur mbeturina të një sinagoge në Dardani, një port antik ilir. Ata mendojnë se ato gërmadha i përkasin shekujve të parë dhe të dytë të eres se re.

Në shekullin e katërt, Shqipëria u bë pjesë e Perandorisë Bizantine. Në Shqipëri, sistemi feudal zgjati deri në kohën e pushtimit otoman në shekullin e XV - të.

Vala e Dytë - Nga Selaniku dhe Spanja.

Hebrejtë romaniotë erdhën në Shqipëri nga Selaniku në fund të shek. të XV - të, të pasuar nga një grup tjetër nga Hungaria.

Enciklopedia Universale Hebreje thotë se në mesjetën e hershme hebrejtë erdhën në Shqipëri nga Selaniku. Ata u përzune pas "Mesjetës se hershme" çka do të thotë se hebrejtë e ardhur në Shqipëri nga Selaniku nuk kishin të bënin me inkuizicionin spanjoll. Këta janë romaniotët për të cilët Josef Jakoel thotë se arritën në Shqipëri nga Greqia veriore. (Shih romaniotet)

Ka të dhëna se ka patur hebrej në qytetin port të Durrësit qysh në mesjetën e hershme. "Një tregtar hebre" që shiste krypë përmendet qysh në gushtin e vitit 1319. Ka gjithashtu dokumente që më 24 Mars të vitit 1281, veneciani Nikolai Martini, bënte tregti me dy hebrej nga Durrësi, Leone dhe Caro Calis. Një tjetër dokument tregon se që në gusht të vitit 1366, një hebre nga Durrësi i shiste krypë një tregtari nga Raguza.(3)

Emigrimi më i përmendur nga Spanja ndodhi në fund të shekullit të XV - të, gjatë kohës së inkuizicionit spanjoll. Kjo konsiderohet Vala e Dytë. Një numër i madh hebrejsh, duke i ikur inkuizicionit shkoi drejt lindjes respektivisht drejt territoresh nën sundimin e Perandorisë Osmane.

Në kohën e inkuizicionit spanjoll, sulltani turk i ftoi hebrejtë që të shkonin dhe të jetonin nën sundimin e tij. Ndoshta sulltani e bëri këtë nga dhëmshuria që

ndjeu për hebrejtë si viktima të Spanjës katolike, të cilët i ishin nënshtruar te njëjtit persekucion si dhe muslimanët.

9

.....

Hebrejtë të cilët u zhvendosën nga Spanja e që njihen si "sefardike" sollën me vete gjuhen Ladino, një formë e alternuar e cila vazhdon të flitet edhe sot tek hebrejt e Turqisë.

Sulltani e kuptoi se hebrejtë e Spanjës ishin mbartës të një kulture dhe eksperience tregtare të cilën ai do të mund ta shfrytëzonte për interesat e tij. Osmanëve iu kishte bërë shumë përshtypje shkalla e lartë e arsimimit të hebrejve, prandaj edhe i pritën e i mbajtën edhe më mirë se romaniotët të cilët kishin lindur në trojet e Perandorisë.

Hebrejtë nga Spanja në fillim u vendosën në Vlore ku ndërtuan një sinagogë dhe varrezat e tyre. Pastaj ata u degëzuan, një palë drejt Beratit dhe një palë drejt Elbasanit duke e shtrirë qëndrimin e tyre ne më se 200 vjet. Në atë kohë Vlora ishte një qytet me 4.000 banorë, më shumë se gjysma prej të cilëve ishin sefardikë nga Spanja. Në Berat gjëndeshin 25 familje, shumica e të cilave merrej me tregti. Në fund të shek. të XVI - të, hebrejtë u larguan nga Vlora për arsye të panjohura për tu kthyer përsëri vetëm në mesin e shek. të XIX - të.

Kur mbërrinë sefardikët në Shqipëri, aty gjëndeshin hebrej nga ata të cilët u shkonin gjurmëve të origjinës së tyre deri në shkollat antike të Palestinës. Këta hebrej u perzien me të sapoardhurit nga Spanja, por kishte përçarje midis tyre për shkak të pretendimeve të sefardikëve për superioritet kulturor ndaj hebrejve vendas.

Në qytetin e Selanikut, hebrejtë vendas u absorbuan prej sefardikëve. Në Janinë dhe disa qytete të tjera të Shqipërise së athershme, e cila brenda Perandorise Osmane përmblidhte tërë trojet etnike, sefardikët ose u absorbuan prej romaniotëve greqisht-folës ose u zhvendosën më në lindje.

Sefardikët në Shqipëri u zhdukën me kohe. Jakoel thotë: "Ne e dimë që ata shkuan diku, por nuk e dimë se kur dhe ku. Ç'është e vërteta nuk jemi te sigurtë se kur arritën dhe as kur u larguan por për një gjë jemi krejt të sigurtë: ata ishin ketu" Ka të dhëna të sigurta se këtu ka patur hebrej. Në një fshat musliman vendasit thonë se ata dikur ishin hebrej dhe të gjithë banorët vendas kishin

emra hebrej. Ka familje të njohura shqiptare të cilat thonë se dikur kanë qenë hebrej.

10

.....

Hebrejtë që jetuan në Shqipëri kaluan shumë vite të mira por jo të gjithë patën të njëjtin fat. Për shembull gjatë Luftës Turko - Veneciane më 1685, hebrejtë u detyruan të linin Vlorën për tu vendosur në Berat.

Një periudhë e vështirë në historinë e Shqipërise pasoi që nga viti 1788 e deri më 1822, periudhë gjatë së cilës hebrejtë hoqën sa nga sulltani aq edhe nga Ali Pashaj. Vitet më të vështira ishin ato të lëvizjes për pavarsi dhe revolucionit grek, kohë gjatë së cilës ata u barazuan me muslimanet dhe u akuzuan si besnikë te Perandorisë Osmane.

Vala e Tretë - Nga Janina në Vlorë

Në përgjithësi pak dihet për hebrejtë gjatë shekullit të XVIII - të dhe gjysmës së parë të shek. të XIX - të, periudhë gjatë së cilës jo shumë prej tyre jetonin në Shqipëri. Vala e Tretë e rivendosi praninë e tyre në atë vend.

Vala e Tretë ishin "Romaniotët" të cilët në fillim arritën në Vlorë në vitin 1850. Ata erdhën nga Janina dhe Preveza që të dya tani qytete nën Greqinë. Në vitin 1850, Janina dhe Vlora ishin në të njëjtin territor të Shqipërise Etnike, sigurisht nën Perandorinë Osmane, (deri me 1878) prandaj kishte një lëvizje të lirë të njerëzve nga njëri qytet tek tjetri. Kolonia filloi me burra të cilët erdhën pa familjet e tyre, por kishte edhe përjashtime. I pari doktor që i sherbeu bashkësisë hebreje në Vlorë ishte Solomon Menahem Jamtov, i cili e mori edhe gruan me vete më 1850.

Kur, me kohë numri i të ardhurve hebrej po rritej dhe kur ata filluan të prosperonin, burrat e martuar i morën pranë vehtes familjet ndërsa ata të pamartuarit u kthyen në Janine që të martoheshin. Në atë kohe Janina kishte bashkësine më të madhe hebreje - romaniote.

Shumica e romaniotëve të cilët emigruan për në Shqipëri, gjatë gjysmës së dytë të shek. të XIX - të u vendosën në Vlorë. Kur i pari hebre erdhi në Vlorë, aty gjeti një bashkësi të vogël e të mbyllur ku sejcili prej tyre e njihte tjetrin.

11

.....

Njëri prej të parëve që u zhvendos prej Janinës për në Vlorë ishte gjyshi i Josef Jakoelit. Menjëherë hebrejtë u përhapën nga Vlora në qendra të tjera si Delvina dhe Gjirokastra. Për një farë kohe, 150 prej tyre gjendeshin në një qyteze në jug të Vlorës.

Bashkësia hebreje në ishullin e Korfuzit kishte filluar të formohej prej të ardhurve nga Venediku në shek. e XVI - të, ndonëse ka të dhëna që thonë se jeta hebreje ka filluar aty që në shek. i IX - të. Ata flisnin një dialekt venecian të italishtes dhe i kishin të kufizuara mardhënjet me bashkësite e tjera hebreje. Në Vlorë shumica e tyre flisnin shqip dhe greqisht.

Nga fundi i dhekullit të XIX - të, lidhjet midis Janinës dhe komunitetit romaniot në Shqipëri ishin të forta por jo aq të forta sa kishin qenë. Në të njejten kohe, lidhjet midis shqiptarëve romaniotë dhe ishullit të Korfuzit u bënë edhe më të forta. Për këtë mjafton që të shohësh hartën dhe të kuptosh arsyen se përse: Korfuzi ishte shumë më afër krahasuar me Janinen.

Hebrejtë e Shqipërise i ruajtën kontaktet me ata të Janinës e të Korfuzit deri në Luftën e Dytë Botërore. Shumica prej tyre kishin të afërm ndaj gjenin mbështetje tek ta siç ishte të derguarit hërë pas here i një rabini, kantori ose xherrahu. Fatkeqësisht, bashkësia hebreje e Korfuzit u zhduk gjatë Holokaustit dhe vetem pak familje arritën që të mbijetojnë në Janine.

Vala e Tretë ishte e fundit, ndonëse më 1894, një grup hebrejsh rusë e vizitoi Shqipërine me qëllim që të vendoseshin aty.(4) Shqiptarët nuk kundërshtuan dhe u ofruan atyre që të vendoseshin në bregdet "pasi pjesë të brendshme të vendit ende manifestonin shënja të mospajtimit racor ndaj të huajve." Tridhjetë deri në dyzet familje ishin të mirëpritura. Asnjë dokument nuk gjëndet që të tregojë se çfare u bë më tej. Ky kontigjent ndoshta do të përbënte Valën e Katërt.

Ka patur edhe njëfarë hamendje tjetër për një valë tjetër hebrejsh të ardhur në Shqipëri, megjithëse nuk ka ndonjë të dhënë që ta vërtetojë këtë.

12

.....

Mbreti Zog, kur ishte në mërgim në Britaninë e Madhe, gjatë Luftës së Dytë Botërore, iu propozoi udhëheqësve hebrej britanikë një plan për vendosjen e 50.000 familjeve hebreje në vendin e tij. Ai e përshkroi Shqipërine si një vend të pasur me njerëz të varfër por që kishte mundësi që të mbante lehtësisht një popullsi pesë milionshe. Ai premtoi t'i jepte çdo familje hebreje një fermë në tokat - pronë shtetërore - në brigjet e detit.

Bordi i deputetëve britanikë, organizata që përfaqësonte hebrejtë britanikë, e mori këtë propozim mjaft seriozisht. Ata morën kontakt me zyrtarët e Forein Ofisit për të parë se çfarë mendonin ata rreth kësaj çështje. Por Forein Ofisi nuk i dha ndonjë rëndësi kesaj pune pasi nuk besonte se monarkia do te rivendosej në Shqiperi pas luftes. Kjo çështje nuk u diskutua më. Vet mbreti vdiq në mërgim.(5)

Romaniotet

Po t'i referohemi Enciklopedisë Hebreje, termi "romaniot" ka të bëjë me hebrejtë me origjinë nga Perandoria e Bizantit. Ajo ka parasyshë vetëm hebrejtë e Janinës, Kastorit dhe Chalcis, të gjitha këto krahina në Greqi, duke i injoruar romaniotët shqiptarë të cilët ishin grupi më i madh në Europë deri kur emigruan në Izrael në vitin 1991

Romaniotët nuk janë as askenazë, (folës të hebraishtes) as sefardikë (folës të ladinos). Hebrejtë e Shqipërisë janë "hebrej romaniotë greqishtfolës" megjithëse në vitet e fundit ata do të ishte më mirë po të përshkruheshin si "hebrej shqipfolës". Jakoel thoshte se shumë prej hebrejve që shkuan në Izrael as që e dinin që ishin romaniotë. Kjo vinte për shkak të mungesës së arsimit hebre në dekadat e kaluara. Shumë syresh nuk kishin dijeni as për historinë e kombit dhe as të paraardhësve të tyre.

Romaniotët këmbëngulin se nuk janë pasardhësit e sefardikëve të cilët erdhen prej Spanjës. Ata pretendojnë se janë pasardhës të hebrejve të cilët jetonin në Greqinë Veriore qysh në kohën e shkatërrimit të Tempullit të Dytë, në shekullin e parë.

.....

Enciklopedia Hebreje (6) i përshkruan romaniotët si trashgimtarë të "Valës së Parë". Romaniotët janë krenar për historinë e tyre antike.

Për një periudhë të shkurtër, sefardikët dhe romaniotët shkonin shumë mirë me njëri tjetrin por ata u përçanë ndoshta për shkak se romaniotët ishin më strikt në respektimin e rregullave fetare. Hebrejtë nga Spanja u therrisnin romaniotëve "Grego" emër i cili në spanjisht mund të kuptohet si grek, term i cili kishte edhe doza përçmuese. Në të vërtetë secili grup besonte se ishte superior ndaj tjetrit.

Vlora

Nuk ishte arritja e romaniotëve që bëri që hebrejtë të identifikoheshin për herë të parë në Vlorë. Në vitin 1507, në Vlore kishte 97 familje të cilat arritën të bëheshin 609 vatra familjare me 1520 frymë; Shumica e tyre ishin refugjatë nga Spanja të ardhur gjatë "Valës se Dytë". Hebrejt e Vlorës u vranë gjatë revoltave kundër osmanëve të shekullit të XVI - të. Ata që mbetën, ikën nga bregdeti drejt qytetit të Beratit në periudhën e Luftës Turko-Veneciane në shekullin e XVII - të.

Qyteti i Vlorës ka qenë gjithmonë një port i rëndësishëm, pra edhe në kohët kur ai kishte një popullsi të madhe hebreje. Pleqtë përmendin një sinagoge që funksiononte deri në vitin 1914, kohë kur italianët e kthyen në depo armësh. Sot asaj nuk i gjënden as gjurmet. Çështja ishte se italianët të cilët pushtuan pjesë të Shqiperise gjatë Luftës së Parë Botërore, e dogjën sinagogën si dhe ndërtesa të tjera për të zgjeruar rrugët për t'i bërë të përshtashme për lëvizjen e mjeteve të tyre ushtarake.

Eshte tepër vonë për të gjetur varreza hebrejsh në Vlorë. Ato janë shkatërruar dhe mbi trollin e tyre është ngritur një banesë private. Eshtë gërmuar në një truall të lirë dhe janë gjetur shënjat e një varreze hebreje. Aty është gjetur nje gurë varri, një yll i gdhendur i Davidit, emri i Saba Matitias dhe data e vdekjes: 5 Dhjetor 1901.

.....

Në atë kohë nuk kishte jetë të organizuar të hebrejve në Vlorë, prandaj edhe shtëpia e J. Matatias u përdor si vend për grumbullimet në raste festash. Në vitin 1990, në Vlorë kishte 60 hebrej. Sipas Z. Matatia, 100 vjet më parë aty ka

pasur nje popullatë të konsiderueshme hebreje e cila thuhet se e la qytetin brenda një dite.

Babai i zotit Matatia, Mateo Matatia, ndoshta ishte hebrej me i dalluar në Vlorë, antar i këshillit të qytetit dhe tregtar.

Ngulimi i parë modern i hebrejve u bë në Vlorë por qëndra e jetës së tyre u zhvendos në Tirane, kryeqyteti dhe qyteti më i madh i vendit. Jakoel lëvizi gjithashtu si shumë të tjerë në vitin 1950, në kërkim të mundësive më të mëdha, përfshire këtu edhe atë për të vijuar studimet në universitet.

Shënime:

1.- Shqiptarët e konsiderojnë veten pasaardhës të popullit ilir të cilët u vendosën këtu që në shek. e XII - të p.e.r. Gjuha e tyre është indoeuropiane.

2.- Vëllimi, 14, fq, 231.

3.- I lindur në Siçili.

4.- Kronike hebreje, 9 Mars, 1894, fq,9.

5.- UKPROFO, 371/38.

6.- Vëllimi, 14, fq.231

.....

Kapitulli i Tretë

Ambasadori Herman Bernshtain

dhe Mesia fallse

Në vitin 1930, një hebre ishte Ambasadori i ShBA - ve në Shqipëri. Ambasadori Bernshtain u interesua për historinë e bashkëkombasve të tij dhe bëri kërkime për të gjetur gjurmë sa më të herëshme të jetës së tyre. Ai ka qenë veçanërisht i interesuar për të gjetur informacion rreth Sabattai Zvi ose Mesia fallse. Ai e dinte se të dhënat më të hershme tregonin se Zvi kishte qenë në qytetin e Ulqinit por ai nuk arrinte të gjente varrin dhe as gjurmë të jetës hebreje në atë qytet.

Ambasadori Bernshtain arriti të zbulonte gjurmët e një bashkësie të gjërë hebreje në Shqipëri gjatë shekujve të XV - të dhe XVI - të. Ai citon nga nje dokument gjerman i botuar më 1611, "...shumë prej këtyre vendeve janë të populluara prej hebrejsh të cilët shkuan në Shqipëri nga Ankona, Itali, gjatë periudhës së Papa Pavlit të IV - rt i cili e intensifikoi inkuizicionin".

Ai shkruante se Patriarku i Kishës ortodokse i kishte thënë se në një vend të Elbasanit, i njohur edhe sot si "Lagja e Çifutëve" mund të shihet një Yll i Davidit, në pjesën e sipërme të një ndërtese. Ky yll më vonë u hoq prej asaj ndërtese dhe copa prej tij u vendosen në një muzeum të vogël në Elbasan ku mund të shihen edhe sot.

Ambasadori i drejtoi kërkimet e tij në arkivat e Elbasanit ku gjeti një protokoll të një gjykate turke (1730) e cila gjykonte tregtarë hebrej per shkelje të ligjeve. (1)

Bernshtain paralajmëroi se Shqipëria mund të afronte së shpejti azil për hebrej të zhvendosur të cilët i gjenin dyert e mbyllura kudo tjeter. (2) Ky parashikim eshte bërë me 1936.(3)

Në mes të shekullit të XVII - të, një falltar i lindur në Izmir, i njohur me emrin Sabattai Zvi (4) e shpalli veten si një Mesi dhe bindi kështu mijëra hebrej që të shisnin gjërat që kishin dhe të shkonin pas tij drejt Tokës së Premtuar.(5)

Misticizmi hebre do të dukej shumë i largët për skenën shqiptare po të mos ishin syrgjynimet që iu bënë atij pikërisht në Shqipëri. Zvi iu mburr sulltanit se armata e pasonjësve të tij do të mund të pushtonte edhe vetë Stambollin.

Perandoria Osmane ishte në pikun e vet kur sulltani fillimisht e arrestoi Zvinë duke e akuzuar për organizim trazirash. Sulltani i ofroi Zvise të zgjidhte midis vdekjes dhe shndrrimit në islam. Zvi zgjodhi të dytën.

Kur u shndrrua ne islam, Nathani i Gazës, një udhëtar i famshëm hebre i asaj kohe, u shpreh: "Ishte një penetrim brenda mbretërise së djallit me qëllim që të lironte adhuruesit e burgosur atje." Mijërat e idhtarëve të Zvise u shndrruan gjithashtu në islam dhe dy dekada më vone, hebrej të tjerë u shndrruan në një sekt hebrejo-musliman të quajtur "Donme". Sido që të ketë ndodhur, shumica e pasonjësve të tij mbeten hebrej.

Veziri i Madh, në vitin 1647, e syrgjynosi Zvinë në Ulqin. Ky veprim u ndërmor edhe pse Zvi tashmë ishte shndrruar në islam dhe kishte marrë emrin, Azis Mehmet Effendi.

Duket që Zvi e la Ulqinin me 1673, kohë kur atij iu shqiptua një syrgjynim tjetër: Kësaj radhe në Berat. Ai i jetoi ditët e fundit të jetës së tij në Berat ku edhe vdiq në vitin 1676. Ajo çfare dihet me siguri rreth tij, është se varri i tij gjëndet në anë të lumit Osum.

Vendi i cili mendohet të jetë varri i tij është trajtuar si një vend i shenjtë për të gjitha fetë, dhe një pervjetor i madh organizohet në truallin që mendohet si i tille. Enciklopedia Hebreje thotë se pasonjësit e Zvise u vendosën ne Berat dhe qëndruan atje për 30 vjet bashkë me një rabin nga Selaniku si kryetar i bashkësise së tyre.

.....

Varri i supozuar i Zvisë u bë një vend i shenjtë për një sekt islamik i njohur si "Bektashi". Deri më 1965 ai ishte vend i përbashkët i muslimanëve bektashi të cilët bënin peligrinazh tek ky varr.

Në një fshat të largët në Jug të Shqipërise, ka të dhëna për shenja të jetës hebreje që prej 500 vjetësh. Eshtë e mundur që Sabattai Zvi ta ketë kaluar kohën e ekzilit atje siç është e mundur që banorët e fshatit Ftera të jenë pasaardhës të pasonjësve të tij.

Më 1956, një kërkues hebre gjeti një letër të Zvise e shkruar rreth gjashtë javë para se të vdiste. Në atë letër ai iu kërkonte hebrejve të Beratit që t'i dërgonin një libër lutjesh për ditët e rëndësishme fetare të hebrejve. Letra është e ekspozuar në muzeun e Jerusalemit. Kjo është e vetmja letër e gjetur, e shkruar nga Zvi. Sipas një historiani izraelit, letra ishte gjetur në mes të faqeve të një libri i cili i takonte një sekti të dishepujve të tij në Selanik e që e praktikonin hapur fenë islame por që në të vërtetë praktikonin fshehtas një formë heretike të judaizmit.

Sabatai Zvi ka meritën të jetë hebrej jo - shqiptar më i famshëm që jetoi në Shqipëri. Por ai nuk ishte i vetmi. 250 vjet më vonë, qindra në mos mijëra hebrej jo - shqiptar do të kërkonin strehë në Shqipëri (6)

.....

Shënime

1.- Në një libër udhëtimesh të publikuar në vitin 1934 (Albanian Journey, Bernard Newman Pitman & Sons, London), autori u referohet tregtarëve hebrej, spanjishtfolës në Tiranë. Ndoshta ata flisnin Ladino. Ky duhet të jetë perjashtim që provon rregullin. Vetem pak hebrej shqiptarë dinë Ladino, një gjuhë e folur kryesisht në Turqi dhe Greqi. Shumica më e madhe e hebrejve në atë kohë jetonin në Vlorë e jo në Tiranë.

2.- Sipas Eduard Mantus, Bernshtain ishte marrë vesh me Mbretin Zog për të marrë hebrej nga Austria dhe Gjermania dhe për t'i vendosur në Shqipëri. Letër dërguar botuesit. Jewish Chronicle, 8 Qershor 1973.

3.- Shih Bernshtain, Herman, "Hebrejtë në Shqipëri", Jewish Daily Bulletin, 17,18 Prill 1934.

4.- Nuk ka një mënyrë të qartë për të shqiptuar këtë emër.

5.- Albanian Catholic Bulletin, 1934, Vëllimi XV - të, faqe 154

6.- Jakob Frank, një pasonjës i Sabbatait. Ai ishte përjashtuar nga judaizmi. Në shenjë hakmarrje ndaj këtij akti ishte dorëzuar në kishën katolike romake. Kjo është e vetmja kohë në histori që nje grup hebrejsh pranon se "gjaku i shpifur" është diçka e vërtete.

Enciklopedia Hebraike i kushton 14 faqe Sbattait dhe sabattaizmit.

.....

Kapitulli i Katërt

Në Shqipërinë muslimane gjatë periudhës otomane.

Shqipëria ishte pjesë e Perandorise Osmane për më shumë se 400 vjet, periudhë së ciles i erdhi fundi me shpalljen e pavarësise me 1912. Që përpara Valës së Dytë dhe përzenjes nga Spanja, hebrejtë ishin nën sundimin musliman. Ajo që ngjau me ta nuk është ajo që mund të presë lexuesi.

Çdokush që e shpallte veten besimtar të një zoti të vetëm dhe që ishte i gatshëm që të pranonte supermacinë politike të muslimanëve njihej si "*Dhimmi"* dhe përfitonte mbrojtjen e Perandorise Osmane duke pushuar se qëni edhe me tej objekt persekutimi. Megjithatë kjo nuk do të thotë se kristianët, armenët ose hebrejtë ishin të barabartë përpara ligjit me muslimanët.

Muslimanët kishin një status më të lartë, paguanin taksa më të ulta dhe kishin më shumë mundësira se ata jo-muslimanë. *Dhimmi,* qoftë ai hebre apo kristian ballafaqohej me një farë frike, megjithëse nuk i nënshtrohej pogromeve dhe as ndryshimit të fesë me dhunë.

Statusi i hebrejve ishte i barabartë me kristianët dhe nuk duket të kishte ndonje dallim midis *Dhimmi* - ve të ndryshëm. Ne Spanjen katolike, hebrejte kategorizoheshin njësoj me minoritetin musliman. Ndërsa në Shqipërinë muslimane dhe në Perandorine e Madhe Osmane, hebrejtë kategorizoheshin njësoj me pakicat kristiane. Një hebru ishte në pozitë më të sigurtë si një *Dhimmi* brenda territorit të Perandorisë Muslimane se sa diku tjetër ku sundonte kristianizmi. Kjo ka zgjatur thuajse për më shumë se katërqint vjet të

Perandorisë Osmane. Hebrejtë përmenden pak, qoftë në jetën politike, në ushtri apo në qeverisje. I vetmi rast që përmenden është ai i një gjyqi, në vitin 1903.

Statusi i *Dhimme* - ve që gëzonin hebrejtë nuk ndryshoi as pas periudhës osmane. Nuk është e qartë në se kjo vinte nga fakti që në Shqipëri numri i tyre ishte i vogël apo për arësye të tjera, por ajo që dihet me siguri është se ata nuk donin të binin shumë në sy. Në historinë e këtij vendi ata përmenden shumë pak.

Në përgjithësi hebrejtë bënin shumë kujdes që të mos binin në sy. Ata mendonin se çdo gjë që bënin mund të tërhiqte vemendjen ose zilinë e të tjerëve bile edhe në se shtëpitë ose bllokun e shtëpive e bënin më mirë se të tjerët.

Lëvizja për pavarësi

Aspirata greke për pavarësi nga sundimi otoman kishte një qëllim fisnik por sikundër edhe në levizje tjera, të tilla, hebrejtë u zune ngushtë prej tyre. Grekët në lëvizjen e tyre anti - turke e anti - muslimane, shpesh i barazuan hebrejtë me muslimanët, kështu që hebrejtë përjetuan vrasje dhe tmerre të mëdha. Arsyet mund të merren me mend. Kjo mund t'i atribuohet shoqerisë së afërt të hebrejve me muslimanët, ndjenjave negative që ekzistonin tek greket ndaj çdokujt që nuk ishte grek, anti - semitizmit të tyre tradicional ose të gjithave së bashku. Në konfrontimet muslimano - kristiane në këtë pjesë të botës, hebrejtë ndiheshin më mirë nën sundimin e muslimanëve se sa të kristianëve. Shembulli më i mirë për këtë gjëndet në dy shekujt e kryqëzatave, ku një numer i madh hebrejsh u masakrua pa asnjë arësye.

Me përjashtim të një ose dy periudhave të këqia dhe gjatë rrebelimeve që ishin lëvizje për pavarësi ndaj turqve, hebrejte ishin të mbrojtur nga pogromet. Eshtë e çuditshme se si ne gjejmë masakra ndaj tyre në periudhën kur shqiptarët po përpiqeshin të arrinin pavarësine dhe lirinë e tyre politike prej otomanëve. Pa marrë parasyshë se sa besnikë ishin ndaj osmanëve, ata shiheshin si pro-osmanë, prandaj edhe u konsideruan si armiq të lëvizjes kombëtare për pavarësi.

.....

Thuhej se kur shqiptarët (dhe grekët në anën tjetër) të revoltuar u ngritën kundër turqve më 1911, hebrejtë u ndihmuan turqve. Kjo pati si pasojë vrasje hebrejsh.

Historikisht hebrejtë e kanë pranuar forcën politike në fuqi. Hebrejtë nuk kanë qenë revolucionarë nga natyra, të paktën jo deri në fund të shek. XIX - të dhe në fillim të shekullit të XX - të. Kjo e gjen spjegimin e vet tek deviza e tyre: "djalli që njoh është më i mirë se djalli që nuk e njoh"; ose mbështetur në eksperiencën e tyre të gjatë, hebrej mbetet pakicë e persekutuar pa marrë parasyshë se çfarë administrate është në fuqi, kështu që " nuk ia vlen që të ngatërrohesh për gjëra me të cilat nuk ke të bësh drejtpërsëdrejti". Më tej kjo devizë është zhvilluar në principin: "Leri të tjerët që të luftojnë me njeri tjetrin, sepse hebrej mbetet hebre, pavarsisht se kush do ta fitojë betejën politike." Vitet e revolucioneve, ndryshimeve të qeverive dhe zhvillimit të nacionalizmave ekstreme nuk kanë qenë vite të mbara për hebrejtë.

Hebrejtë kanë qenë besnikë ndaj osmanëve dhe e vlerësonin statusin që këta të fundit u kishin dhënë atyre. Ata ishin çliruar nga frika, gjë që nuk ndodhte në asnjë vend europian. Por hebrejtë e paguan shtrenjtë këtë qëndrim të turqve ndaj tyre. Në rebelimet e pasuksesshme ndaj turqve, grekët do të ndërmerrnin shpesh veprime asgjësuese ndaj tyre.

Sistemi i Miletit

Shqipëria vuajti nën Perandorinë Osmane për katërqint vjet. Pushtimi i plotë i saj u bë me 1501 dhe zgjati deri në vitin 1912. Osmanët vunë në zbatim një formë qeverisje të quajtur "*Milet*", me qëllim që të lehtësonin administrimin e perandorisë së tyre të pafund deri në skajet më të larta.

Mileti ishte një formë organizimi e bazuar në vetqeverisje me liderë fetarë të veshur edhe me autoritet laik. Udhëheqësit hebrej ishin rabinët. Ata kontrollonin çdo gjë përveç ekonomisë e cila u ishte lënë në dorë tregtarëve dhe zejtarëve.

Brenda *Miletit*, hebrejtë mund të adhuronin në formën e tyre, të flisnin hebraishten si dhe të kontrollonin shumë mirë jetesën e tyre për aq kohë sa ata nuk e demtonin paqën dhe i paguanin taksat. Ekziston një mendim sipas të cilit sistemi i *Miletit* ushqente armiqësi midis grupeve të ndryshme etnike duke mos u lënë atyre mundësi që të organizoheshin kundër sundimit turk. Kjo ndoshta është një ndër format që e bënte *Miletin* edhe më funksional për të patur nje sundim të përsosur, ashtu siç e donin osmanët.

Sistemi i *Miletit* zbatohej ndaj tërë qytetarëve jo-muslimanë të Perandorisë Osmane. Pakicat më të mëdha në këtë sistem ishin ortodoksët grekë, armenët dhe hebrejtë. (Palestina) *Mileti* ishte një shprehje e tolerancës së turqve, por ishte edhe një mënyre për të administruar një perandori aq të madhe. Ky sistem nuk u prish deri me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, ndonëse ai kishte mbaruar në Shqiperi që me 1912.

Hebrejtë në Ushtrinë Otomane

Në periudhën nga viti 1855 e më pas, hebrejtë paguanin "taksë zevendësimi", në vend që të shërbenin në ushtrinë otomane. Taksat u hoqën me 1910, kështu që hebrejtë filluan të thirreshin nën armë. Shumica e tyre shërbeu me dëshire në ushtrinë shqiptare megjithëse pat edhe nga ata që ikën në Greqi për t'ju shmangur detyrimit ushtarak. Ushtria u siguronte ushqim të mjaftueshëm dhe i lejonte ushtaret hebrej që të festonin festat e tyre fetare.

Ne njohim të paktën një doktor hebre - shqiptar i cili shërbeu në ushtrinë osmane. Ai ishte Dr.Solomon Effendi, doktor ushtarak i cili e filloi karrierën në vitin 1896-1897

Korfuzi

Hebrejtë iberikë dhe ata italianë kanë jetuar në ishullin e Korfuzit që në shekullin e XII - të, në fillim nën venecianët e më pas nën osmanët. Jeta hebreje ka evoluar në dy bashkësi të ndara: në atë italiane e greke. Ata jetonin në paqë e harmoni në atë ishull deri në kohën e revolucionit grek.

.....

Vetëm kur e tërë popullsia hebreje u vu në rrezik nga grekët gjatë revolucionit të tyre anti-turk, të dy grupet u lidhën me njëri tjetrin në mënyrë të pazgjidhshme.

Një numër i madh hebrejsh në Korfuz dhe në krahina të tjera u masakruan prej grekëve në revolucionin e vitit 1921 edhe pse nuk luajtën ndonje rol në sundimin turk bile edhe pse nuk ishin palë dhe as që donin të përziheshin në konfliktin midis muslimanëve dhe kristianëve. Masakrat që ata përjetuan në atë kohë nga grekët ngjasin me ato të Holokaustit të kryera në shek. e XX - të: 5.000 të vrarë në Morea, qindra të tjerë në Vllahi, 1.200 në Tripolza. Hebrejtë që jetonin në ishullin e Spartës, Patras, Korinthos, Mistras dhe Argos u fshinë nga faqja e dheut. Të njëjtin fat patën edhe ata të Tebës, Vrachorit, Atikës dhe Epirit.

Në fillim Korfuzi ishte vendi për ku niseshin hebrejtë pasi ua mbathnin prej bandave greke, por shpejt u provua se edhe ky ishull nuk ishte i përshtashëm për të shpëtuar kokën. Bandat greke masakruan një numër të madh hebrejsh në Korfuz. Strehë për ta u kthye Izmiri, ku formuan një bashkësi te re.

Vetëm në veriun e Greqisë dhe pikërisht në Janinë dhe Selanik, turqit dhe hebrejtë mundën tu rezistonin masakrave që ndërmorën grekët ndaj tyre. Në këtë kohë (1820) Janina ishte kryeqyteti i Vilajetit me të njejtin emër dhe një prej katër vilajeteve që përbënin Shqipërine e që ishin ndarë për lehtësi administrimi nga Porta e Lartë.

Ne vitin 1891, "Gjaku i shpifur" ngriti kokën e tij të shëmtuar në Korfuz çka bëri që të organizoheshin manifestime anti - hebreje. Kjo bëri që shumë prej tyre të iknin prej andej për në Janine.(1)

Gjatë luftës greko - turke të vitit 1897, hebrejtë e Korfuzit dhe ata që ishin brenda vendit u bënë objekt goditjesh të vazhdueshme, vrasjesh e keqtrajtimesh. Vala e largimeve vazhdoi si edhe më parë në Selanik dhe Izmir, të dya qytete të rëndësishme osmane.

.....

Lajmi i dhënë nga një gazetë, sipas së ciles sulltani e kishte pritur kreun e rabinëve të Janinës me të gjitha nderimet, u kishte bërë shumë dëm hebrejve, pasi grekët kishin reaguar me egërsi të jashtëzakonshme ndaj këtij fakti.

Në vitin 1909, një bandë ortodokse greko - shqiptare vrau katër hebrej dhe plagosi shumë të tjerë. Ata ua prenë veshët viktimave dhe ua dërguan në sinagoge.(2) Kjo, thuhet të ketë qenë një hakmarrje ndaj hebrejve të cilët spiunonin kunder revolucionarëve grekë.

Gjatë kryengritjeve të shqipëtarve të vitit 1911, hebrejtë u akuzuan për bashkëpunim me turqit në dëm të lëvizjes kombëtare shqiptare për pavarësi.

Më 1912, Perandoria Osmane po binte. Ballkani përbëhej nga një mori kombesh ku secili dyshonte tek tjetri. Serbët kërkonin dalje në dete, diçka që Austro-Hungaria e kundërshtonte. Këta të fundit e ndjenin që një Shqipëri e pavarur ishte e preferueshme pasi kjo do të bllokonte Serbinë nga të dalurit në dete. Për këtë kishte lindur Shqipëria. Pavarësia i shërbeu asaj më së miri, pasi ajo qe e zonja që të mbetej neutrale gjatë Luftës se Pare bile edhe pse një pjesë e vendit u pushtua nga italianët, austro - hungarezët dhe trupat franceze.

Shënime:

1.- Jewish Chronicle, 29 Maj 1891, faqe.7. "Gjaku i shpifur" është një trillim i hershëm sipas të cilit hebrejtë i vrisnin femijët jo - hebrej për tu marrë gjakun të cilin e përdornin për qëllime fetare.

2.- Jewish Chronicle, 29 Janar 1909, fq.8

.....

Kapitulli i Pestë

Periudha midis dy luftrave

Shqipëria u shpall shtet i pavarur më 1912 dhe mundi të mbetej asnjanëse gjatë Luftës së Parë Botërore, ndonëse u kthye në një fushë beteje për kombet ndërluftuese (1). Traktati i Fshehtë e Londres i vitit 1915 u nënshkrua nga Aleatët pa dijeninë e Shqipërise, duke lëne zona të tëra, thuajse tërësisht të populluara prej shqiptarëve, jashtë kufijve të vendit. Më 1920, Fuqitë e Mëdha përcaktuan kufij të rinj duke e ndare vendin më dysh e duke lënë respektivisht gjysmën e popullsisë jashtë shtetit ame.

Në qershor të vitit 1926, Fan S.Noli, një prift, intelektual demokrat u bë kryeministër i Shqipërise. Në këtë kohë Shqipëria u pranua antare e Lidhjes së Kombeve. Por qeverisja e Nolit zgjati vetëm gjashtë muaj, pasi atë e mori Ahmet Bej Zogolli i njohur me emrin Zog. Me 1924 ai mori atributet e presidentit të vendit, ndërsa me 1928 e shpalli veten Mbret të Shqiptarëve.

Periudha midis luftrave botërore ishte një prej periudhave të prosperitetit të madh të hebrejve shqiptarë ndonëse ishte edhe një periudhë e dobësimit të traditave të tyre. E vetmja sinagogë që gjendej qe shkatërruar për të mos u ngritur më. Trashgimtari i familjes Levi donte të paguante për rindërtimin e saj por vdiq para se ta realizonte këtë synim. Shkollat e fundit hebreje u mbyllën gjatë kësaj periudhe.

Jakoel e quan periudhën prej vitit 1925 deri me 1935, periudhë në të cilën sundoi Mbreti Zog, "një kohë të artë për hebrejtë shqipëtar" edhe pse bashkësia e tyre nuk njihej zyrtarisht prej qeverisë deri me 2 prill 1937.

.....

Nga faqja 27 deri ne faqen 57

.....

Në vitin 1930, Bashkia e Vlorës adaptoi një ligj nëpërmjet të cilit iu kërkonte pronarëve hebrejë që t'i hapnin dyqanet të shtunën dhe t'i mbyllnin të djelën (2) Në rast të moszbatimit të këtij rregulli parashikoheshin gjoba të rënda. Të djelën e parë pasi ky ligj kishte hyrë në fuqi, dyqanet e hebrejve qëndruan të mbyllura duke iu nënshtruar gjobave të parashikuara. Javën tjetër gjobat u rritën. Pronarët e dyqaneve vendosën së bashku që t'i hapnin dyqanet të djelën siç e kërkonte rregulli por të mos shisnin. Ata që ishin më të pasur preferuan që të mos i hapnin dyqanet duke i paguar gjobat.

Hebrejtë e hodhën Bashkinë e Vlorës në gjyq. Gjykata u dha të drejtë që t'i mbyllnin dyqanet të shtunave. Bashkë me këtë atyre iu kthyen edhe shumat e të hollave të paguara për gjobat.

Sipas Enciklopedisë Hebreje, me 1927, "numri i vogel" i hebrejve shqiptarë jetonte kryesisht në Korçe. Ka mendime të ndryshme rreth faktit se ku jetonte pjesa më e madhe e hebrejve shqiptarë midis dy luftrave. Jakoel e sfidon mendimin e mësipërm duke thënë se grupi më i madh gjëndej në Vlorë. Në rregjistrimet e popullsisë të vitit 1930 në Shqipëri numëroheshin 204 hebrej. Gjithnjë sipas shifrave zyrtare, më 1937, popullsia hebreje në Shqipëri numëronte 120 frymë të cilët jetonin më së shumti në Vlorë dhe në Delvinë.

Me 1928, Kushtetuta Shqiptare u amandamentua duke përfshirë një nen i cili kishte të bënte me lirinë e besimit. Në të shprehej qartë: "Në vend nderohen te gjitha besimet dhe fetë; liria e praktikimit të tyre mbrohet me ligj. Feja në asnjë rast nuk përbën pengesë ligjore. Feja nuk mund te përdoret për qëllime politike." Shteti shqiptar nuk njihte fe zyrtare por ndalonte me ligj ndrrimin e fesë nga shtetasit e vet. Edhe kushtetuta e riparë e vitit 1939 shpallte të njejten gje: respektimin e feve dhe garantimin e praktikimit te tyre me ligj.

.....

Janina

Megjithëse Janina dhe pranë saj Preveza(3) kanë mbetur nën Greqinë, ato e kane siguruar vendin e tyre në historinë e hebrejve shqipëtar. Janina u mbajt nën sundimin osman që nga 9 Tetori i vitit 1430 e deri me 1913. Ajo bashkë me rrethinat e saj ishte pjesë e Shqipërise por mbas largimit të osmanëve iu dha Greqisë e cila e mban edhe sot e kësaj dite.

Shumica e hebrejve romaniote mund tu shkojnë gjurmëve të historisë së familjeve të tyre nëpërmjet Janinës. Greqishtja e folur prej tyre në këto zona ishte aq arkaike sa të bën të besosh se është e vërtetë se bashkësia hebreje në Janinë është vendosur që në shekullin e IX - të. Janina ishte kryeqyteti i atij rajoni dhe një qytet i pasur në të cilin prosperonin si hebrejtë edhe bashkësitë e tjera.

Në Janinë hebrejtë gëzuan ditë të arta por përjetuan edhe pogrome. Gazetat e athershme shkruanin për një numër të madh hebrejsh të mbytur në Janinë, me 9 Janar 1909.

Të llogaritësh numrin e hebrejve është e vështirë sepse ai ndryshon gjatë periudhave të ndryshme. Llogaritjen e vështirëson edhe mënyra se si është bërë rregjistrimi: herë herë me numër frymësh e herë herë me numër familjesh. Vitet e rritjes më të madhe ishin ato kur osmanët i mirëpritën refugjatet që po iknin nga inkuizicioni spanjoll për tu përfshirë në popullsinë romaniote. Vitet e zvogëlimit më të madh ishin ato gjate periudhës midis viteve 1912-1920, atëhere kur shumë shqiptarë emigruan drejt ShBA - ve dhe pa dyshim ditët më të zeza mbetën ato të vitit 1944 kur Holokausti mbërriti në Janinë.

Me 1831 atje kishte një bashkësi prej 212 familjesh i cili shkoi në 343 ne vitin 1856. Me një mesatare prej gjashtë frymësh për familje, duhet te ketë pasur

respektivisht 1.200 dhe 2.056 frymë. Në vitin 1870 pat një zvoglim të numrit të hebrejve prej 250 familjesh (1.500 vetë) gjë që mund të spjegohet me numrin e madh të atyre që emigruan drejt Vlorës. Në gjashtë vitet që pasuan (1876) pat një dyfishim të popullsisë duke e çuar numrin në 3.000, shifer e cila u ruajt deri në vitet e emigracionit të madh drejt ShBA - ve, të përmendura më lart.

.....

Në vigjilje të Holokaustit kishte 1.950 hebrej që jetonin në Janinë. 1.850 prej tyre u dërguan në Aushvic me 24 Mars 1944. Me 1948 numri i tyre ishte 170. Sot janë më pak se 100.

Hebrejtë e Janinës zotëronin një libër të vjetër, të shenjtë i cili mendohet të ketë qenë 1500 vjeçar, i njohur me emrin "Më të sigurtë në Vlorë" Ai më parë u takonte hebrejve të Vlorës. Shkrimet në atë libër të shenjtë do të tregonin se në atë vend hebrejte kanë zënë vend që prej më se 1500 vjetësh. Më 1936, hebrejtë nga Shqipëria kërkuan tu rikthehej libri por ata të Janinës i mbajten me llafe duke e shtyrë kthimin. Ky libër i shenjtë u dogj prej nazistëve së bashku me libra të tjerë të gjetur në Janinë.

Katër Vilajetet.

Për të kuptuar mardhënjet e Janinës me Shqipërine në përgjithësi dhe të Vlorës në veçanti është e nevojshme të dihet se si ishin të organizuara katër vilajetet, të cilat përbënin Shqipërinë e atherëshme nën sundimin e Perandorisë Osmane.

Deri më 1878, Shqipëria përbëhej nga kater provinca, të quajtura ndryshe, *vilajete.* Ato ishin, Vilajeti i Janinës, Shkodrës, Kosovës dhe i Manastirit. Janina ishte kryeqyteti i provincës me të njejtin emër. (4) Ajo jo vetëm që gjëndej në Shqipëri, por edhe shtrihej në një krahinë me Beratin dhe Vlorën. Kjo e lehtësonte lëvizjen midis Janinës dhe Vlorës duke i hapur rrugë emigrimit të *Valës së Tretë.*

Aty nga fundi i shekullit të 19-të, lidhjet midis Vlorës dhe Janinës mbaheshin ende të forta, ndonëse jo aq sa kishin qenë më parë. Vilajetet u shkrinë ndërsa Janina vetë u kthye në një provincë greke edhe pse ajo ende vazhdonte të ishte nën sundimin osman.

Në të njejten kohë vihet re një forcim i lidhjeve midis hebrejve të Korfuzit dhe atyre të Vlorës. Korfuzi është shumë afër me Vlorën. Kjo do të sillte favore të

mëdha po të mos bëhej pengesë gjuha. Hebrejtë e Korfuzit pëlqenin të flisnin një variant të italianizuar të greqishtes. Hebraishtja nuk mund të quhej gjuhë e përbashkët në atë periudhë, pasi ende nuk ishte ringjallur deri në atë masë sa të merrte trajtën e vet të plotë si gjuhë e folur.

29

.....

KATER VILAJETET GJATE PERANADORISE OSMANE (Deri me 1878) (Per botim te shfrytezohet harta e botuar ne tekstin origjinal)

30

.....

Ka patur një lidhje mbas Luftës së Dyte Botërore midis hebrejve të Shqipërise dhe atyre të Janinës por kjo lidhje ishte e dobët. Vetëm 10 % e hebrejve të Janinës mbijetuan, ndërkohë që politika izolacioniste e Enver Hoxhës i ndihmoi edhe me shumë dobësimit të këtyre lidhjeve. Thyerja përfundimtare e këtyre lidhjeve ndodhi kur hebrejtë e Shqipërise emigruan përfundimisht në Izrael. Ashtu të shkatërruar siç ishin në Janinë, hebrejtë gjetën forca për tu dërguar shqiptarëve në vitin 1945, nëpërmjet të Fondit të Ndihmave nga Janina, rreth 1.500 pound nga mielli Matzo. Në Mars të vitit 1953, Fondi i Ndihmave i Janinës siguroi ndihma ndaj atyre që ata i quanin "hebrejtë e Janinës që jetojnë në Shqipëri"

Pas Luftës së Parë Botërore shpërtheu Lufta Greko-Turke. Kjo luftë detyroi shumë hebrej nga Janina të shkonin në Shqipëri për t'i shpëtuar mobilizimit në ushtrinë greke.

Shënime:

1.- Shqipëria ishte vendi i fundit që u çlirua nga Turqia.

2.- Në të njejtën kohë gjenden raste të ngjashme edhe në gjykatat e Polonise dhe të Nju Jorkut. Ato shkuan edhe më tej duke iu kërkuar pronarëve të dyqaneve që t'i hapnin të

djelen. Gjykata shqiptare kërkonte që të mbylleshin të gjitha dyqanet të djelën pasi dita e pushimit në një vend si ai, ku shumicën e përbejnë muslimanët ishte e premtja.

3.- Thuajse çdo gjë që është shkruar për Janinën duhet thëne edhe për Prevezen, sigurisht në një shtrirje më të vogel.

4.- Mbasi Turqia u mund prej Rusise më 1874, Shqipëria, edhe pse vazhdonte të ishte pjesë e Perandorise, u gjymtua dhe u zvoglua. Pjesë të tëra nga çdo vilajet iu dhane fqinjëve të saj. Parë nga këndvështrimi i interesave tona, ndryshimi më i rëndësishëm është që Janina nuk ishte më e Shqipërise dhe se Vlora u kthye në qendër të jetës së hebrejve në Shqipëri.

.....

Kapitulli i gjashtë

Refugjatët hebrej.

Refugjatët e parë hebrej të kohëve moderne erdhën në Shqipëri në vitin 1933, më së shumti prej Gjermanisë dhe Austrisë, në rrugen e tyre drejt SHBA -ve, Afrikës së Jugut, Turqisë e gjetke. Pak prej tyre, në se ishte ndonjë, planifikonte të qëndronte në Shqipëri. Shqipëria ishte një stacion i përshtatshëm në rrugën e gjatë për një vend tjetër.

Me rritjen e shqetësimit që lindi tek hebrejtë gjermanë dhe austriakë për të ardhmen e tyre nën rregjimin nazist, numri i atyre që përpiqeshin për të shpëtuar nga Europa u rrit menjëherë. Gjatë muajve të parë të vitit 1939, konsullatat shqiptare u mbushën plot me hebrej të cilët kërkonin viza hyrje. Në fillim kërkuesit ishin nga Gjermania dhe Austria por aty nga fundi i 1938 - tës dhe fillimi i '39 - tës atyre iu bashkuan edhe hebreje nga vende të tjera nga Europa Qëndrore.

Për të marrë një vizë hyrje si pikë tranziti për të ikur jashtë Europës nuk ishte e vështirë, pasi qeveria shqiptare ishte shumë liberale në lëshimin dhe garantimin e vizave. Çështja nuk qëndronte se a mund të shkoje në Shqipëri por si të gjëndej rruga për një vend tjetër.

Ndërsa numri i hebrejve që futeshin në Shqipëri rritej, mundësitë për të vajtur në destinacion, zvogëloheshin. Në atë kohe u mbajt një konferencë ndërkombëtare me përfaqësues nga SHBA - të, Italia dhe Shqipëria në kërkim të një vendi për refugjatët hebrej. Italia shkoi deri aty sa ofroi një vend për

5.000 refugjatë në një prej kolonive të saj afrikane. Në dimrin midis viteve 1938-1939, kuota amerikane për refugjatët bëri të pamundur garantimin e vizave për më shumë hebrej. Konferenca u mbyll duke marrë shumë pak përsiper.

Në fillim të vitit 1938, në Shqipëri gjëndeshin 300 hebrej shqiptar.(1) Gjatë viteve 1938 - 1939 popullsia hebreje u rrit në mënyrë të ndjeshme.

.....

Dukej qartë se kishte një rritje të numrit të hyrjeve në Shqiperi, në një kohë kur numri i të larguarve po zvogëlohej. Nga fundi i po atij viti, numri i hebrejve u rrit zyrtarisht në 350 por kishte shumë hebrej në vend, shumica e të cilëve me viza "turistike" ose "tranziti" të skaduara.

Ambasadori Bernshtain bëri përgatitjet e nevojshme për vendosjen e hebrejve gjermanë dhe austriakë në Shqipëri. Për shembull, në shkurt të vitit 1939, 100 hebrej të cilët erdhën nga Viena u lejuan në menyre legale të vendoseshin në Shqipëri: 60 prej tyre në Tiranë dhe 40 në Durrës.

Gjithashtu, 95 familje hebreje arritën në Mars të vitit 1939. Mbreti Zog i lejoi hebrejtë që të vendoseshin në Shqipëri, por ai për vete iku në Greqi më pak se një muaj më vone, pasi italianet e pushtuan Shqipërine të Premten e 7 Prillit 1939.

Me pushtimin italian të Shqipërise dhe me fillimin e luftës globale në Shtator 1939, refugjatët u detyruan që të pranonin faktin se ata duhej të qëndronin në Shqiperi deri në mbarim të luftës. Gjërat dukeshin aq mirë për hebrejtë shqiptar dhe ata ndjeheshin aq të sigurte sa që pak vemendje iu ishte kushtuar fjalëve të emigrantëve rreth tmerrit në rritje në vendet e Europës Qëndrore.

Gjërat u ngatërruan shumë lidhur me vendin se ku do të ishin më të sigurinë hebrejtë. Një hërë e një kohë rruga për të shpëtuar kalonte nëpër Shqiperi, ne Itali e më tej. Pas fillimit të luftës hebrejte gjermanë të cilët mundnin të arrinin në Itali futeshin ilegalisht në Shqipëri.

Numri i refugjatëve që arritën në Shqipëri llogaritej të ishte me qindra në mos me mijëra. Kështu ata ishin përplasur në një vend për të cilin ambasadori Bernshtajn do të shkruante: "Nuk ka gjurmë të ndonje diskriminimi ndaj tyre

(hebrejve) për arsye se Shqipëria është një ndër të paktat vende në Europën e sotme ku paragjykimi dhe urrejtja fetare nuk ekzistojnë."

33

.....

Qeveria shqiptare.

Qeveria shqiptare adaptoi rregulla të ndryshme anti-hebreje gjatë periudhës së viteve 1938-1939, bile që përpara pushtimit italian. Ajo nuk pati as dëshirën, por as kohën e nevojshme për ti zbatuar këto vendime. Dukej qartë së këto ligje ishin bërë për të kënaqur italianet ndërkohë që nuk kishte as gadishmërinë më të vogël për t'i zbatuar ato. Praktikisht, ndaj hebrejve nuk ushtrohej asnjë kufizim i veçantë.

Një ndër kufizimet e zbatuara ndaj hebrejve ishte lëshimi i vizave vetëm për 30 ditë. Vizat turistike kishin vetëm emrin "turistike" pasi ato nuk respektoheshin si të tilla prej "turistëve" hebrej. Kjo përbente mënyrën se si të futeshin në Shqipëri me qëllim që të shtrohej rruga se si të shkohej diku tjeter. Kur kjo ishte e pamundur, "turisti" kthehej në një banor ilegal të Shqipërise.

Konsujt shqiptar u instruktuan të hiqnin dorë nga të lëshuarit e vizave turistike për hebrejtë. E megjithate ata vazhduan ta bënin këtë deri në fillim të Luftës Botërore. Shumë konsuj, thjeshtë nuk i morën parasyshe ato kufizime. Edhe pas fillimit të Luftës së Dytë, disa hebrej mundën të merrnin përsëri viza për të hyrë në Shqipëri, duke përdorur në ndonjë rast edhe bakshishin.

Mbështetja financiare dhe forma të tjera.

Në Shqipëri refugjatët hebrej ndiheshin relativisht të sigurtë. Bashkësia hebreje vendase iu siguroi atyre ndihma, falë përpjekjeve bujare të tregtarëve hebrej si Isak Kohen në Durrës, Rafael Levi dhe Rafael Jakoel në Vlorë, etj. Shumica e këtij fondi u sigurua prej shoqatave bamirëse hebreje, përfshirë edhe Komitetin e përbashkët Amerikan të Shpërndarjes. Edhe Qeveria Shqiptare dha një ndihmë modeste për refugjatët më në nevojë.

Hebrejtë të cilët kishin mbushur në Shqipëri disa muaj u lejuan që të punonin në tregti ose profesione të tjera që ata zotëronin, duke i paisur me leje qëndrimi. Sipas ligjës refugjatët duhej ta lëshonin vendin me të skaduar viza, por në këtë

rast moszbatimi i këtij ligji konsiderohej një nder pasi kjo kishte si rrjedhoje shpëtimin e jetëve të atyre njerezve.

34

.....

Konsujt shqiptar po e lehtësonin hyrjen e hebrejve në Shqipëri. Ata përkundër politikës zyrtare, vazhdonin të lëshonin viza.

Pas pushtimit, italianët ushtruan presion mbi qeverinë shqiptare më qëllim përzenjën e hebrejve të huaj si dhe të ndërmerrte kufizime ndaj atyre vendas.

Italia dhe pushtimi italian.

Italia ishte i vetmi vend më të cilin Shqipëria kishtë nënshkruar një traktat dhe ishte po Italia ajo që e pushtoi në Prill të 1939 - tës. Me këtë fakt mund të spjegohet ngurrimi i Shqipërisë për të hyrë në ndonjë traktat tjetër që prej Luftës së Dytë Botërore.

Italianët nganjëherë i referoheshin anti-semitizmit si "sëmundje gjermane" Bile, bile edhe kur i zbatonin urdhërat e gjermanëve dukej sheshit se kete e benin pa kurrefare deshire. Ne Itali hebrejte ishin relativisht te sigurte deri me kapitullmin e saj ne vjeshtën e vitit 1943, kur pjesa qendrore dhe veriore e vendit (perfshire edhe Romën) ranë nën pushtimin gjerman. Tragjikisht, keto ishin edhe zonat me perqëndrime më të mëdha hebreje.

Italianët rrallë mund të bëheshin vegla të bindura të gjermanëve kur ishte fjala për hebrejtë. Prej dëshmive të njerëzve del se jeta në kampet e administruara prej italianëve në Jugosllavi ishte e durueshme ndërkohe që ushtarët italianë u ndihmuan hebrejve që të çliroheshin nga kampet e të shkonin në Shqipëri. Kjo ndodhi në atë kohë kur një numër i madh i hebrejve nga Europa po dërgoheshin në Poloni e Gjermani, drejt kampeve të vdekjes.

Kur italianët arritën në Shqipëri, ata shpallën disa rregulla anti- hebreje ku ndër të tjera atyre u ndaloheshin veprimtaritë politike, sociale e kulturore. Në krahasim me vendet tjera të pushtuara, kufizimet ishin shumë më të lehta.

Gjatë kohës së pushtimit italian të Shqipërisë, shumë refugjatëve hebrej nuk iu cenua jeta, bile edhe atherë kur ata nuk e fshihnin identitetin e tyre.

.....

Ata i festonin ditët e shenjta dhe punonin për të mbajtur veten siç mundeshin, derisa gjërat u rrukullisen shumë shpejt me kapitullimin e Italisë dhe bashkimin e saj me aleatet në vjeshtën e vitit 1943. Gjermanët erdhën në Shqipëri. Rreth 800 refugjatë hebreje nga Jugosllavia, Bullgaria, Gjermania, Polonia dhe Austria të cilët gjëndeshin në Shqipëri edhe një herë u ballafaquan me friken dhe nevojën për të gjendur vend për tu fshehur.

Në ditët e fundit të pushtimit, italianet u urdhëruan që t'i grumbullonin hebrejtë që gjendeshin në Shqipëri për t'i përqëndruar të gjithë në një vend, në shkollën bujqësore të Kavajës. Ja se çfarë ngjau më pas:

Ushtarët italian që i ruanin hebrejtë duhej të zevendësoheshin prej ushtarëve gjerman. Komandanti italian e hapi derën e shkollës pa ndrojtjen më të vogel dhe u tha te ngujuarve: Ikni! Çfarë e bën këtë ndodhi edhe më interesante është fakti se nuk gjëndet asnjë dëshmi që të vertetoje se në Shqipëri ka patur kampe përqëndrimi apo dëshmi të tjera të cilat të tregojnë për "transport" të hebrejve për në kampet e vdekjes.

Jakoel thotë se nganjëhere ai e ka të vështirë t'i gjykojë italianët. Me të ardhur ata i institucionalizuan kufizimet ndaj hebrejve dhe dukej sikur donin që t'i

friksonin por, nuk i ndaluan që të punonin e të fitonin. Ata hebrej që ranë në dorë të italianëve në përgjithësi nuk u trajtuan keq.

Por nga ana tjetër, kur Rafael Jakoel u arrestua i akauzuar për ndihmë ndaj partizanëve, italianët dëshmuan se ato ishin të vërteta.

Me kapitullimin e Italisë, partizanët shqiptar përjetuan një kënaqesi të çuditëshme: Qindra ushtarë italianë iu bashkuan atyre duke u sjellë një sasi të madhe armësh dhe paisjesh ushtarake. Nuk dihet mirë numri, por dihet se fare pak ushtarë italianë iu bashkuan forcave gjermane.

.....

Territoret e aneksuara

Në prill të vitit 1941, territori i Kosovës, (2) në atë kohë pjesë e Jugosllavisë por e banuar kryesisht prej shqiptarëve etnike, u aneksua prej Shqipërise dhe u vendos nën "kontrollin shqiptar", i cili në të vërtete ishte një kontroll italian.

Që në fillim gjermanët paraqiten ligje për ndjekjen e hebrejve, ligje të cilat ata i kishin vendosur edhe në vende të tjera të pushtuara. Por çuditërisht ato ishin të pazbatueshme në Shqipëri. Për shembull, hebrejve në territoret e aneksuara u kërkohej që të vendosnin një "J" ose "Jew" në mëngën e xhaketes ose diku në rroba. Këto rregulla as që njiheshin në Shqipëri.

Hebrejtë në "zonat e aneksuara" nuk ishin aq fatlumë sa ç'ishin brenda vendit. Jeta në "territoret e aneksuara" nuk ishte e sigurtë dhe ndodhte që të bëheshin pre e abuzimeve të banorëve vendas.

Hebrejtë nga Serbia dhe Kroacia ia mbathen për tek kjo zonë ku ndjeheshin të trajtuar më mirë prej shqiptarëve dhe italianëve derisa edhe ketu mbrrine gjermanët. Sidoqë të ketë ndodhur, mënyra më të cilën shqipëtarët i trajtuan hebrejtë mbetet e pakrahasueshme me atë çfarë bënë të tjerët ndaj tyre. Shqiptarët as nuk i dorëzuan listat e hebrejve tek gjermanët e as nuk morën pjese në arrestimin e tyre.

Në Prishtinë, kryeqyteti i territoreve të aneksuara, me kërkesën e gjermanve, autoritetet lokale i përpiluan listat e hebrejve. Kjo solli arrestimin e 60 burrave hebrej. Një doktor simpatik shqiptar Spiro Lito, e bindi kryesinë e vendit që të mos lejonin dërgimin e këtyre 60 burrave në Poloni, të destinuar për shfarosje. Ai gjithashtu i bindi autoritetet gjermane se të burgosurit hebrej ishin të infektuar nga tifoja kështu që duhej domosdoshmërisht të dërgoheshin në spitalet e Shqipërisë për të menjëanuar ndonjë epidemi. Hebrejtë u dërguan në Berat, u paisën me dokumente false dhe u shpërndanë nëpër Shqipëri, më së shumti tek miqtë e Doktor Litos në qytetet Lushnje, Shijak, Kavajë e Krujë.

Disa instruksione të dhëna nga Ministri i Brendshem i Shqipërise, shefit të policisë së territoreve të aneksuara përbejne një histori më vete me një fund pjesërisht të lumtur.

.....

Motivimi nuk është i qartë por dihet se shumica shpëtuan.

Në një urdhër të lëshuar nga ministri, i datuar 20 Mars 1942, thuhej: "Të gjithë hebrejtë të cilët kanë qenë brenda rajonit tuaj përpara ndarjes së Jugosllavise duhet të transferohen brenda tre ditësh në Berat. Ata nuk duhet të ndalohen në rrugën e tyre. Nëqoftëse do të kundërshtojnë instruksionet e dhëna duhet tu bëhet e qartë se i pret deportimi. Hebrejtë të cilët kanë ardhur pas fillimit të luftës do të mbahen në burg dhe ju duhet të beni një listë emërore të tyre.

Ministri duket të ketë ndërruar mëndje pasi dhjetë ditë më vonë (me 1 Prill 1941) i rishikoi porosite: "Hebrejtë të cilët kanë ardhur pasi filloi lufta nuk do të burgosen por do të mblidhen në një *fushe perqendrimi*, për shkak se mund të ketë femijë dhe gra midis tyre. Ju do të koordinoni me autoritetet ushtarake për të patur një plan të përbashkët për të gjithë Kosovën. Për ata që lufta i ka gjetur këtu ndalohet deportimi për në Berat deri në një urdhër të dytë."

Shefi i policise nuk u ngut që të kryente detyrat e dhëna. Me 20 Maj ai e njoftonte ministrin: "Burrat hebrej të cilët ishin në rajon përpara luftës do të dërgohen në Berat. Gratë dhe femijët do të lejohen që të qëndrojnë atje ku janë ose të shkojnë në Berat. Në qoftëse ndokush që është caktuar që të shkojë në Berat gjëndet i sëmure, atëherë duhet pritur derisa sa ta marrë veten."

Me 5 korrik disa hebrej duhet të kenë qenë në burg pasi ministri urdhëronte: "Hebrejtë të cilët janë në burgun tuaj do të ndahen në katër grupe dhe të dërgohen në Kavajë, Krujë, Burrel dhe Shijak nën kontroll policor. Çdo përson ose familje është i lire që të zgjedhë këdo që do në grupin e tij veçse çdo grup duhet të ketë afërsisht të njejtin numër njerëzish."

Urdhëri nuk thoshte: "hebrejtë të cilët erdhën pasi filloi lufta" por thoshte, citojmë: "Hebrejtë të cilët janë në burg" "Por në vitin 1942, mundet që hebrejte që gjindeshin në burg të ishin po ata që arritën pasi filloi lufta por që vazhdonin të qëndronin fshehtas.

Eshtë e çuditshme se si kishte shqetësim për të sëmuret hebrej, fëmijët dhe gratë, për bashkimin e familjeve të tyre, në një kohë kur flitej për *fusha përqëndrimi*. Ajo çfarë ishte me të vërtetë diçka e mire ishte fakti se ata po shkonin drejt katër qyteteve të përmendura, (Kavajë, Krujë, Burrel dhe Shijak) pra në Shqiperi, në vendin emri i të cilit do të thoshte: JETE, megjithëse jo çdokush e kishte atë fat që të arrinte atje.

Ishin çrregullimet e shumta dhe një mungesë e theksuar formalitetesh që i bënte të paqarta sa për ata "bashkëvuajtës" sa për ne sot ato *fusha të përqëndrimit.*

Këto *fusha përqëndrimi* ishin të rrethuara me tela me gjëmba dhe me gardianë italiane. Dëshmitë ishin të dyfishta: këtu kishte rrethim me tela me gjëmba ku shtriheshin fushat e përqëndrimit të ruajtura nga gardianë italianë, më tej gjëndeshin hebrejtë që niseshin për Kavajë ose që interesoheshin për një film, një ndeshje futbolli apo një festë fetare. Ky kontrast lidhet me dy gjëra: Së pari rojet dhe zyrtarët e kampeve as nuk kishin porosi të qarta dhe as nuk ishin të gatshëm që t'i zbatonin ato; Së dyti, ne nuk mund të përgjithësojmë prej atyre pak raporteve për këto kampe pasi konditat ndryshonin substancialisht nga një vend në tjetrin dhe nga një kohë në tjetrën.

Në korrik të vitit 1943, duke qenë ende nën kontrollin italian, shefi shqiptar i policisë sygjeronte burgosjen e një numri të caktuar hebrejsh: " Sipas disa hulumtimeve tona, hebrejtë e listës së mëposhtme janë të rrezikshëm pasi ata bëjnë propogandë kundër aksit (Romë-Berlin) dhe duan të organizojnë aksione dhë të mbajnë metingje. Në mendojmë se këta njerëz duhet të hiqen prej këtej sa më parë që të jetë e mundur drejt një fushe përqëndrimi për shkak se qëndrimi i tyre i metejshëm mund të jetë i rrezikshëm për rregjimin."

.....

Jo çdo hebre në territoret e aneksuara e pat atë fat që ta dërgonin në Shqiperi. Numri i hebrejve të mbajtur në burgun e Prishtinës është i panjohur. Italianët i dorëzuan tek gjermanët ndërsa këta të fundit i dërguan në Beograd ku dhe gjetën vdekjen prej tyre. Ka shumë të ngjarë që këta të ishin hebrejtë të cilët shefi i policise i përshkruante si të rrezikshëm. Në prill të vitit 1944, gjermanët i transportuan 400 hebrej nga territoret e aneksuara për në Bergen Belsen; 100 prej tyre mbijetuan.

Sipas një raporti, numri i të mbijetuarve në Kosove ishte 60 për qint, shifër që e bën atë njëren prej zonave me përqindjen relativisht më të lartë të të mbijetuarve në Europën e pushtuar.

Shënime:

1.- Ambasadori Bernshtain zakonisht kupton numrin e hebrejve në Shqipëri. P.sh.ai shkruan: "Janë vetëm njëqint hebrej në të gjithë vendin" Mendohet se ai këtë e ka bërë me qëllim.

2.- Statusi i tashëm i Kosovës si pjesë e Jugosllavise është një burim konflikti. Shqiptarët kërkojnë ose pavarësi për Kosovën ose bashkimin e saj me Shqipërine. Populllsia është etnikisht shqiptare.

Disa shënime të rastit

A

Raport i zyrës së policisë së Prishtinës, 30 qershor 1943.

Solomon Hazmonay

Emri i babait: Haim; emri i nënës: Sara;Lindur ne Bullgari me 1913; qytetar i Sofjes. I pyetur se përse kishte hyrë në Shqipëri fshehtas, ai përgjigjet: " Me 6 qershor ne e lamë Shkupin në një vagon treni i destinuar për transport kafshësh dhe mbrrimë në Ferizaj të nesërmen. Kur zbritëm prej trenit na zuri policia dhe na dergoi menjëherë në burg. Arsyeja se pse ne erdhëm këtu është se autoritetet bullgare donin të konfiskonin pasuritë tona ndaj na deportonin. Ne erdhëm në Shqipëri për t'i shpëtuar rrezikut. Kishim pak dollare."

Nuk dimë se çfarë ndodhi me këtë familje por dimë se qeveria shqiptare siguroi një rrogë të vogël për ato familje të cilat ishin në gjendje më të keqe.

.....

B

Raport i një gruaje që jetonte në ato territore. Ajo ankohet se ishte arrestuar gabimisht pasi edhe pse ishte e lindur hebreje, ajo ishte shndrruar që heret duke u martuar me një kristian dhe ishte shkëputur nga origjina. Nuk gjëndet ndonjë

rregjistrim i ndonjë ankese të bërë nga ana e saj por në qoftëse ajo ishte e prekur si gjithë të tjerët, ankesa e saj eshte e pavlefshme.

C

Fushat e përqëndrimit.

Ky ishte një emër i vënë që kishte të njejtin kuptim me fjalën: kamp përqëndrimi. Këto ishin kampe për civilët dhe megjithëse shumica e njerëzve në to ishin hebrej aty kishte edhe njerëz të cilët hapnin probleme. Kampet ishin të rrethuara prej telash me gjëmba dhe ushtarësh italianë. Sëmundjet në kampe ishin tërësisht jashtë kujdesit dhe kontrollit. Barakat ishin prej druri dhe nuk kishin dritare. Krevatët ishin po ashtu prej druri të vendosur në tre kate. Thjesht ishte një vend i shëmtuar.

41

.....

Kapitulli i shtatë.

Gjermanët

Kërkesat për listën e hebrejve

Në fund të vitit 1943, gjermanët iu kërkuan drejtuesve të bashkësisë hebreje që të dorëzonin një listë të hebrejve që jetonin në Shqipëri. Me sa duket kjo kërkesë naive ishte hapi i parë drejt transportimit të hebrejve për në kampet e përqëndrimit. Ata nuk e dhane listen e kërkuar në vitin 1943 por megjithëate i përfshiu frika se mos rregjenca do të pajtohej më gjermanët dhe do tua dërgonte listat e kërkuara gjatë vitit që pasonte.

Në pranverën e vitit 1944, nazistët i kërkuan zyrtarisht rregjencës listat si dhe grumbullimin e hebrejve në një vend.

Babai i Josef Jakoelit, Rafael Jakoel dhe xhaxhai i tij Mateo Matalia i kuptuan qartë qëllimet e gjermanëve për të arrestuar të tërë hebrejtë e Shqipërise. Si udhëheqës të bashkesise ata u ankuan tek njëri prej rregjentëve, Mehdi Frashëri. Ky i fundit i këshilloi ata që të takoheshin me Minsitrin e Brendshëm, XhaferDeva, i cili njihej si anti-semitist.

Ata që shkuan të takoheshin me Ministrin Deva, edhe pse e dinin rrezikun që iu kanosej nga ky takim. Të dy e pranuan sfiden duke iu lënë familjeve lamtumirën përpara se të niseshin. Për çudinë e tyre, nacionalizmi i Ministrit Deva e tejkalonte anti-semitizmin e tij; ai pranoi që të protestonte tek gjermanët për rastin e tyre. Deva ia doli që t'i bindtte gjermanët që të tërhqnin kërkesën për hartimin e listave të hebrejve.

Kujtimet zbehen ndërkohë që koha kërkon haraçin e vet. Ka edhe nje variant tjetër të kësaj ngjarje me Xhafer Devën: Ai i hodhi poshtë kërkesat e gjermanëve dhe më pas i njoftoi hebrejtë se gjermanët e pranuan vendimin e tij, pra nuk ishte e nevojshme që të përpilohej lista. Nuk ka shumë rëndësi se cili nga variantet është i vërtetë pasi rrjedhoja është e njejta: Shqiptarët nuk iu bindën nazistëve për tua dorëzuar listat e hebrejve.

.....

Kur Ministri Deva e hodhi poshtë kërkesën e gjermanëve, gjithnjë sipas të dhënave, ai u tha gjermanëve se e vleresonte këtë si një shkelje flagrante të marrëveshjes si dhe një ndërhyrje arbitrare në punët e brendshme të Shqipërise. Ai iu spjegoi përfaqësuesve të bashkësisë hebreje përgjigjen që u kishtë dhënë nazistëve duke i siguruar ata se për sa kohë që qeveria shqiptare do të kishte force, hebrejtë në Shqipëri, nuk kishin se pse të kishin frikë. Ngjarjet e mëposhtme treguan vërtetësine e kësaj deklarate.

Fakti që qeveria dhe populli shqiptar nuk bashkëpunuan me gjermanët nuk do të thotë se rreziku ishte zhdukur si për hebrejtë ashtu edhe për muslimanët dhe kristianet te cilët i morën ata nën mbrojtje. Gjithkund rreth e rreth këtij vendi, nga Korfuzi, nga Janina si dhe nga territoret e aneksuara, hebrejtë transportoheshin drejt kampeve të vdekjes. Rëndësia e kundërshtimit të kërkesës për dorëzimin e listave të hebrejve nuk mund të mos vlerësohet. Ka një lidhje të padiskutueshme midis listës që nuk u dorëzua dhe numrit të atyre që mbijetuan. Shembulli i Greqise e ilustron më së miri, këtë. Në Selanik, listat

e kërkuara nga nazistët u dorëzuan dhe kjo bëri që të mbijetuarit të ishin jo më shumë se dhjetë për qint. Në Athinë listat nuk u dorëzuan dhe të mbijetuarit ishin pesëdhjetë për qint.

Bisedimet

Jakoel tregon për përvojën e tij kur ai dhe tre hebrej të tjerë të rinj po kërkoheshin nga gestapo. Tre të tjerë u kapën prej nazisteve. Pleqtë e bashkësisë hebreje të Vlorës u përpoqën që të bisedonin për lëshimin e tyre. Ata arritën që të futeshin tek shefi i Gestapos nëpërmjet të një ndërmjetësi. Ndërkohë njeri prej të treve arriti të njoftonte vëllain e tij dhe t'i thoshte se lëvizjet e tij ishin nën vëzhgim, kështu që duhej të bënte kujdes për pjesën tjetër të familjes. Përfaqësuesi i gjeneralit Futztun, shefi i gestapos iu ofroi atyre lirimin kundrejt një pagese të konsiderueshme në të holla. E vetmja garanci që gjermanët jepnin në këtë pazar ishte "fjala e nderit" e shefit të gestapos. Me të paguar mitin e kërkuar të katër hebrejtë u liruan.

.....

Thuajse i njejti incident i ndodhi Pepe Levit i cili kundërshtoi që të punonte si informator për gjermanët. Ai e ndjeu rrezikun e vdekjes ndaj përpara së të shkonte për të rrëfyer tek gjermanët vendimin që kishte marrë, i dha lamtumiren familjes së tij. Pa hyre tek detajet se si ndodhi, fakt është që gjermanët pasi e dëgjuan refuzimin ndaj kërkesës së bërë prej tyre për tu kthyer në një informator të gestapos, e lanë që të shkonte. Nuk ka spjegim tjetër veç atij që Rajhut të Trete i ishte afruar fundi dhe megjithëse gjermanët po e përshpejtonin punën e makinerise së tyre vrasëse, oficerë të veçantë të ushtrisë gjermane nuk dëshironin që emri i tyre të lidhej me vrasje hebrejsh.

Ndodhia e mëposhtme mund të merret si e fundit me hebrejtë e Vlorës. Nazistët kishin përgatitur një listë bashkë me adresat dhe kishin planifikuar që pikërisht në mëngjesin e asaj dite kur ata do ta lëshonin Vlorën, t'i arrestonin të tërë hebrejtë. Ata e ndjenin së fundi ishte afruar. Ditën kur gjermanët do të iknin, partizanët zbritën nga kodrat dhe e rrethuan qytetin. Ata filluan të këndonin e të kërcenin siç ishte zakoni i tyre përpara se të fillonin betejën, si formë e luftës psikologjike. Pushtuesi vendosi ta lëshonte qytetin natën, pa e pritur mëngjesin. Kështu hebrejtë e Vlorës shpëtuan.

.....

Kapitulli i Tetë

Fisnikët dhe Holokausti

Tani që Shqipëria është "hapur", ne mësuam për herë të parë historine e jashtëzakonshme se si shqipëtarët i mbrojtën hebrejtë gjatë pushtimit italian dhe gjerman. Dihet historia rrënqethëse e shpëtimit të hebrejve të Danimarkës. Historia e shpëtimit të tyre në Shqipëri ishte varrosur për katër dekada, për shkak të politikës anti-izraelite dhe izolacioniste të një diktatori komunist.

Asnjë hebre shqiptar nuk u vra gjatë Holokaustit . Po ashtu çdo hebre grek, gjerman, jugosllav apo austriak që pat fatin të prekte në tokën shqiptare, shpëtoi për mrekulli. Historia shqiptare është pa dyshim më e veçanta edhe për faktin se shumica e fisnikëve shpëtimtar të hebrejve ishin musliman, ndonëse kishte gjithashtu edhe ortodoks dhe katolikë.

Një fakt tjetër tejet i veçantë është ai që nuk gjëndet asnjë rast ku shqiptarët të kenë pranuar kompensime për fshehjen e hebrejve. Megjithëse ende nuk ka ndonjë studim statistikor mbi origjinën e hebrejve që shkelën në Shqipëri,

rezulton se shumica e të huajve të fshehur në këtë vend ishin nga vendet kufitare me Jugosllavine. Veçantia e Shqipërise si një strehë e hebrejve bie edhe më shumë në sy po të kemi parasyshë faktin se më pak se dhjetë përqint prej shatëdhjetë mije hebrejve të Jugosllavise arritën t'i shpetonin Holokaustit.(1)

Ka edhe diçka tjetër që e bën situatën në Shqipëri më të ndryshme nga vendet e tjera. Koha gjatë së cilës hebrejtë kanë qenë të kërcënuar nga rreziqet më të mëdha, ka qenë prej vjeshtës së vitit 1943 deri në tetor të vitit 1944. Si në asnjë vend tjetër të pushtuar, Shqiperia kishte brenda kufijve të vet më shumë hebrej

në fund të luftës se sa në fillim të saj.

.....

Ndersa vetë djalli rendte si i çmendur nëpër Europën e pushtuar nga fashizmi, Shqipëria ishte kthyer, siç e quante një hebre i shpëtuar aty, në një "kopësht të Adamit" për refugjatët hebrej. Më poshtë do të gjeni atë çfarë i ndodhi një familje hebreje, refugjate nga Jugosllavia.

Kur gjermanët i vunë në jetë ligjet raciste, kjo familje me identitet të fallsifikuar shkoi për të shpëtuar në Jugosllavinë Jugore e cila ishte aso kohe nën kontrollin italian. Italianët e arrestuan për hyrje ilegale dhe e vendosën në një kamp- burg, ku gjëndeshin edhe familje të tjera hebreje. Italianët ishin njerzorë në trajtimin që u bënin hebrejve në këtë kamp familjesh dhe nganjëherë i lejonin burrat që të punonin në tregëti ose në profesionet e tyre. Edhe fëmijëve të të burgosurve u lejohej që të loznin me femijët e rojeve.

Shqetësimet filluan bashkë me ankesat për mbi-popullim të kampit. Kur hebrejte u ankuan, italianët ua bënë të njohur këtë gjermanëve të cilët u paraqitën të gatshëm për ta trajtuar çështjen siç dinin ata. Të nesërmen, ata shkuan tek kampi, morën gjysmën e hebrejve që ndodheshin aty, i dërguan tek

një pyll afër Prishtinës dhe i pushkatuan pa as më të voglën mëshire. Kjo ndodhi në atë pjesë të Jugosllavisë të cilën gjermanët e quanin territor i aneksuar.

Italianet u ndien dukshëm fajtor për këtë dhe si për tu shfajsuar i trafikuan hebrejtë e mbetur në Shqipërinë e pushtuar në atë kohë vetëm prej trupave të tyre. Kjo u krye me makina transporti ushqimesh duke i fshehur njerëzit nëpër thasë.

Nga ferri i tmerreve nëpër Europe, ata po shkonin drejt një bote tjetër - drejt një ishulli mistik që quhej Shqipëri. Të gjendur në këtë vend të panjohur për ta, të rrethuar nga mikëpritja tradicionale shqiptare ata panë me sytë e vet dallimin midis ferrit dhe parajses.

Naftali tregon këtë histori: "Unë isha në atë kohë një djalë i të katërmbëdhjetave. Ne shpëtuam nga Serbia e pushtuar, kaluam nëpër Bullgari e prej andej në provincën

.....

Kosoves (në territoret e aneksuara) ku u ndesha me një pritje të tmerrshme. Gjermanët ushtruan trysni ndaj italianëve për të na arrestuar. Kështu e gjitha familja jonë përfundoi në burg. Atherë në pamë anën më të shndritshme të shqipëtarve. Një grup gjykatësish shqipëtare erdhën dhe kërkuan që të bëhej zhvendosja e refugjatëve më në jug të vendit. Ata e bënë këtë për të shpëtuar jetët tona dhe për t'ja arritur kësaj na transferuan në Kavaje.

Tri makina të mbushura plot me hebrej arritën në Kavaje në një ditë pazari. Mihali, i cili ishte 17 vjeç në atë kohë, e mori familjen time dhe e vendosi tek

një hotel i vogël, pronë e familjes së tij duke na dhënë edhe ushqime. Ai më punësoi si pjatalares. Më të mbërritur ne, erdhën gjermanët kështu që na duhej patjeter të iknim për Tiranë. Por për të shkuar atje duheshin dokumente. Dihet tashmë se si Mihali i mori dokumentet ne polici per ne.

Historia e Mihal Lakatarit

Në vitin 1942 refugjatë hebrej të liruar nga burgjet italiane u dërguan në Kavajë. Familjet hebreje nuk kishin pasaporta shqiptare gjë që përbënte një problem serioz. Mihal Lakatari, një djalë ortodoks 17 vjeçar e kuptonte rrezikun që u kanosuj atyre familjeve.

Një mëngjes heret, ai u armatos dhe shkoi tek posta e policise pasi pandehte se nuk do të gjente njeri në punë aq heret por u befasua kur gjeti aty një sekretar. Megjithatë, falë guximit që e karakterizonte, i mori të gjitha kartat e identitetit, rreth 50 copë, dhe e porositi sekretarin të mos fliste në se e donte veten dhe familjen.

Refik Veseli me shokë të tjerë i siguruan fotografitë e nevojshme për pasaportat por prapëseprapë ato nuk mund të përdoreshin pasi nuk kishin as vula të njoma as të thata. Mihali iu kthye edhe një herë postës së policisë dhe i siguroi ato.

Kur ndodhi kjo, Mihali ishte nxënës në shkollën pedagogjike. Përse e beri ai këtë veprim? Përgjigja e tij vjen gati një gjysmë shekulli më vonë: Nuk ka arësye fetare që më shtynë ta beja këtë. Unë u përpoqa t' i shpëtoja ata njerëz pasi ishin në situatë tmerrësisht të rrezikshme. Për mua s'kishte asnjë rëndësi se çfarë feje apo kombësie kishin. Ne i deshëm ata njerëz. Mirënjohja që shfaqin ndaj meje më bën të lumtur. Ky është shpërblimi më i madh.

Një prej përdoruesve të këtyre dokumenteve fallse e ruan edhe sot e kësaj dite fotografinë e cila i ishte bashkëngjitur "kartes" së tij dhe e quan atë si dhuratën më të çmuar e më të bukur që ka marrë ndonjëherë. Ai e përqafon Mihalin dhe i thote: "Flori, Ju, familja juaj dhe tërë populli shqipëtar jeni flori i pastër." Nuk është për tu çuditur pse hebrejtë shpëtuan nga treni i vdekjes. Njerëz si Mihali e bënë këtë. Ai tanimë është nderuar me titullin Fisnik.

Familjet Veseli dhe Mandili

Moshe Mandili dhe familja e tij ikën prej Beogradit ku kishin lindur dhe u ndjenë pak a shume më të sigurtë në internim në një kamp në jug të Jugosllavise i cili ishte nën kontrollin italian. Mbasi qëndruan për më se nje vit të internuar, kjo familje si dhe 120 bashkëvuajtës të tjerë dolën nga kampi dhe shkuan në Shqipëri.

Refugjatët hebrej jetonin në një farë sigurie relative deri në vjeshten e vitit 1943, kohë kur forcat pushtuese italiane ua lëshuan vendin atyre gjermane. Kur këta të fundit e morën plotësisht fuqinë, Refik Veseli vendosi që të shtatë hebrejtë të cilët i fshihte në Tiranë t'i siguronte pranë prindërve të tij në vendlindje. Atyre iu dhane dokumentet e nevojshme, i veshën me rrobe fshatarësh dhe iu vunë emra musliman. Refiku iu tha atyre se do të ishte më mire po të ecnin në këmbe në një rrugë rreth 50 kilometra se sa të zinin ndonjë autobus i cili vërtetë i dërgonte shpejt por mund t'i rrezikonte në se ndodhej dikush që e kuptonte këtë. Në atë kohë edhe ai vet nuk ishte i sigurte se si do të reagonin njerëzit ndaj një veprimi të tillë. Ai nuk deshi të merrte përgjegjësi të panevojshme megjithëse koha vertetoi se ky rrezik ishte shume i vogel në mos nuk ekzistonte fare.

Familjet Mandili dhe ajo e Ben Jozefit të cilët përbëheshin prej pesë të rriturish dhe dy fëmijesh u fshehën në shtëpinë e prindërve të Refikut në

.....

Krujën malore deri në mbarim të luftës. Refiku e ndjeu se prinderit e tij patën një farë ngurrimi për t'i marrë këta njerëz të çuditshëm në shtëpi, por më vonë ata u bënë si njerëz të një shtëpie. E vërteta është se nuk mund të ndodhte që një shtepi e tillë të mos pranonte miq.

Përveç rrezikut që u kanosej për vete nga gjermanët, tani u shtohej edhe problemi tjeter, ai i strehimit të shtatë njerëzve të huaj që jetuan në shtëpine e tyre për një kohë të gjatë. Kjo familje u dha strehë atyre për një vit të tërë. Rreth pesëdhjetë metra larg shtëpisë së Veselëve ishte një shpellë ku hebrejtë e rritur fshiheshin sa herë thuhej se po vinin gjermanët. Ata kurrë nuk dalluan tek mirëpritësit ndonjë farë bezdie. Interesant është fakti se familja shqiptare kurrë nuk pranoi të merrte qoftë edhe një qindarkë si shpërblim për shpenzimet e bëra për mbajtjen e miqve.

Pas luftës Refiku shkoi në Beograd për të bërë një vizitë tek Mandilët ku mësoi artin e të fotografuarit në studion e tyre. Më pas ai hapi studjon e vet në Tiranë.

Letrat qe Mandili dërgonte pandërprerë u bënë baza dokumentare që çoi në nderimin me titullin Fisnike midis Kombeve të familjes së Veseleve, prej Yad Vashemit. Ata ishin të parët shqipëtar në mos të parët muslimanë që u nderuan me këtë titull prej Yad Vashemit.

Atif dhe Ganimet Toptani.

Si shumë familje të tjera shqiptare edhe Toptanët ishin dashamirës të kulturës gjermane por jo të nazizmit. Si njerëz fisnikë që ishin ata i ndihmuan kauzës së aleateve. Ata gjithashtu bënë sakrifica për tu shpëtuar jetën e hebrejve

Gjatë një operacioni të gjermanëve kundër forcave partizane, një kolonel i misionit ushtarak britanik ishte plagosur seriozisht. Ai gjeti strehë në Kamëz në familjen e Toptanëve. Po kjo familje strehoi në shtëpine e vet edhe familjet Altarak dhe Levi, edhe pse ishte e para herë që takonin një familje hebreje.

.....

Edij Toptani ishte dymbëdhjetë vjeç kur u shoqërua me Jashan dhe Mikan. Antaret e familjes Toptani janë nderuar gjithashtu me titullin Fisnikë.

Sulo Maçaj

Sulo Meçaj ishte nga Kruja. Ai jetonte me djalin dhe gruan në një shtëpi të vogël që ua kishte lënë trashëgim babai. Në vitin 1943 ai e hapi derën e shtëpise për dhjetë hebrej midis të cilëve kishte edhe pjestarë të familjes Battino. Djali i Sulos tregon se çfarë ndodhi kur erdhën gjermanët në Krujë "Babain e lajmëruan se gjermanët po vinin tek shtëpia jonë për të kontrolluar për hebrej. Ai u tha miqve që sapo të jepte një sinjal, ata duhej të shkonin zvarrë tek një vend që ai e kishte përgatitur posaçërisht për ta, nën çati. Miqte i kapi paniku por babai u përpoq t'i bindtte se ata kurresesi nuk do të zbuloheshin. Njëri prej tyre e pyeti atë se çfare do të ndodhte në se gjermanët do ta digjnin ndërtesën. Për t'i siguruar, babai më urdhëroi mua, të vetmin djalë që kishte, të shkoja nën çati bashkë me të duke ndarë të njejtin fat nëse shtëpia do të digjej prej gjermanëve. Im atë nuk mund të zgjidhte rrugë tjetër. Kjo ishte çështje nderi për të"

Pyetja se si e ndjeu djali i Sulos veten kur e urdhëroi babai që të rrezikonte jetën bashkë me hebrejtë, i shkakton njefarë hutimi dhe më pas përgjigjet se kjo

ishte e vetmja gjë që mund të bëhej në ato çaste. Pyetjes tjetër se a do ta bënte edhe ai vetë atë që bëri i ati, ai i përgjigjet: "Pa as më të voglin dyshim" Nipi i Sulos i cili po e dëgjonte këtë histori dha të njejtën përgjigje. Që të dyve iu erdhën të habitshme pyetjet rreth kësaj çështje.

Ndodhi edhe një ngjarje tjetër në Krujë e cila i trembi të dya palët, edhe hebrejtë edhe mikëpritësit e tyre. Kur partizanët e morën qytetin, filluan të vallzonin në rrugë. Hebrejte menjëhereë dolën prej vendeve të fshehta dhe iu bashkuan turmës që po festonte fitoren. Pak ditë më vonë gjermanët kundragoditën dhe e rimorën Krujën. Të gjithë banorët e qytetit tashmë e dinin se hebrejtë kishin dalë nga familjet Meçaj e Veseli.

.....

Çështë e vërteta, për një farë kohe hebrejtë ndjeheshin shumë të shqetsuar pasi ende nuk e dinin se çfarë ishte ajo mburojë e shenjtë që i ruante e që shqiptarët e quajnë BESA.

Nëqoftëse ndonjë nga banorët do tu tregonte gjermanëve për musafiret e çuditshëm atëhere spiuni do të të ekzekutohej por nga ana tjetër familjet qe i mbanin do të përziheshin nga vendlindja dhe do tu mbetej njolla e turpit përjetsisht.

Familja Nosi

(Vasili dhe motra e tij Adelina)

Në mars të vitit 1943 hebrejtë e ardhur nga Maqedonia u dërguan në kampin e vdekjes, Treblinka. Marko Menahen, një hebre maqedon e humbi tërë familjen dhe pas kësaj ai gjeti shpëtim në Shqipëri. Në fillim ai shkoi ne Tirane, por kur e mori vesh se gjermanët po e kërkonin ia mbathi për në Elbasan. Ai u strehua tek familja Nosi të cilët e punësuan si kimist në një fabrikë të tyre. Marko kishte dokumente fallso dhe e paraqiste veten si musliman, por ndodhi që në një dasëm të diktohej dhe u arrestua nga gestapo.

Vasil Nosi njihte një oficer madhor të Gestapos që kur ishte student në Austri. Gjermani ishte alkolist. Vasili diti ta shfrytëzonte këtë dobësi të tij. Gjermani e lëshoi Markon prej burgut "vetëm për këtë herë" dhe e solli në shtëpinë e Nosëve.

Markon e çuan menjëherë në fshatin Lixha ku e mbajtën të fshehur në një hotel të braktisur deri në çlirimin e plotë të vendit. Gjatë asaj kohe ai shihte vetëm Adelina Nosin e cila i sillte rregullisht ushqimin. Pas luftës, Marko u përgatit të shkonte në Izrael pasi kishte një vizë të përdorshme por nuk qe e thënë pasi komunistët e arrestuan Vasil Nosin. Marko dhe vellai i Vasilit u përpoqën që ta nxirnin Vasilin nga burgu por ata përfunduan për vete në pranga. Vasili vdiq në burg ndërsa Marko vuajti katër vjet ne burgjet komunsite thjesht për ndërhyrjet dhe përpjekjet që kishte bërë për të liruar shokun e vet.

Kur Marko doli nga burgu, viza e tij dalëse kishte skaduar, ndërkohë që qeveria komuniste e Enver Hoxhes nuk e lejonte emigracionin për Izrael. Kështu ai u kurthua plotësisht.

.....

Atij iu shty vajtja në Izrael deri në vitin 1991, 41 vjet pas përpjekjes së parë ndërsa pjestarët e familjes Nosi pas një kalvari të gjate vuajtjesh i gezohen titullimit: Fisnikë.

Beqir Qoqja

Avraham Eliasaf (i cili mbante emrin musliman, Gani) jetonte në rrobaqepsinë e mikut të tij, Beqirit në Tiranë. Kur gjermanët filluan një spastrim ndaj hebrejve ata menduan se ishte më e sigurtë që të dërgonin Avrahamin në një fshat të largët ku ai do të "shpëtonte" si musliman. Avrahami kishte disa monedha floriri te cilat ia dhe Beqirit për ta ndihmuar. Pas çlirimit, Beqiri ia ktheu mikut të tij florinjtë duke refuzuar çdo lloj kompensimi.

Beqiri e vizitoi Izraelin më një grup fisnikësh por ata nuk arritën që të takoheshin përsëri, pasi Abrahami vdiq vetëm pak kohë para vizitës. Edhe Beqiri është nderuar me titullin fisnik.

Ky nuk është një rast i vetëm kur pasuritë u janë kthyer hebrejve pas luftës. Nadire Buxhiu iu ktheu hebrejve të gjitha vlerat që ata i kishin besuar. Haim David i la disa objekte arti me vlera të mëdha Haxhi Mulla Deliut. Haimi nuk jetoi e megjithatë Haxhiu ia ktheu objektet vajzes se tij edhe pse duket se ajo nuk kishte dijeni për këtë. Në një rast tjeter si ky, zonja Qirko u dha djemve të Samuel Matathias, të gjitha gjërat e vlefshme që babai i tyre ia kishte besuar asaj.

Prefekti i Vlorës, një figurë e rëndësishme në ditët e pushtimit italian, mori disa mallra të zgjedhura tek dyqani i Pepe Levit. Pepe i tha prefektit që të mos shqetësohej për pagesen pasi mund ta bënte atë kur të donte. Kjo në gjuhën e tregtarit do të thoshte: asnjeherë! Prefekti kishte fuqi që t'i arrestonte të tërë

hebrejte dhe tu konfiskonte tërë pasuritë. Praktikisht ai mund të kishte marrë ndonjë gjë qe i duhej. Ai u ndie shumë i fyer

.....

dhe iu pergjigj atij: Dëgjo Pepe Levi! Unë kam qenë miku yt dhe këtë nuk e kam fshehur kurrë. Në qoftëse ju mendoni se unë këtë e kam bërë për të përfituar ndonjë gjë, jeni gabuar rëndë. Tani, më jepni çmimin, përndryshe do t'ju trajtoj si hasmin tim.

Metin, Azis dhe Shpresa Ruli - Ali Kuci

Shpresa Ruli me prindërit e saj, Metin e Azis Ruli si dhe Ali Kuci zunë shoqëri të madhe me Solomon Komfortin dhe gruan e tij të cilët kishin një vajzë të sapo lindur. Aliu siguroi karta fallso ndërsa familjet e Rulëve dhe Kucëve i morën Komfortët nën "mbrojtjen e tyre". Gjatë një periudhe prej shtatë muajsh, ata i zhvendosën Konfortet nga një vend në tjetrin, atje ku Rulet mundnin t'i mbronin ata.

Një ditë Solomoni shkoi në qytet dhe papritmas u arrestua. Familja hebreje kishte dokumente që vertetonin se ishin muslimanë. Duke përdorur njohjet personale, familjet muslimane ia dolën që t'i lëshonin nga burgu duke këmbengulur se ai ishte i vëllai i Aliut. Qëndrimi në Tiranë u bë shumë i rrezikshëm. Prandaj ata u dërguan në një qytet të vogël. Në Shatator të vitit 1944, familja Komfort u largua për në Milano pa pësuar gjë dhe në janar të vitit 1945 u kthye në Jugosllavi e më pas në Izrael. Këto familje edhe pas pesëdhjetë vjetësh vazhdojnë korespendencën me njëra tjetrën.

Aliu ishte anti-komunist i njohur. Ai u torturua dhe u vra prej komunistëve në vitin 1945. Djali i tij erdhi bashkë me grupin e shqiptarëve në Izrael dukë përfaqësuar familjet e Rulëve dhe të Kucëve.

Familja Budo

Vajza e tyre Sado Xhyheri fshehu katër hebrej. Riketa Goni, Viktor Jakoel, Eftimi Jakoel dhe David Matathia. Sadoja do të kalonte thuajse tërë kohën me ta, duke i inkurajuar dhe mbajtur lart moralin. Kjo miqësi njerëore vazhdoi me vite të tëra.

Familja Batino qëndroi e fshehur për 40 dite.

.....

Pas bombardimit të qytetit nga gjermanët, qëndrimi i mëtejshëm u bë i pamundur, kështu ata u vendosen në një qytet të vogël por më të sigurtë. Nuk ishte e pazakonshme për hebrejtë që të "pasoheshin" nga një shpëtimtar i tyre tek një tjetër. Kjo bënte që të kishte më shumë se një person ose një familje që ndihmonte për shpëtimin e tyre nga nazizmi e që njihen edhe ata si Fisnike.

Besim e Aishe Kadiu

Gjatë pranverës dhe verës së vitit 1944, që ishte edhe koha më e rrezikshme, familja Kadiu i hapi derën dhe e strehoi një familje hebreje.

Shyqyri Myrto

Shyqyriu ishte një shok i ngushtë i Josef Jakoelit. Në mars të vitit 1944 u ndërmor një "kontroll" nga gjermanët në një përpjekje për t'i mbledhur të tëra kartat e identitetit që mbanin hebrejtë. Hapi tjetër do të ishte përzënja e tyre. Shyqyriu i fshehu Josef Jakoelin dhe motrën e tij Eriketa nga marsi deri në nëntor 1944.

Një natë erdhën gjermanët. Ata dukej se kishin ndonjë informacion për hebrejtë që fshiheshin tek Shyqyriu. Dera nuk u hap deri sa Josefi u largua. Eriketa u vesh me rrobat karakteristike të Shqipërisë së Mesme dhe u fsheh në odën e grave ku hyrja e burrave ishte e ndaluar. Gjermanët u bindën të mos futeshin në atë dhomë pasi iu spjegua kjo traditë e vendasve.

Pesëdhjetë vjet me vonë, duke ndenjur në një dhomë të rehatshme në Izrael, Shyqyriu dhe shoku i tij Beqir Qoqja bisedonin për ngjarje të atyre viteve të vështira. Shyqyriu, tani tetëdhjetë vjeç me një beretë të vjetër në kokë, i mbështetur tek shkopi i tij dëgjonte tregimet e vajzës së Josef Jakoelit se si i kishte shpëtuar babai. "Në kulmin e terrorit gjerman ai i dërgoi babain dhe hallën nga një shtëpi në tjetrën, nga një oborr tek tjetri, nën hundën e nazistëve të cilët gjuanin për hebrej deri sa gjeti një vend të sigurtë për ta." Sytë e saj shkëlqenin nga admirimi për burrin që e nxori babain dhe hallën e saj nga kthetrat e sigurta të vdekjes.

.....

Ne i pyetëm këta dy pleq musliman se përse i kishin bërë këto gjeste kaq fisnike. Beqiri, si njeri i thjeshtë që ishte fliste mjaft rrallë dhe përgjigjej shkurt:

" Ai është miku im". Ndërsa Shyqyriu ndërhyn: "Ndoshta ju mendoni se ne e bëmë këtë për humanizëm. Feja jonë muslimane na mëson që të ndihmojmë gjithkënd që është në pozitë të vështirë ose në rrezik." Beqiri nuk ishte i një mëndje me të: " Kjo nuk ka asgjë të bëjë me fenë. Ne të gjithë kemi një zot dhe ai ka urdhëruar që t'i ndihmojmë njëri tjetrit. Të njejtën gjë thotë Jezusi, të njejtën gjë urdhëron Muhameti, të njejtën gjë predikon edhe Moisiu."

Fisnikë të tjerë jo-hebrej.

Më shumë se tetëdhjetë hebrej kalimtarë, shumica të panjohur për Nadire Bixhiun kaluan në shtëpine e saj duke gjetur gjithnjë një vend të sigurtë. Hoxhë Ferri iu priu shumë hebrejve për në fshatin Zall Herr ku ai kishte një shtëpi mjaft të madhe. Aty ushqehej gjithnjë një turmë e përbërë thuajse prej tetëdhjetë vetësh ndër të cilët kishtë edhe ushtarë italianë të cilët u larguan nga ushtria e tyre e shpartalluar.

Familja Solomon dhe të tjerë u fshehën në shtëpinë e Nuro Hoxhës në Vlorë. Si masë paraprake sigurie u bë një transhe ku mund të rrinin të shtatëmbëdhjetë miqtë e familjes Hoxha. Të shtatëmbëdhjetët ndejtën në këtë shtëpi për tre muaj.

Në vitin 1940, Vjera Matuseviç dhe familja e saj prej shtatë antarësh u gjendën në Tirane. Ata u strehuan në Zall Herr. Ushqimin ua çonte Mikel Kilica. Gjermanët e pikasën se çfarë bënte Mikeli prandaj ai u detyrua t'i hiqte prej aty dhe i dërgoi në Manastirin e Ardenicës. Prifti i manastirit i paisi ata me pashaporta fallso. Por edhe aty ranë në sy, ndaj u detyruan që t'i kthenin përsëri në Tiranë, kësaj radhe në shtëpinë e Vasil Bidoshit ku edhe qëndruan deri në çlirimin e vendit.

Disa prej refugjatëve u dërguan në Berat me urdhër të autoriteteve shqiptare. Ishte fati që i ndihmoi pasi njerëzit e mirë të Beratit si Abdullah Shkodrani,

Xhevdet Gjergjani dhe të tjerë i ushqyen dhe i mbajtën fshehur për një kohë të gjatë.

55

.....

Toli dhe Todi nga Kavaja strehuan Jozef Adixhedin ndërsa vëllezerit Gjata nga Fieri, morën në mbrojtje Mosha Basarin.

Abdullah Shkodrani i dha strehë Rashel Davidit ndërkohë që në Shkodër Xhevdet Bekteshi i shpëtoi jetën Jashar Barukoviçit.

Në shkurt të vitit 1942, fahistët i urdhëruan autoritetet shqiptare që të arrestonin e t'i dorëzonin tërë hebrejtë që e kishin kaluar kufirin fshehtas nga Serbia. Kryetarët e bashkive u urdhëruan që të siguronin informacion për të gjithë hebrejtë kalimtarë në qytetet që ata drejtonin. Të gjithë kthyen të njejtën përgjigje: "Në qytetin tonë nuk ka hebrej", ndonëse e dinin se në çdonjërin qytet kishte mjaft prej tyre.

Fillimi i vitit 1944 nuk ishte ai i një viti të mbarë. Që në ditët e para, gjermanët arrestuan një grup qytetarësh nga Vlora. Ata erdhën në mes të natës dhe kryen arrestime sipas një liste të përpiluar që më parë. Të gjithë të arrestuarit u dërguan në kampe përqëndrimi. Disa u vranë në qytetin Resnje të Jugosllavise. Shtatëqint vetë u arrestuan atë natë prej të cilëve vetëm disa u kthyen të gjallë. Midis tyre nuk pati asnjë hebre. Edhe një hebre që u muar, u lëshua pas ndërhyrjes që bëri dikush për të. Nazistët shkonin sipas motos: Lërini hebrejtë se na duhen për një kohë të veçantë.

Në një natë shkurti të vitit 1944, nazistët vranë nëntëdhjetë vetë kudo që gjëndeshin, në shtëpi, në rruge e gjetkë. Nazistët kërkuan shtëpi më shtëpi për

hebrej, i mblodhën dokumentet e tyre dhe i urdhëruan që të paraqiteshin tek zyrat e SS - ve brenda dy ditëve. Hebrejtë e dinin se po ta kalonin atë prag s'do të ktheheshin më kurrë të gjallë prej andej. Prandaj menjëhere u paisën me dokumente fallso nga miqte e tyre shqiptare.

Nuk mund të tregohet çdo gjë në detaje; ka ende shpetimtarë të cileve nuk u është bërë e njohur vepra që kanë kryer. P.sh. E shoqja e Fatlli Imamit, Irena, me origjinë sllave i fshehu miqtë hebrej të cilët ajo i njihte që përpara luftës. Numri i hebrejve të cilët po kërkonin vend për tu fshehur erdhi duke u rritur, aq sa erdhi një moment kur shtëpia e tyre e vogel nuk mbante dot më. Fatlliu dhe e shoqja nuk donin të refuzonin asnjë prej tyre prandaj tërhoqën në këtë vepër fisnike edhe familje të tjera.

.....

Hebrejtë ishin shpërndarë nëpër shumë fshatra dhe qytete të Shqipërise si në Lushnjë, Shijak, Kavaje, Berat, Fier dhe Kruje. Disa prej hebrejve gjetën përkrahje prej shokëve të tyre me të cilët njiheshin që prej shume kohësh. Të tjerët gjetën ndihmë prej njerëzish që nuk i kishin takuar kurrë deri në ato momente kur trokitën në dyert e tyre.

Megjithëse hebrejtë e Shqipërisë mbijetuan, ata prapëseprape pësuan humbje të rënda. Shumica prej tyre kishin të afërt në Janinë dhe në Korfuz por vetëm pak prej atyre që jetonin atje, shpëtuan. Vetëm dy shpëtuan prej familjesh njëzet antarëshe të Zhaneta Solomonit. Jakoeli humbi motrën njëzet e pesë vjeçare së bashku me dy femijët: vajzën pesë vjeç dhe djalin dy vjeç. Motra e tij qe martuar me një burre prej Korfuzi ku kishin ngritur shtëpinë. Dihet tashmë se çfarë ndodhi me hebrejtë në atë ishull.

.....

Kapitulli i Nëntë

Të mbijetuarit tregojnë jetën e tyre

Johanna Jutta Neumann

Prindërit e mij dhe unë erdhëm nga Gjermania në Shqipëri në vitin 1939. Ne ishim të lumtur që morëm viza shqiptare. Kaluam nëpër Itali dhe arritëm në Durrës brenda një nate. Kur arritëm gjetëm gjashtëdhjetë emigrantë të tjerë në Durrës dhe Tiranë. Tre javë më vonë Italia e pushtoi Shqipërinë. Në Shtator të vitit 1940, së bashku me emigrantë të tjerë, u evakuam për në Berat ku morëm një dhomë me qera. Në atë kohë ne kishim shumë pak para por gëzonim një ndihmë të vogël nga qeveria shqiptare. Familja muslimane që na e lëshoi dhomën me qera na ndihmoi shumë bujarisht veçanërisht me ushqime. Miqësia dhe mikëpritja që na afruan ishte një përvojë e mrekullueshme në atë vend.

Britanikët e bombarduan Beratin për ditë të tëra ndërkohë që ne siguruam një leje për tu vendosur në Lushnje ku qëndruam deri në qershor të vitit 1941.

Babai ishte piktor amator dhe bënte peisazhe nga natyra e më pas i dërgonte për shitje nëpër dyqane. Në verën e vitit 1941, një leje tjetër na dha mundësinë që të vendoseshim në Durrës. Aty morëm një dhomë me qera në Shkozet. Në shkurt të vitit 1942, dy italianë tentuan që të hynin me forcë në apartamentin tonë. Pronari i banesës, hapi një dalje nëpërmjet murit që na ndante. Kështu në rast rreziku ne mund të kalonim nëpër shtëpinë e tij, nëse kjo shihej e nevojshme.

Një polic shqiptar i pikasi prindërit dhe i kishte arrestuar ata. Inxhinjer Pilku dhe gruaja e tij Sharlota të cilët ishin qeradhënësit dhe miqtë tanë të parë që zumë në Shqipëri ia dolën që t'i lironin vetëm pas disa ditësh.

.....

Kur gjermanët erdhën, në vitin 1943, ne u fshehëm menjëherë. Babai, të cilin mund ta dalloje lehtë se ishte hebre, shkoi në Krujë. Nëna dhe unë shkuam në shtëpinë e Pilkëve dhe kërkuam të bëheshim antarë të familjes gjermane të Sharoletëve.

Asgjë nuk na ndodhi deri në verën e vonë të vitit 1944, përpara se gjermanët të na gjenin e të na dërgonin tek shtabi i SS - ve për të na rregjistruar. Ne ndjeheshim të qetë sa kohë që gjermanët ishin të zënë në luftë me partizanët e nuk kishin kohë të merreshin me ne. Në nëntor ata u shporrën nga Shqipëria dhe ne u çliruam. Ne shpëtuam vetëm në saje të guximit,miqësisë dhe mikpritjes së popullit shqiptar. Shqipërinë e lamë në shtator të vitit 1945.

C'thotë Dr. Ana Kohen

Familja ime ishte nga Janina. (Vetëm 10% e bashkësisë hebreje atje,shpëtoi) Shkuam në malet e Vlores, i ndërruam emrat në muslimanë dhe u përziem në mënyrë të padallueshme me vendasit të cilët na pranuan dhe na trajtuan si vëllezerit dhe motrat e tyre.

Irenë Grunbaunn

Në një libër të kohëve të fundit në të cilën përshkruan përshtypjet e saja si hebreje në kohën e luftës, në Shqipëri, Irenë Grunbaum i bën homazh popullit shqiptar. Në paragrafin e fundit rreth Shqipërise ajo shkruan:

"Lamtumirë Shqipëri, thashë me vete. Ju na dhuruat kaq shumë mikpritje, strehë, miq dhe aventura. Lamtumirë Shqipëri! Një ditë do t'i tregoj botës se sa trima, besnikë e bujar, të fortë e të pathyeshëm janë djemtë tu. Aq trima, sa as vdekja as djalli s'mund t'i trembë ata. Nëqoftëse do nevoitet, unë do të tregoj se si ata i mbajtën refugjatët, se si nuk lejuan që dikush t'i prekte ata edhe atëherë kur e vunë jetën e tyre në peshoren e vdekjes. Portat e vendit tuaj të vogël mbeten hapur, Shqipëri. Autoritetet tuaja i mbyllën sytë kur kjo nevoitej, që tu jepnin njerëzve të rrezikuar një shans për t'i shpëtuar njërës nga luftrat më të tmerrshme. Shqipëri, ne e çamë rrethimin vetëm në saje të humanizmit tënd. Faleminderit.!"(1)

.....

Ndjenjat e shprehura nga zonja Grunbaum gjetën jehonë tek hebrejt e tjerë. Fill pas mbarimit të luftës, bashkësia hebreje në Jugosllavi nderoi dhe falenderoi popullin shqiptar për humanizmin e treguar. Një inxhinjer hebre transmetoi një mesazh në radio ku falenderoi tërë popullin shqiptar. Ai citohet të ketë thënë: "Shqiptarët, falë natyrës së tyre liberale e kanë gjykuar gjithmonë tjetrin në bazë të meritave personale dhe kanë qënë vazhdimisht të mëshirshëm ndaj njerëzve të shtypur dhe të mjerë."

Ai vazhdon: "Të gjithë hebrejtë që e lanë Jugosllavinë, të shtrënguar nga gjermanët, gjetën shtëpi të hapura dhe njerëz bujarë në Shqipëri."

Pse?

Si mund të spjegohet fakti që refugjatët hebrej në Shqipëri, përfshirë edhe ata që erdhën nga jashtë gjetën të njëjtën mbrojtje brenda kufijve të atij vendi? Përse shqiptarët e morën përsipër rrezikun duke i shpëtuar hebrejtë? Përgjigja gjendet sa tek kodi moral i shqiptarëve, i njohur si "Kanuni" aq edhe tek koncepti i njohur shqiptar, "Besa".

Ka edhe përgjigje të tjera të mundshme por ngado që t'i kërkojmë ato gjithnjë mblidhen në një: Hebrejtë e Shqipërisë njiheshin si shqiptar. Ata vlerësoheshin si vendas. Vetëm disa prej tyre flisnin hebraisht ose ladino. Ata flisnin shqip dhe greqisht dhe nuk e veçonin veten nga shqiptarët, ndonëse përpiqeshin që jetën dhe fqinjësinë ta bënin me njëri tjetrin.

Hebrejtë ishin profesionalisht të mësuar dhe me përvojë të madhe në tregti dhe kjo shkonte në proporcion me numrin e tyre. Por ata nuk ishin aq shumë sa të përbënin ndonjë problem siç ndodhte në disa vende të tjera ku në fusha të tilla si tregtia dhe profesionalizmi ata binin menjëherë në sy.

Po të bëhet një krahasim i mardhënjeve të hebrejve shqiptarë me shqiptarët vetë, dhe i mardhënjeve të hebrejve të Selanikut me selanikasit e tjerë del se Holokausti mori jetën e më shumë se 90 % të hebrejve të Selanikut kundrejt asnjë jete hebrei në Shqiperi

.....

Ata pak hebrej të Selanikut që shpëtuan, shpëtuan thuajse falë fisnikëve grekë të cilët rrezikuan jetën e tyre për të shpëtuar miqtë ose shokët e biznesit. Ekstremet e shifrave, 100% të shpëtuar në Shqipëri dhe vetëm 10% në Selanik përbën një fushë kërkimesh të pasur për historianët.

Eshtë vënë re se sa me i vogël të ketë qenë numri i hebrejve në një bashkësi, aq më shpejt ata janë shoqëruar me vendasit dhe aq më të pranueshëm kanë qënë.

Në kohën e luftës, në Shqipëri popullsia hebreje vërtitej tek numri 800 vetë por mund të ketë shkuar edhe 1.000. Ata përbënin rreth 1% të popullsisë. Në Selanik ata përbënin diçka rreth 30 dhe 40 %. Mirëqënja e tyre ishte e lakmueshme çka nuk përbënte ndonjë faktor pozitiv për ta. Ajo që i dallonte dukshëm hebrejtë e Selanikut, diçka që haset edhe sot, ishte gjuha e veçantë, ladino. Kjo i ka penguar që të futen në zemrën e selanikasve vendas. Ata nuk u bënë selanikas në atë sens që hebrejtë e Shqipërisë u bënë shqiptar.

Për të arritur tek një studim më bindës do të ishte mirë të bëhej një krahasim në mes të përvojës së hebrejve të Janinës dhe atyre të Shqipërisë. Asnjë fisnik jo-hebre nuk është shpallur i tillë në Janinë. Gjermanët i mblodhën dhe i ekzekutuan brenda një dite hebrejtë e Janinës gjë që nuk iu dha kohë as atyre as miqve të tyre për të ndërmarrë ndonjë veprim siç mund të ishte fallsifikimi i ndonjë pashaporte, gjetja e ndonjë vendi për tu fshehur apo diçka tjetër për të shpëtuar. Në të vërtetë, shpejtësia me të cilën gjermanët i mblodhën hebrejtë në Janinë, le shteg të mendohet se listat ishin përpiluar që më parë. Kush i dha ato lista, nëse ekzistonin? A ishte autoriteti civil që e bëri këtë siç ndodhi në territoret e aneksuara apo kjo lidhet me bashkësinë hebreje si në Selanik?

Politika e qeverisë shqiptare përfshirë këtu edhe atë që e vunë italianët edhe atë qe e vunë gjermanët ishte: t'i mbronte hebrejtë shqiptarë njësoj si vetë shqitarët. Këtu s'kishte dallim.

.....

Rregjenca e emëruar prej gjermanëve kundërshtoi t'i jepte listat ose t'i mblidhte hebrejtë në një vend të vetëm. Ata e vlerësuan këtë si ndërhyrje në punët e tyre të brendshme. Askush nuk e di se si e pritën gjermanët këtë përgjigje. Kjo do të ishte shumë e rëndësishme të dihej por më interesante duket pyetja tjetër: Po hebrejtë e huaj në Shqipëri?!

Midis Shqipërisë dhe vendeve tjera sa i takon mbrojtjes së hebrejve të huaj ka një dallim kuptimplotë. Për shembull, qeveritë franceze dhe bullgare bashkëpunuan me nazistët dhe iu bindën kërkesave të tyre për arrestimin e hebrejve të huaj, por i mbrojtën ata vendas.

Mardhënjet e mira, numri i vogël e argumente të tjerë si këto, të çojnë drejt një përgjigje ndaj pyetjes se pse kishte pak ose aspak anti-semitizëm në këtë vend, por nuk i japin përgjigje pyetjes tjetër se pse shqiptarët rrezikuan kaq shumë për vete për t'i shpëtuar hebrejtë. Nëqoftëse debatojmë në këtë mënyrë duhet të pranojmë se fshehja e tyre kishte një kosto të caktuar. Kjo është e një rëndësie të veçantë po të kemi parasyshë se shpëtimtarët shpeshherë nuk i njihnin fare hebrejtë për të cilët rrezikonin jetën e tyre, bile në shumë raste ata nuk komunikonin dot me ta për shkak të mosnjohjes reciproke të gjuhës.

Kjo na çon tek kodi moral i shqiptarëve i cili është ligji që rregullonte mardhënjet e përditshme midis tyre. Ky kod është një mënyrë jetese në Shqipëri dhe ndryshon nga kodet e popujve të tjerë të cilët e mbajnë në majë të gjuhës por e injorojnë në praktikë. Qëndrimi ndaj refugjatëve ishte: tu sigurohej me çdo kusht jeta atyre që shkelnin në Shqipëri. Eshtë i njëjti koncept si për mikun që shkel në pragun e shtëpisë së shqiptarit edhe për atë që kërkon strehim në vendin e tyre. Në se në rastin e parë përgjegjësia është individuale, në të dytin ajo është kolektive.

Në disa vende të tjera ka dallim midis mbrojtjes që iu bë hebrejve vendas dhe atyre të huaj. Ky dallim nuk u bë në Shqipëri prandaj edhe shpëtuan që të gjithë si vendasit edhe të huajt. Interesante është të shënohet se edhe vetë shqiptarët të cilët bashkëpunuan me gjermanët, për një arësye ose për një tjetër nuk e shkelën kodin e tyre të nderit kur ishte fjala për hebrejtë.

.....

Kodi moral i shqiptarëve

"Nuk ka të huaj në Shqipëri, ka vetëm musafirë" Kodi ynë moral si shqiptarë kërkon që ne të jemi mikpritës ndaj miqve në shtëpitë tona dhe në vendin tonë, thotë Refik Veseli. Kur e pyetëm se a ekzistonte mundësia që ndonjëri të raportonte tek gjermanët për praninë e hebrejve ai përgjigjet: "Çdo gjë mund të ndodhte por në se dikush e bënte këtë ai turpëronte veten, familjen dhe tërë fisin. Për këtë ai do të ndëshkohej rëndë. Më së pakti do t'i digjej shtëpia dhe do

të dëbohej nga vendlindja. Por ky diskutim tanimë nuk ka rëndësi përderisa asnjë shqiptar nuk na turpëroi"

Kodi moral i shqiptarëve i dallon ata nga popujt e tjerë të Europës. Ky populli i vogël i cili jeton në kushte të rënda ekonomike doli si shoqëria me moralin më të lartë nga ditët e shëmtuara të Luftës së Dytë Botërore.

Kodi moral që i udhëhiqte shqiptarët, në të vërtetë zë fill tek malsorët. Me kalimin e viteve ai u mblodh në një Kod Ligjor i njohur me emrin Kanuni. Sipas Antonia Young (2), studjuesit besojnë se Kanuni mund të jetë baza e një sistemi të tërë ligjor. Kanuni njihet tradicionalisht në veri të Shqipërisë por versione të tij njihen edhe në pjesë të tjera të vendit. Enver Hoxha u përpoq që ta nxirrte atë jashtë ligjës por as ky diktator nuk mund ta fshinte atë nga kujtesa popullore.

Kanuni i Lekë Dukagjinit mban emrin e një kreu fisi të shek. XV - të i cili e standartizoi kodin gojor. Kanuni nuk e pa dritën e të shkruarit derisa një prift katolik u përpoq që të bënte këtë më 1913. Ai u vra pikërisht për përpjekjet e bëra në këtë drejtim por ishin priftërinj të tjerë ata të cilët e cuan punën deri në fund. Të 1.262 nenet e Kanunit u botuan në vitin 1933.Kodi përcakton barazi midis besimtarëve shqiptarë me fe të ndryshme.

Më poshtë janë disa prej neneve më të rëndësishme të Kanunit të cilat kanë patur efektin e tyre në fatin e hebrejve që ishin apo që kaluan në Shqipëri.

"***Shtëpia e shqyptarit asht e Zotit e e mikut"***

63

.....

Buka e krypa e zemra, zjarmi e trungu e do firi për shtroje do të gjendet gati për çdo kohë të natës e të ditës.

Fjala "mik" për refugjatët hebrej që i shpëtuan makinës vrasëse naziste në Shqipëri kishte të njëjtin kuptim: mik në vendin e shqiptarëve si në shtëpinë tyre.

Çdo kush ta njohë veten si njeri të mirë vetëm atëhere kur i çmon të tjerët.

Nëqoftëse dikush dështon në përmbushjen e përgjegjësive të tij, sipas Kanunit emri dhe nderi tij marrin fund përgjithmonë. Fjala që ruan nderin është BESA. "Shqiptarët duhet ta ruajnë besën e tyre."

Sipas Hamdi Meçajt, "Besa spjegohet thjeshtë: Në qoftëse një shqiptar e jep fjalën, ai më parë mund të vrasë djalin se sa ta thyej atë" Kjo është e gjitha. Besa është e përjetshme. Nëqoftëse një shqiptar e jep besën dhe nuk e përmbush atë ose mashtron, nderi i tij quhet i humbur." dhe shton: "Kjo është e gjitha".

"I pabesi që pret kënd a shet kënd në besë, grihet katundisht e shkon gjak-hupës."

"Të gjithë janë njësoj përpara Zotit. Si i pashmi si i shëmtuemi kanë të njajtën randsi."

"Mikut i duhet ruejtun ndera edhe me rrezik jete.

Ky nen të bën të mendosh për Refik Veselin kur ai rrinte tek pragu i derës së shtëpisë së tij duke pritur gjermanët të cilët mund të kalonin vetëm mbi trupin e tij të vdekur. Kjo na spjegon pse Mihali shkoi në polici dhe i mori pasaportat për tu dhënë refugjatëve.

Këto janë vetëm disa nene të kanunit por të rëndësishme për t'i dhënë përgjigje pyetjes: Pse?

.....

Shënime:

1.- *Escape Through the Balkans*. Fq.139

"Rishtypur nga *Escape Through The Balkans: Autobiografia e Irene Grunbaum*. Perkthyer dhe botuar me nje hyrje nga Katherine Morris me lejen e shtepise botuese te Universitit te Nebraskes. Copyright 1996 prej Katherina Morris."

2.- Nxjerrë nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, botuar nga ILLYRIA, 1 shkurt 1995, f.6

.....

Kapitulli i Dhjetë

Pas Luftës së Dytë Botërore

Me 8 Nëntor 1941, si reaksion ndaj ideologjisë fashiste u formua Partia Komuniste Shqiptare me Enver Hoxhën në krye. Askush nuk mund të parashikonte në atë kohë se çfarë roli negativ do të luante ky njeri në jetën e vendit të tij për pesëdhjetë vjet.

Në fund të vitit 1944, shqiptarët festuan lirinë e tyre jetëshkurtër. Enver Hoxha udhëheqësi i partizanëve e shpalli Shqipërinë një vend komunist ndërsa vetë u shndërrua në një diktator absolut. Atij nuk iu dridh dora kur vrau e burgosi të tërë kundërshtarët e tij, ndërkohë që përdori një teknikë frikësimi të tmerrshme ndaj popullit, duke e mbajtur atë nën trysninë e frikës nga pushtimi i huaj si rrugë për të mos e lëshuar pushtetin e tij diktatorial.

Syrit të kujtdo që e viziton Shqipërinë sot nuk mund t'i shpëtojë peisazhi i mbushur me bunkjerë që shfaqen në çdo udhëkryq. Dikush thotë se janë mbi 300.000 të tillë, të tjerë thonë se janë 600.000 (Janë 700.000). Këta bunkjerë u ndërtuan për të mbrojtur Shqipërinë nga pushtuesit e huaj duke mbuluar çdo pjesë të vendit. Në të vërtetë ndërtimi i tyre e rrënoi Shqipërinë e cila ishte aq e varfër edhe pa ta.

Në ditët e rregjimit të Enver Hoxhës, çdo qytetari të aftë për luftë i ishte rezervuar një bunkjer. Prej kujt ruheshin ata? Sigurisht më së pari prej ShBA-ve.

Bunkjerët tashmë janë zhytur në vetminë e tyre shkatrrimtare por edhe ashtu mbetën një problem: Ende nuk është gjetur një mënyrë për të liruar tokat e kultivueshme prej tyre. Ato kërpurdha gjigande prej hekuri e betoni zënë pjesë të konsiderueshme toke të punueshme.

Gradualisht Enver Hoxha i ashpërsoi mardhënjet me vendet tjera. Kështu në vitin 1961 ai ndërpreu çdo kontakt me Bashkimin Sovjetik duke u kthyer në një aleat të Kinës Komuniste. Kur Kina u hap ndaj perëndimit ai e konsideroi atë tradhëtare e kështu i dha fund edhe asaj aleance të çuditëshme. Ky ishte konflikti i fundit i Shqipërisë me botën e jashtme të cilën Enver Hoxha e konsideronte si djallin vetë.

.....

Kontaktet me Shqipërinë u ndërprenë, ndërkohë që vetë shqiptarët iu lutën miqve të tyre jashtë që të mos u dërgonin letra pasi kjo të çonte drejtpërsëdrejti nën vëzhgimin e policisë sekrete, sigurimit famëkeq.

Pabesueshmërisht, Enver Hoxha i konsideroi Bashkimin Sovjetik dhe të gjitha vendet tjera që kishin sistem socialist, si vende që rrëshqitën dhe degjeneruan në një sistem kapitalist.

Me 1985 Enver Hoxha, udhëheqësi që kishte qeverisur më gjatë në Europën e pasluftës, vdiq. Arkivoli i tij u shoqërua nga mijëra njerëz. Pjesa më e madhe e shqiptarëve e fshehu gëzimin për vdekjen e tij. Ata të cilët e "qanë" me lotë, mezi pritën që të vinte dita për t'ja shkatërruar monumentet anë e mbanë vendit. Dhe kjo ditë erdhi vetëm pas pesë vjetësh,në vitin 1990. Pasardhësi i Enver Hoxhës, Ramiz Alia iu dorëzua presionit të popullit dhe u detyrua që të shpallte zgjedhje shumëpartiake. Në të njëjtin vit u lejuan lidhjet telefonike me jashtë. Në vitin 1992, Partia Demokratike i fitoi zgjedhjet, ndërtoi një sistem demokratik dhe evidentoi shkatërrimet e tmerrshme që komunizmi kishte bërë në Shqipëri. Varfëria në Shqipëri gjendej gjithkund. Paga mesatare ishte 20 dollarë në muaj kur një bukë kushtonte 20 cent. Dyqanet dhe pikat e karburanteve ishin të mbyllura me rrjeta hekurash dhe papunësia ishte krejtësisht jashtë kontrollit. Projekte shumë të mëdha veprash industriale kishin dështuar ndërsa edhe oxhaqet e atyre fabrikave me teknollogjitë më të vjetra nuk nxirnin më tym. Shqipëria nuk mund të matej me tregun botëror.

Më 1969 të gjitha taksat nga shitjet dhe të ardhurat ishin hequr si zë i ekonomisë ndërsa më 1976 nëpërmjet të një kushtetute kjo u zyrtarizua

përfundimisht. Shteti i realizonte të ardhurat nga ndërmarrjet dhe tregtia e jashtme. Kohë më vonë u vu një taksë mbi të ardhurat.

Hebrejtë pas luftës

Popullata hebreje u zvogëlua me shpejtësi bile që përpara se të mbaronte lufta. Refugjatët u kthyen njëri pas tjetrit në vendet e tyre sapo ato çliroheshin nga nazizmi. Vetëm kur u kthyen ata kuptuan se çfarë tmerri kishte lënë prapa Holokausti. Shumë prej tyre ikën në kërkim të një mundësie për të hyrë në atë vend që më vonë do të bëhej shteti i tyre, Izraeli. Pak prej tyre ndenjtën për tu bërë qytetarë shqiptarë; në të vertetë shumica e atyre që ndenjtën e bënë këtë sepse ishin martuar me shqiptare.

.....

Një grua hebreje polake, e cila u martua me një shqiptar, hodhi poshtë ndihmën e ofruar për ta dërguar në Izrael si emigrante. Këtë ajo s'e pranoi as pas vdekjes së burrit të saj. Ajo kishte zgjedhur që të rrinte në Shqipëri "me miqtë e saj shqiptarë".

Eshtë vlerësuar se pas Luftës Botërore kishte 85 familje hebreje të cilat jetonin në Shqipëri. Ky numër duket fare i vogël. Sipas Jakoelit, kur mbaroi lufta, në vend kishte 600 hebrej. Të tjerë thonë se kishte rreth 1.000. Që nga viti 1933 e deri më 1945 kishte hebrej që hynin e dilnin nga Shqipëria çka e bën të pamundur deklarimin e një shifre të saktë, 500, 1000, apo 3000? Ndoshta kjo shifër i referohet periudhës së pushtimit nazist nga vera e vonë e vitit 1943 deri në nëntor 1944 kur popullsia hebreje ishte stabël dhe e fshehur. Vlerësimi më i mirë për këtë periudhë është 800 - 1000 hebrej vendas dhe të ardhur të dy palët të fshehur.

Nën Komunistët

Pas luftës, shqiptarët jetuan në një shtet policor i cili i kufizonte liritë për të gjithë shqiptarët, rrjedhimisht edhe për hebrejtë. Ishte e rrezikshme të flisnje gjuhë të huaj, të lexoje libra të ndaluara, të shprehje opinione të caktuara, të dëgjoje radio apo të shikoje programe televizionesh të huaja.

Josef Jakoel e dëgjonte radion Zëri i Amerikës dhe BBC - në, radiot greke dhe italiane duke e ndjellur rrezikun e arrestit në përpjekjet e tij për të mësuar se çfarë ndodhte në pjesën tjetër të botës.

I ati i Jozefit kishte një fabrikë të vogël dhe për këtë ai ishte arrestuar dhe mbajtur në burg, ndërsa e gjitha pasuria iu konfiskua nga komunistët. Pasi dorëzoi çdo gjë që kishte, komunistët e lshuan duke i lejuar të kishte vetëm një shtëpi të vogël.

Izraeli.

Në vitin 1949 disa hebrejë bënë një përpjekje të pasukseshme për të shkuar në Izrael. Kjo ishte rreptësisht e ndaluar, ndërkohë që një detyrim tjetër u vu përpara tyre: Të rrinin në Tiranë ose në Vlorë ku gjendeshin shumica e hebrejve të mbetur në Shqipëri mbas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1953 disa hebrej u vranë në një përpjekje për të ikur për në Itali. Të tjerë ikën në Greqi, ndërkohë që vlerësohet se në vend kishte 52 familje hebreje shqipëtare.(1) Siç shprehet një ndër udhëheqësit e bashkësisë hebreje, Isak Kohen kjo ishte ishte periudhë terrori.

Sipas Enciklopedisë Hebreje, në Tiranë kishte 200 hebrej në vitin 1969 si dhe disa të tjerë në Vlorë dhe në Shkodër, por ata të Tiranës ishin thuajse të tërë sefardikë. Jakoel nuk është dakort me këto të dhëna.

Qeveria shqiptare në unison me ate ruse votoi në Kombet e Bashkuara në favor të shtetit të Izraelit. Kur sovjetikët ndërmorën një kurs agresiv anti-semitist, qeveria Shqiptare, vasale e saj bëri të njëjtën gjë. Qeveria shqiptare tregoi mbështeje të vazhdueshme ndaj palestinezëve duke marrë një pozitë anti-izraelite afatgjatë gjë që shkaktoi një pozitë të vështirë për hebrejtë vendas. As mbështetja që Izraeli i bëri rezolutës së lëshuar nga Shqipëria për pranimin e Kinës në Kombet e Bashkuara nuk pati ndonjë efekt në politikën shqiptare të mëpastajme.

Shqipëria vendosi mardhënje diplomatike me Izraelin në gusht të vitit 1991. Kjo ishte një shenjë e mirë që tregonte se mardhënjet midis dy vendeve po hynin në rrugë të mbarë. Qeveria shqiptare nuk e kundërshtoi eksodin e hebrejve të vitit 1991.

Në vitin 1995 orkestra Kibbutz e Izraelit, Kori i Teatrit të Operas së Tiranës dhe disa prej orkestrantëve të Operas së Tiranës dhanë një koncert të përbashkët për nder të fisnikëve shqiptar. Gjërat duket se kanë marrë për mbarë.

Ka mospërputhje pikpamjesh rreth anti-semitizmit në Shqipërinë e pasluftës. Ka raste kur fëmijët kanë mësuar rreth anti-semitizmit në Shqipëri si edhe në vendet tjera komuniste. Një grua hebreje thotë se u bë pre e anti-semitizmit kur

ia mohuan të drejtën që të studjonte në Konservatorin e Muzikës edhe pse ishte shumë e kualifikuar. Një tjetër i bazon të thënat e veta në faktin se nuk kishte diskriminim pasi shumë prej hebrejve kishin marrë grada shkencore si dhe kishin bërë përparim profesional.

69

.....

Ka mundësi që asaj t'i ishte mohuar e drejta për të studjuar në konservator pasi gjyshi i saj ishte shumë i pasur gjë që përbënte një mëkat shumë të madh për komunistët.

Në vitin 1986 kronika hebreje raportonte se një hebre i cili "shpëtoi" nga Shqipëria pasi i kaloi malet midis Shqipërisë dhe Greqisë tha se anti-semitizmi në Shqipëri ishte shumë i përhapur. Shumë hebrej shqiptarë e kundërshtojnë këtë.

Shteti ateist

Do të ishte lehtë të thuhet, por edhe gabim po të dilet në përfundimin se mungesa e fesë intensive në Shqipëri vjen si rezultat i nxjerrjes së fesë jashtë ligjës nga ana e qeverisë së Enver Hoxhës. Në një Histori të Shqipërisë të shkruar në vitit 1919, një gjeneratë para Enver Hoxhës thuhet se shqiptarët kishin qenë historikisht indiferentë ndaj fesë. Mbreti Zog u dha fund mardhënjeve me muslimanët jashtë Shqipërisë që në vitin 1930. Toleranca ndaj feve të ndryshme ekziston në këtë vend sikundër askërkund tjetër.

Një arësye tjetër për këtë situatë të veçantë mund të gjendet tek fakti se ka patur relativisht pak ndrrime feje "me shpatë". Turqit ishin muslimanë dhe i mirëprisnin ndërrimet e fesë, por rrallë i vinin ata përpara detyrimit: "Ose ndrysho fenë ose prano vdekjen". Në të shumtën e rasteve, shndërrimi bëhej për përfitime personale, si dhe lehtësira të tjera dhe jo nga zelli fetar. Duke jetuar nën një shtet musliman ishte shumë më mirë të ishe musliman. Pikërisht se i dinin këto favore, shumë njerëz e ndrruan fenë. Eshtë e kuptueshme që në këto rrethana, pak njerëz e merrnin fenë seriozisht.

Ashtu si në Spanjë ku hebrejtë ishin ditën katolikë dhe natën hebrej, edhe të saposhndërruarit në islam shpesh bënin të njëjtën gjë, ndonëse ekziston një dallim shumë i rëndësishëm.

Në Spanjë ndodhte shpesh që fundi të ishte fatal për ata të cilët praktikonin fshehtas fe tjetër, ndërkohë që ishin deklaruar si kristianë. Por në Shqipëri dukej se askush nuk e vriste mendjen për ata që ishin shndërruar në islam e që fshehtas praktikonin qoftë kristianizmin qoftë judaizmin.

.....

Martesat e shumta midis çifteve me fe të ndryshme shpesh përfundonin me shndërrimin në islam. Edhe kjo kthehej në një faktor të rëndësishëm. Duke patur familje të përzier fetare kjo i ndihmonte jashjtëzakonisht shumë tolerancës. Në Shqipëri nuk është e çuditëshme që të gjenden vëllezër me fe të ndryshme. Po kështu s'është e çuditshme kur sheh që fëmijë me prindër muslimanë të mbajnë emra katolikë vetëm pse ata tingëllojnë bukur.

Ka edhe ndrrime të fesë kristiane nga ajo ortodokse në katolike dhe anasjelltas të bëra për shkaqe ekonomike ose politike. Heroi kombëtar i shqiptarëve është i njohur për shndërrimin e tij në islam e më pas luftoi deri sa mori titullin "Kalorësi i Krishtërimit"

Hebrejtë e ndërruan fenë, por sa herë dhe sa shpesh e bën këtë nuk dihet. Herman Bernshtain shkruan se një klerik musliman i ka thënë se ka shumë të ngjarë që të parët e tij të kenë qenë hebrej.

Një klerik tjetër musliman i ka thënë Bernshtainit se ka të ngjarë që një herë e një kohë i tërë fshati të ketë qenë hebrej. Ai e bazonte këtë më së shumti në emrat që mbanin banorët e atij fshati e që u ngjanin emrave të hebrejeve. A pat kjo ndonjë rëndësi në ndjesinë e shqiptarëve ndaj hebrejve, qofshin ata vendas apo të huaj gjatë viteve të Holokaustit?

Ateizmi iu imponua shqiptarëve në vitin 1967 nga qeveria komuniste. Deri në atë vit kishte tolerancë dhe njerëzit ishin të lirë që të ushtronin besimet dhe zakonet e tyre. Shqipëria u dallua pasi u bë i pari shtet në botë tërësisht ateist. Ligjet dhe masat shtrënguese anti-fetare të cilat u ushtruan mbi popullsinë ishin shumë më të detajuara dhe më shtrënguese se sa në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e bllokut komunist.

Enver Hoxha shpallte se feja e shqiptarëve ishte shqiptaria. Me këtë devizë të rilindasve shqiptarë e cila kishte luajtur një rol shumë të rëndësishëm në jetën e

shqiptarëve në përpjekjet për pavarësi, ai justifikonte gjoja dëshirën për ta mbajtur vendin homogjen duke zvogëluar njëkohësisht influencën nga jashtë. Por këtë ai e kishte predikuar një gjysmë shekulli përpara se të dilte ligji për luftën kundër fesë, çka tregon se pas kësaj fshihej dëshira për ta sunduar vendin me dorë të fortë.

.....

Duke filluar nga viti 1967, qeveria ndërmori një fushatë kundër fesë e cila rezultoi në mbylljen e të gjitha kishave dhe xhamive. Kjo nuk u bë aq thjeshtë e pa gjakderdhje pasi u përdor edhe dhuna anti-fetare. Për shembull, ka patur një raport që murgjët françeskane vdiqën të djegur në një kishë katolike dhe në kuvendin e tyre.

Fushata anti - fetare pat si pasojë shkatërrimin ose djegjen e institucioneve fetare, bibliotekave të tyre si dhe dënoi çdokënd që guxonte të kundërshtonte ligjin anti - fe. Klerikët e tre feve kryesore u kthyen në puntorë të rëndomtë në sektorin shtetëror ose u pensionuan. Kishat dhe xhamitë u mbyllën dhe në shumë raste u kthyen në muzeume. Për një farë kohe të vjetërve iu lejua praktikimi i fesë vetëm në shtëpi. Por kjo shumë shpejt mori fund edhe për ata.

Në tërë këtë katrahurë, nuk u ngritën tone të veçanta anti - semitiste pasi ligji iu referohej të tëra besimeve njësoj. Pra hebrejtë nuk përbënin përjashtim nga ligji por siç do të shohim disa hebrej (dhe të tjerë) shpesh herë e shkelën ligjin. Një shkelje ishte ajo që Joesef Jakoel organizonte takime fetare, të cilat morën fund kur Shqipëria adaptoi kushtetutën e re të vitit 1976 e cila përmbante një dispozitë të veçantë për ndalimin e mbledhjeve me karakter fetar.

Familja Jakoel u përfshi në një numër praktikash fetare ilegale, ndër të cilat edhe përkthimin në shqip të informacioneve për Izraelin, historinë dhe traditat hebreje. Këto materiale qarkullonin në të tëra bashkësite hebreje në Shqipëri. "Një artikull ose një libër për Izraelin ishte një festë për në." thotë Jakoel.

Në vititn 1967, të gjitha vendet e shenjta u mbyllën, librat e shenjtë u ndaluan, ritet fetare dhe ceremonitë po ashtu, ndërkohë që vendosja e një shënje fetare në një gur varri vlerësohej si vepër kriminale.

Megjithëse Shqipëria u bë vend ateist që në vitin 1967, goditja e plotë u ndie në vitin 1975 kur filloi periudha më shtypëse ndaj feve. Duke filluar nga ky

.....

vit identiteti hebrej u përkeqësua edhe më tej pasi çdo kontakt me botën u ndërpre.

Në vitin 1988 u dukën shenjat e para të humbjes së shtrëngesës mbi fenë kur udhëheqësit fetare në emigracion u lejuan që të vizitonin vendin. Në nëntor të vitit 1990, një prift katolik i liruar pak kohë më parë nga burgu ku kishte vuajtur për 26 vjet, ndërmori një shërbesë për katolikët dhe muslimanët. Ai u arrestua por shumë shpejt u lirua për shkak të reagimit të ashpër të popullsisë ndaj këtij akti.

Nga fundi i vitit 1990, shumica e pengesave për praktikimin e fesë morën fund si dhe u abrogua ligji që i mbante në këmbë ato. Dy muaj më vonë u hapën kishat dhe xhamiat.

Sapo diktatura mori fund, njerëzit, shumica të moshuar rendën tek kishat dhe xhamiat, i rindërtuan ato që kishin shpëtuar si dhe ndihmuan për ndërtimin e disa të tjerave nga e para. Meqenëse gjeneratat e vona në Shqipëri nuk i njohin ritet fetare, në çdo xhami ata vendosën tabela me vizatime për mënyrën e të falurit.

Referuar shifrave më të besueshme, përbërja fetare është si më poshtë: 70 % janë musliman, 20 % ortodoks dhe 10 % katolike. Përqindja e bashkësisë hebreje gjatë shekullit të XX - të asnjëherë nuk ka qenë më shumë se një fraksion i 1 përqindshit.

Jeta e hebrejve përpara dhe gjatë periudhës ateiste.

Pjesa e "mëtejshme" e diskutimit është e pavlefshme në se i referohemi faktit që fundi i periudhës ateiste erdhi njëkohësisht me eksodin e hebrejve në Izrael, pra në vitin 1990.

Varrimet

Deri në vitin 1967 hebrejtë varroseshin në një vend të veçantë në varrezat e muslimanëve si një gjest i dëshirës së mirë i ofruar nga bashkësia muslimane. Ka vetëm një përjashtim: Një varrezë e vjetër në Vlorë e cila mbahet mend që në shekullin e kaluar u përdor deri në vitin 1965.

.....

Pasi shteti ateist pllakosi tërësisht, të gjitha varrimet bëheshin në varrezat e komunales, pa dallim feje apo përkatësie fetare. Në vitin 1967 varrezat e vjetra u shkatërruan prej qeverisë dhe gurët e varreve u dërguan tek varrezat e reja. Meqenëse u lejua transferimi i trupave të vdekur, bashkë me ta u morën edhe gurët në të cilët ranë në sy datime nga shekulli i XIX - të e ndoshta edhe më parë.

Deri në vitin 1967 funeralet bëheshin me rregullin më të madh duke respektuar në mënyrë strikte ligjet hebreje. Trupi lahej dhe mbështillej në një copë të bardhë e më pas shtrihej në një qivur por, varrimi bëhej pa këtë të fundit. Trupin e të vdekurit e shoqëronte një masë njerëzish të cilët mërmëritnin vajet e faljes gjatë gjithë rrugës për tek varrezat.

Zija zgjaste 40 ditë ndërkohë që gjatë tetë ditëve të para familja flinte përtokë dhe hante në një pozicion të pjerrtë. Burrat nuk rruheshin për dyzet ditë, ndërsa çdo natë që ka dhënë zoti gjatë kësaj kohe një grup prej dhjetë ose më shumë burrash mblidheshin dhe luteshin për të vdekurin.

Rabinet

Prania e rabinëve në mesjetën e hershme vërtetohet prej shkrimeve të lëna prej udhëtarit shumë të njohur Rabbi Benjamin i Tudeles cili e vizitoi Shqipërinë në vitin 1170 e që ju referohet rabinëve Solomon dhe Jakob të cilët jetonin aty.

Ka patur rabinë gjatë viteve të mëparëshme por bashkësia hebreje e shekullit të XX-të nuk ishte aq e plotë sa të mbante një rabin me kohë të plotë. Pjestarët e bashkësisë do të vepronin si "hazen" duke ndjekur traditën e hebrejve turqë të cilët i shkrinin edhe rabinët edhe kantorët në të njëjtin person.

Për dekada të tëra bashkësia hebreje në Shqipëri mbështetej tek rabinët e Korfuzit për raste martesash e synetesh. Mbas Holokaustit nuk mbeti bashkësi hebreje në Korfuz, ndërkohë që mbas vitit 1967 rabinëve iu ndalua reptësisht hyrja në Shqipëri. Siç u tha më lart të gjitha praktikat fetare u ndaluan.

.....

Bashkësia hebreje nuk kishte atë që duhej për të kryer synetet prandaj mbështetej tek muslimanët të cilët me gjithë qef e bënin këtë. Muslimanët e vazhduan këtë praktikë edhe pas vitit 1967 por në mënyrë tepër të fshehtë. Para luftës ishte normale që kjo të kryhej nga ata që vinin nga Korfuzi, por kjo mori fund bashkë me luftën.

Normalisht syneti duhej bërë tetë ditë pas lindjes së fëmijës, por në Shqipëri, gjatë shekullit të XX - të kjo bëhej edhe më vonë. Rituali i fundit i syneteve u bë gjatë periudhës së pushtimit italian, në fshehtësi dhe pa ceremonira fetare. Synetet e muslimanëve i bënte zakonisht një berber me një trajnim të veçantë. Eshtë e qartë që kjo nuk bëhej sipas rregullave, por ajo çfarë është e rëndësishme është se kjo bëhej.

Sinagogat

Nuk ka patur sinagoga në Shqipëri përveç asaj që u shkatërrua aksidentalisht gjatë Luftës së Parë Botërore. Ato u zëvendësuan nga shtëpitë e hebrejëve të cilët kishin hapsirë të bollshme dhe që paraqiteshin të gatshëm për të vënë në shërbim të riteve fetare pjesë nga shtëpitë e tyre. Familja Jakoel i bashkoi dy dhoma pikërisht për këtë qëllim. Pas vitit 1975 u bë tejet e rrezikshme të kryheshin rite të tilla.

Martesat

Në të gjitha bashkësitë hebreje kishte një ndjenjë të fortë që i shtynte që të martoheshin brenda fesë së tyre. Përpara Luftës së Dytë Botërore martesa jashtë fesë konsiderohej skandaloze. Ka patur dy incidente në vitin 1935, në dy raste martesash me kristianë. Bashkësia dhe vetë prindërit i quanin këto martesa, të mallkuara. Familjet shkuan aq larg sa njëra prej tyre ia recitoi lutjet e vdekjes duke mos e qasur më si vajzë të vet atë që bëri këtë martesë. Por gjërat ndërruan me shpejtësi. Kështu pas vitit 1967, 50% e martesave u bënë me jo-hebrej.

.....

Martesat e para luftës në të shumtën e rasteve bëheshin me hebrejë nga Janina. Kishte relativisht pak martesa me hebrej të Korfuzit pasi ata flisnin një dialekt venecian, i panjohur për hebrejtë e Shqipërise. Djali ose vajza që kërkonte të

martohej shkonte në Janinë për të vizituar të afërmit, për të punuar ose për tu shkolluar derisa ai ose ajo të ndesheshin me personin e duhur.

Ka patur martesa brenda bashkësisë hebreje shqiptare dhe kjo ndodhte shpesh të bëhej midis atyre që e njihnin njëri tjetrin që në fëmijëri. "Shoqëria" e burrit ose e gruas së ardhshme nuk ishte aq e gjerë, por fëmijët e dinin këtë prej një moshe të re; ata e dinin se çfarë kërkohej prej tyre. Për shumë hebrej, martesa jashtë fesë ishte ende e paimagjinueshme.

E gjithë kjo ndryshoi në vitet e pas-luftës së Dytë Botërore dhe veçanërisht pas vitit 1967. Atje nuk ekzistonte edhe më tej ndonjë "shoqëri" që premtonte për martesa, ndërkohë që as në Korfuz e as në Janinë nuk shkohej më. Për të gjetur bashkëshortin e përshtatshëm, ka qenë gjithmonë e vështirë. Por kjo erdhi e u vështirësua edhe më shumë pasi udhëtimet tradicionale jashtë vendit për të vizituar kushërinjtë u ndërprenë, ndërkohë që shoqëria në Shqipëri ishte e vogël.

Zgjidhjet kishin mbetur vetëm tre. Ishte i lumtur ai që gjente një shok jete midis bashkësisë hebreje; disa ishin të shqetësuar se mund të ndodhte që të gjëndej partneri brenda fesë, por nuk do të ishte ai partner që ai ëndërronte. Për prindërit kjo mbetej zgjedhja më e mirë e mundshme. Nuk kishte shkuesi por sidoqoftë familjet në një mënyrë ose në një tjetër i shtynin të shkonin drejt martesave që në moshë të re.

Zgjidhja e dytë ishte të mbeteshin të pamartuar. Kjo është kundër traditës hebreje, prandaj duket qartë se shumë pak prej tyre zgjodhën këtë variant.

Nuk ka ndonjë statistikë, por ekziston mundësia që 50 % të martesave të bëra 1967, të jenë me partnerë jo-hebreje. Pra ka ndodhur pikërisht ajo që është çmuar si dicka skandaloze.

.....

Prindërit ndonëse e kuptonin shqetësimin me të cilin iu ballafaqoheshin fëmijët, prapëseprapë këmbëngulnin që ata të martoheshin brenda fesë së tyre. Ka të dhëna se pikërisht ky shqetësim ka qenë një ndër arësyet kryesore që i bëri hebrejtë shqiptar të emigronin në Izrael. Mardhënjet ndaj partneres nuk kishin ndonjë ndryshim me ato çfarë përjetohej në pjesën tjetër të Europës, bje fjala,

një shëtitje në një park, një film, një koncert, një drekë ose darkë, një vizitë tek miqtë...etj. Por ndryshimi qëndron diku tjetër dhe pikërisht tek vëmendja e madhe që i kushtohej virgjërisë.

Kjo përbënte një shqetësim për gratë moderne. Kur dy të rinjtë fillonin të mendonin seriozisht për njëri tjetrin, mardhënjet duheshin bërë sa më të kujdesshme, pasi mund të ndodhte që duke ndjerë që karakteret nuk puqeshin, femrës t'i dëmtohej tej mase personaliteti. Në këtë mënyrë shanset për tu martuar brenda bashkësisë, edhe ashtu të vogla, zvogëloheshin edhe më shumë në mos zhdukeshin fare. Po të kihet parasyshë se sa e vogël ishte bashkësia, kuptohet se sa kollaj binte në sy çdo veprim i pamatur.

Kjo veçanërisht përbënte një barrë për të rejat. Vetëm pak kohë pas fillimit të mardhënjeve me një partner, femrës i duhej të merrte një vendim. Në qoftëse mardhënjet vazhdonin por nuk rezultonin në martesë, ajo rrezikonte të mbetej përgjithmonë e pa martuar. Në qoftëse ajo i ndërpriste mardhënjet ende pa u ardhur koha, mund të humbte të vetmin shans që mund t'i vinte në jetë për tu martuar. Një qëndrimi i pavendosur mund të kishte pasoja të pariparueshme.

Dasmat bëheshin në vende mjaft të mëdha e të përshtatshme për ceremoni festive e martesa. Ishte një nder i madh për pronarin e një shtëpie të madhe që t'i kërkohej shtëpia për të bërë një dasëm. Dasma deri në vitin 1967 bëhej sipas rregullave strikte të jetës hebreje. Çifti mbulohej nga një talisë, një shall falje dhe pinte verën rituale në një kupë e cila më pas thyhej.

.....

Ky ishte një rit që bëhej për të kujtuar shkatërrimin e Tempullit të Solomonit. Pastaj prindërve të nuses u jepej një kontratë martese e cila përgatitej që më parë në gjuhën hebraishte.

Përpara 1967 - tës, ceremonitë fetare të martesave lejoheshin të bëheshin ashtu si edhe ato qytetare. Që nga ai vit i mbrapshtë e më pas, kishte vetëm ceremoni qytetare. Ndodhte që në ndonjë dasëm, fshehtas të bëheshin ceremoni fetare, por Jakoel thotë se kjo ishte me rrezik të madh.

Qeveria izraelite filloi të dyshonte me të drejtë se midis emigrantëve nga Shqipëria kishte shumë syresh që nuk ishin hebrej. Bashkëshortëve jo-hebrej,

fëmijëve ose nipërve të hebrejve iu dhanë të njëjtat të drejta, përfshirë edhe të drejtat e mbështetjes financiare, siç i garantohej çdo emigranti hebrej.

Në këto martesa ndër-fetare duket se më së shumti ata shkuan në drejtim të judaizmit; bashkëshortët hebrej, mbetën hebrej, ndërsa fëmijtë u rritën si fëmijë hebrejsh. Kjo ndoshta vjen pasi partneri hebre kishte njohuri shumë më të forta e të konsoliduara për fenë, si dhe ishte shumë më i edukuar nga ana fetare se ai jo-hebre. Partneri musliman ose kristian nuk haste në pengesa si ajo e shoqërisë së kufizuar të hebrejve, kështu që ata nuk shqetësoheshin nga feja e tyre. Nëse ndonjë lloj fanatizmi do të ekzistonte midis shqiptarëve në këtë drejtim, atëherë do të ndodhte që hebrejtë të mos gjenin as partnerë vendas për tu martuar.

Nuk kishte ndonjë dallim në preferencat për tu martuar, muslimanë apo kristianë. Por fakti që martesat e bëra jashtë bashkësisë, rezultojnë të jenë nga dhjetë të tilla, shtatë me muslimanë dhe tre me kristianë, tregues ky i raporteve fetare të popullsise në Shqipëri. Në të vërtetë në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut dominon feja muslimane, ndërsa në atë të Veriut ajo katolike.

Kosher

Ushqimet kosher nuk gjëndeshin, prandaj hebrejtë konsumonin mish jo-kosher. Një numër i tyre u kthyen në vegjetarian pasi nuk gjëndej mish kosher. Hebrejtë i shmangeshin ngrënjes së mishit të derrit si dhe ushqimeve të tjera të ndaluara nga rregullat hebreje.

.....

Festat

Përpara periudhës ateiste, dyqanet e hebrejve lejoheshin që të mbylleshin gjatë ditëve të festave të tyre. Pas 1967 - tës, pronarët hebrej të dyqaneve duhej t'i hapnin ato edhe në ditët e Yom Kippurit dhe Rosh Hoshamas. Ata që punonin, dilnin në punë, ndërsa fëmijët duhej të shkonin në shkollë. E megjitatë duke bërë kujdesin më të madh ata argjëronin si dhe i kryenin fshehtas formalitetet fetare.

Darka e Yom Kippurit, pas një dite argjërimi ishte gjithmonë e një kënaqësie të veçantë. Gati të tërë burrat do ta kalonin ditën duke u lutur në një dhomë të ndriçuar prej kandilëve me vaj ulliri të dërguar nga çdo familje në shtëpinë ku mbahej tubimi i lutjeve. Me të mbaruar festa, natën ata largoheshin njëri pas tjetrit duke mbajtur nga një kandil të ndezur në dorë. Parada e këtyre dritave vazhdonte edhe në rrugë duke u shuar dalëngadalë deri sa zhdukeshin në thellësinë e natës. Por edhe kjo praktikë përfundoi më ... 1967!

Gjërat karakteristike për pashkët e hebrejve piqeshin në shtëpi, pasi nuk mund të bëheshin diku tjetër që të plotësonin të tëra kërkesat. Sapo kishte mbaruar lufta, kur një ditë të pranverës së vitit 1945, hebrejtë morën njëmijë e pesëqint pound matszo nga Agjensia e ndihmave të Janinës.

Vajza e Jakoelit kujton: "Unë sjell ndërmend gëzimin që sillnin pashkët. Gjyshi do të lexonte Hagadah në hebraisht; Ai kishte mësuar në një shkollë fetare në Greqi. Unë kujtoj gjithashtu mënyrën e veçantë se si i studionim mësimet e biblës. Prindërit krijonin historira të mrekullueshme të përafërta me legjendat biblike dhe ua tregonin fëmijëve, ndonëse ata që e njihnin biblën i dinin këto histori."

Purimi ishte festa më e dashur pasi ajo nuk kishte asnjë privacion. Për këtë festë, hebrejtë i japin dhurata njëri tjetrit. Ushqimet më të mira shërbeheshin pikërisht për këtë festë; fëmijët iu gëzoheshin monedhave që iu jepnin, vendosnin maska ne fytyrë dhe shkonin derë më derë për të pyetur shokët dhe miqtë në se arrinin t'i njihnin apo jo.

Hanukkah - u zgjaste 8 ditë. Gjatë gjithë ditëve kandilat rrinin ndezur. Gjatë festave fetare bëheshin vizita familjare. Edhe shqiptarët shkonin për vizita. Njësoj si hebrejtë e lashtë ata nuk ishin të sigurtë për datat e sakta të festave. Për këtë u duhej të dëgjonin ndonjë radio italiane me shpresë që të kapnin ndonjë shenjë se kur do të fillonin festat.

Gjuha hebraishte.

Rrallë ndonjë hebre - shqiptar dinte hebraisht përpara se të shkonin në Izrael, bile edhe ata pak prej tyre që dinin, në të vërtetë dinin një gjuhë për tu falur dhe jo gjuhë të përdorimit të përditshëm. Në shumicën e vendeve ata që synonin të emigronin për në Izrael, përpara se ta bënin këtë, fillonin të mësonin hebraisht. Hebrejtë shqiptarë nuk e patën këtë mundësi, pasi ata vinin nga një vend ku të mësuarit e hebraishtes konsiderohej si një krim.

Shtëpitë e hebrejve.

Eshtë një grua hebreje në Vlorë e cila është martuar me një musliman e që identifikohet si hebreje: Ajo ka rritur dy djem që e dinë veten hebrej. Ajo zgjodhi të mos shkonte me babanë në Izrael në vitin 1991. Shtëpia e saj në Vlorë është një shtëpi e madhe e konfiskuar prej komunistëve dhe e përdorur si bibliotekë popullore gjatë periudhës komuniste. Në vitin 1994, shteti iu ktheu atë pas shumë vonesash, pasi duhej gjetur një vend tjetër për bibliotekën. Në kornizën e derës ka një vend të vogël të palyer që tregon qartë se prej çfarë materialesh është bërë ajo. Ajo thotë se që përpara se ajo vetë të lindte, dhoma e madhe e shtëpisë përdorej si sinagoge. Shtëpia tjetër në drejtim të portës, gjithashtu një shtëpi e madhe i takonte familjes Jakob, ndërsa tani ajo është selia e Partisë Demokratike Shqiptare. Shtëpia tjetër në radhë ka qenë pronë e familjes Levi. Këto tri shtëpi janë aq të mëdhaja sa dallohen menjëherë jo vetëm nga shtëpitë e shqiptarëve por edhe nga shtëpitë e hebrejve në rrugën që mban emrin e tyre.

80

.....

Emri zyrtar i kësaj rruge ishte, " Rruga e çifutëve". Por ky nuk ishte aspak emër përbuzës, por thjeshtë një emërtim. Shumë prej familjeve të hebrejve jetonin në këtë bllok të kësaj rruge të gjatë. Shtëpitë në rrugën e hebrejve ishin modeste, bile edhe po të krahasohen me standartet shqiptare. Rruga dhe emri i saj janë kuptimplota dhe shërbejnë për të treguar vendodhjen e kësaj bashkësie në Vlorë. Jakoel jetoi në një prej shtëpive të asaj rruge deri sa familja e tij u vendos në Tiranë.

Tanimë asnjë hebre nuk jeton në atë rrugë e megjithatë ajo mban ende të njëjtin emër. Ajo kurrë s'ka qenë një geto, pasi hebrejtë jetonin këtu me vullnetin e tyre duke patur gjithmonë familje jo-hebreje, fqinjë. Familja e fundit e la atë rrugë në vitin 1991. Një zonjë e vjetër e cila jetonte aty thotë se hebrejtë ishin fqinjë të mirë dhe asaj i vjen keq që ata nuk janë më aty. S'ka asnjë arësye që kjo të mos besohet.

Anti-semitizmi

Ka patur shumë pak anti - semitizëm të çfaqur në Shqipëri; si në shumicën e vendeve komuniste, ai fshihej, por kjo nuk do të thotë se mungonte plotësisht. Në fillim të viteve '50, kur ndodhi i ashtuquajturi "komploti i doktorëve" për të vrarë Stalinin, politika zyrtare e cila hiqej sikur ishte kundër anti - semitizmit u injorua prej linjës së ashpër komuniste duke bërë deklarime të forta që në të vërtetë shkonin në linjën anti - semitiste. Shqipëria në atë kohë ishte aleate e

ngushtë e Bashkimit Sovjetik. Sipas Jakoelit, anti - semitizmin e përfaqësonte qeveria komuniste por kjo nuk kishte asnjë farë refleksi tek ndjenjat e popullit shqiptar.

Anti - semitizmi, kudo që ekzistonte ishte më shumë një dukuri potenciale se sa një formë konkrete e shfaqjes apo ekzekutimit të vet të organizuar. Ka patur akuza për diskriminim në mos dhënjen e mundësive për të vazhduar universitetin. Por Jakoel e kundërshton këtë duke thënë se ishin aq shumë hebrej të cilëve iu ishte dhënë mundësia që të vazhdonin studimet e larta aq sa nuk mund të flitet për diskriminim.

Tregtia dhe profesionet.

Hebrejtë e Valës së Tretë, (Ajo e fundit e shek të XIX - të) ishin më së shumti tregtar. Ata që shkuan në Izrael në vitin 1991, më të shumtët ishin profesionistë.

.....

Asimilimi dhe ndrrimi i fesë

Për shkak të natyrës së shoqërisë ateiste, nuk ekzistonte ndonjë merak se a do t'i shpëtonin hebrejtë asimilimit apo jo. Çdo njëri e dinte se kush ishin hebrejtë ose të paktën mendonin se e dinin, por kjo nuk tërhiqte vëmendjen e askujt. Hebrejtë shqiptar ishin asimiluar, por pa humbur identitetin hebre. Ndrrimi i fesë në judaizëm ose nga judaizmi në fe tjetër ishte shumë i rrallë në kohët moderne. Por ka të dhëna se historikisht përpara shekullit të XX - të ka patur ndrrime feje masive në islamizëm. Eshtë e llogjikshme që të pranojmë se shumë prej personave jo-hebrej të cilët i shoqëruan familjet e tyre në eksodin e vitit 1991 në Izrael, do ta ndrronin fenë për hatër të njerëzve të tyre të afërt dhe lehtësirave që rrjedhin prej kësaj.

Emrat.

Përpara periudhës ateiste, zakoni sefardik kërkonte që emri i fëmijës të ishte emri i një njeriu të gjallë. Kështu djalit të parë i ngjitej emri i gjyshit nga babai, ndërsa djalit të dytë emri i gjyshit nga mamaja.

Në periudhën ateiste, emrat që u viheshin fëmijëve nuk duhej të kishin karakter fetar. Disa prindër u kishin vënë fëmijëve emra nga Bibla ose Kurani, sipas feve që ata mbanin, por në vitin 1976 qeveria vendosi që fëmijëve tu viheshin emra jo fetare.

Paratë për të blerë toka në Izrael.

Jakoel tregon për zakonin e para Luftës së Dytë, për fondet e kontributeve për të blerë tokë në Palestinë. Ka patur një kuti me ngjyrë blu dhe të bardhë, e stolisur me Yllin e Davidit në të, e fiksuar në mur brënda së cilës fëmijët hidhnin monedha çdo të shtunë. Prindërit, i çonin fëmijët në krahë deri sa ata e arrinin kutinë në mur për të hidhur paratë, të cilat do të duheshin për çlirimin e atdheut të humbur. Një herë në vit përfaqësuesi i fondit vinte dhe e zbraste kutinë. Kjo ka qenë një praktikë e përhapur midis hebrejve amerikanë dhe hebrejve të tjerë të së njëjtës gjeneratë.

Emigracioni nga Shqipëria para vitit 1991.

Kur përfundoi lufta, gjysma e hebrejve e lëshuan vendin dhe shkuan në Izrael, Jugosllavi dhe vende të tjera. Ata lanë në Shqipëri afërsisht 300 hebrej, nje numër i vogel por gjithsesi dy herë më i madh se para luftes.

.....

Në vitin 1949 shumë prej hebrejve të mbetur u përpoqën që të emigronin për në Izrael, por qeveria nuk i lejoi kurrësesi. Në atë kohë Shqipëria ishte pjesë e bllokut sovjetik, i cili ishte anti - sionist dhe kundërshtonte eksodin hebrej si një lëshim ndaj kombeve arabe me të cilët ata flirtonin. Bile edhe pas prishjes me sovjetikët, diktatori shqiptar vazhdoi të mbante një kurs anti - sionist e anti - Izrael të cilin është shumë vështirë për ta kuptuar. Periudha deri në vitin 1990, ishte periudhë e izolimit dhe Shqipëria nuk bënte përjashtime ndaj vendeve muslimane, por edhe pse nuk flirtonte më me arabët, propogandën ndaj Izraelit nuk e ndërpreu.

Enver Hoxha ua ndaloi hebrejve të vendit të vet imigrimin për në Izrael duke marrë një pozitë tejet anti - izraelite. Shqipëria nuk vendosi mardhënje diplomatike me Izraelin deri 6 vjet pas vdekjes së diktatorit.

Në të shumtën e vet, propoganda anti - sioniste është edhe propogandë anti - semitiste, por Shqipëria përbën një përjashtim këtu: Propoganda anti - izraelitë ishte gjerësisht e përhapur, por ajo nuk duket të ishte anti - semitiste po të shihet qëndrimi që mbahej ndaj popullatës së vogël hebraike të Shqipërisë.

Shënime:

1.- 13 mars 1993, fq. 36

2.- Në atë kohë Universiteti i Tiranës kishte tetë fakultete dhe 16.000 studentë. Kishte edhe dy Institute të Larta Pedagogjike.

.....

Kapitulli i Njëmbëdhjetë

Fisnikët Midis Kombeve

Shteti Izrealit krijoi një program për të identifikuar dhe nderuar jo - hebrejtë të cilët rrezikuan jetën për të shpëtuar bashkëkombasit e tyre gjate Holokaustit. Më shumë se 12.000 të tillë janë nderuar deri tani. Të marrësh këtë status nuk është e lehtë pasi duhen patur prova të pakundërshtueshme. Për fat të keq, ka ende shumë të tillë të cilët për një mori arsyesh nuk janë bërë të njohur. Në disa raste fisnikët janë vrarë prej të njejtëve gjermanë që vranë edhe hebrejtë. Në raste të tjera hebrejtë kanë vdekur pa patur mundësi që të dëshmojnë për shpëtimtarët e tyre. Ka patur edhe një periudhë të mungesës së komunikimit me hebrejtë e vendeve të ish-bllokut sovjetik. Polonia dhe Shqipëria janë nga më tipiket. Prej tyre ishte shumë e vështirë të merrej informacion për t'i kualifikuar fisnikët.

Kur hebrejtë shqipëtar arritën në Izrael, nuk i harruan miqtë e tyre muslimane e kristiane shqiptarë të cilët kishin rrezikuar jetën për t'i shpëtuar ata nga tmerri i Holokaustit. Josef Jakoel solli në Izrael dosjet që ai dhe hebrejtë e tjerë kishin faqosur për të dokumentuar veprën e Fisnikëve. Këto dosje ishin përpiluar ndër

vite sepse ai besonte që një ditë do të mund t'i dërgontë në Izrael, kështu që Fisnikët një ditë, sado vonë të ishte, do të nderoheshin për atë që kishin bërë. Kjo bëri që shtatëmbëdhjetë shqiptar ta merrnin këtë titull. Ka edhe Fisnikë të tjerë shqiptarë të cilët janë njohur nëpërmjet të dokumenteve të tjera.

Duke u titulluar Fisnik, automatikisht fitohet e drejta e qytetarisë së nderit në shtetin e Izraelit dhe në disa raste edhe një ndihmë financiare për njerëz më në nevojë. Ndihma financiare është siguruar nga Fondacioni Hebrej për Fisnikët me qendër në Nju Jork, një organizatë amerikano - kanadeze e pavarur, e ngritur për të ndihmuar fisnikët që e meritojnë këtë ose që janë në vështirsi ekonomike.

.....

Shqipëria është i vetmi vend i pushtuar nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore ku hebrejtë nuk u vranë. Fatkeqsisht, bujaria dhe heroizmi i popullit shqiptar nuk është njohur dhe propoganduar sa e si duhet.

Programi për fisnikët Jo-Hebrej

Izraeli e krijoi programin për fisniket jo-hebrej për të nderuar ata njerëz të cilët rrezikuan jetën e tyre duke i strehuar gjatë viteve të Holokaustit. Programi drejtohet nga agjensia qeveritare izraelite Yad Vashem.

Çdokush që kandidon për këtë status duhet të japë provat e nevojshme. Shumica e fisnikëve quhen të zgjedhshëm kur Yad Vashem merr letër nga dy bashkëshortë të cilët provojnë faktin që Fisniku i ardhshëm jo - hebre ka rrezikuar jetën e tij për të shpëtuar atë të hebrejve. Më së shpeshti është një hebre i strehuar nga fisniku ai që e inicion këtë proçes. Nuk kërkohet vizite ne Izrael për akreditim bile shumica e fisnikëve s'e kanë parë kurrë atë vend.

Fisnikët që e vizitojnë Izraelin, marrin pjesë në një ceremoni shumë të bukur ku nderohen për atë që kanë bërë një gjysmë shekulli më parë. Deri disa vite më parë, mbjellja e një peme në kopshtin e Yad Vashemit ishte pjesë e kësaj ceremonie. Kjo s'mund të bëhet më pasi maja e kodrës ku mbilleshin këto pemë është mbushur dhe nuk ka më vend të lirë. Në vend të mbjelljes së pemëve është zgjedhur një varg muresh ku vendosen pllaka bronxi me shkrime me emrat e Fisnikëve si dhe të dhëna për ta. Pllakat e bronxit kushtuar Fisnikëve Shqiptar janë midis të parave në këto mure.

Fisniket Jo - hebrej vizitojnë Izraelin.

Në vitin 1993, të gjithë Fisnikët Shqiptar të cilët ende nuk e kishin parë Izraelin u ftuan në Tokën e Shenjtë si musafirë të Harvey Sarner për tu nderuar prej shtetit izraelit dhe popullit hebru.

.....

Disa prej fisnikëve kishin vdekur, të tjerë ishin të sëmure ose të pamundur për të marrë një udhëtim të tillë. Në një numër rastesh prindërit fisnikë, ndonëse mund të ishin të aftë ta përballonin udhëtimin, kërkuan që t'i dërgonin fëmijët në vend të tyre. Ata e kuptonin rëndësinë që kishte për fëmijet e tyre një udhëtim i tillë jashtë Shqipërisë. Pikërisht për këto arësye rreth një e treta e grupit të Fisnikve Shqiptar përbëhej nga femijët ose të afërmit e tyre.

Shtatëmbëdhjetë Fisnikët dhe të afërmit e tyre kaluan një javë në Izrael si musafirët e mi. Përveç pjesmarrjes në ceremoninë e mrekullueshme të Yad Vashemit, musafirët patën rastin të takojnë hebrej shqiptarë shumica e të cilëve gjendej në qendrat e mësimit të hebraishtes dhe të aklimatizimit. Ndjenjat e shfaqura në ato momente ishin aq të sinqerta dhe emocionuese. Duke i vështruar ata njerez tek përqafoheshin, putheshin, përloteshin, ishte e pamundur të dalloje se cili prej tyre ishte hebre, cili musliman e cili kristian.

Musafirët gjithashtu vizituan vendet e shenjta të hebrejve, të muslimanëve dhe kristianëve; mësuan për jetën në Izrael dhe në përgjithësi panë vende turistike tërheqëse.

Në vend të suvenireve që zakonisht jepen në këto raste, atyre iu dhanë kuti me ushqime që t'i ndanin me familjet dhe të afermit.

Eksodi i Vitit 1991

Në vitin 1991, hebrejtë e Shqipërise e lanë vendin e tyre. Pas një pranie prej më se 2.000 vjetësh, bashkësia hebreje pushoi së ekzistuari, më përjashtim të një dore njerëzish të cilët nuk mundën t'i merrnin të tërë ata që donin e t'i dërgonin në Izrael. Shumica prej atyre pak vetëve që kanë mbetur, janë të martuar me shqiptarë të cilët nuk dëshironin të emigronin.

Analogjia midis Josef Jakoelit dhe Moses nuk mund të lihet pa u përmendur. Ai ishte njësoj si Moses i cili e nxori popullin e Izraelit jashtë Egjyptit.

.....

Por këtu bie ne sy një dallim shumë i madh. Moses i priu popullit të vet të ikte nga shtypja dhe skllavëria ndaj ata nuk ndjenin keqardhje per largimin nga ai vend. Ndërsa Jakoel iu priu njerëzve të tij të largoheshin nga një vend ku lanë aq dashuri, mall, e nje mal me lotë.

Pak hebrej të njohur mbeten prapa. Ata ishin më së shumti të martuar me vendasit, ndaj ndenjën që t'i mbanin familjet të bashkuara, çka përbën nje gjest të një rëndësie të veçantë. Dy familje u kthyen më pas në Shqipëri. Kthimi i pjestarëve jo - hebrej të familjeve la prapa habi. Ndoshta ata prisnin shumë më shumë.

Nuk është mbivlersim të flasësh për atë çafrë bënë Josef Jakoeli dhe vajza e tij Feliçita për kthimin e hebrejve në vendin e ëndërruar. Në të vërtetë këtu qëndron historia e një aventure të madhe. Dikush duhej të bënte një udhëtim të fshehtë në Izrael. Josefi do të ishte personi më i përshtatshëm, por shëndeti i tij i lig nuk ia mundësonte këtë. U zgjodh Feliçita. Ajo karakterizohej nga të gjitha cilësite e babait si dhe nga enthusiazmi rinor.

Në vitin 1990, Feliçita Jakoel, mundi të merrte një vizë dalje për të vizituar kusherinjtë e saj të largët në Greqi. Pas vitesh të tëra izolimi, Shqipëria po i lejonte qytetarët e vet që të ndërmerrnin udhëtime jashtë shtetit. Me ndihmen e ambasadorit izraelit në Greqi, Feliçita mundi ta zgjaste rrugën nga Greqia në Izrael. Ky hap i rëndësishëm nuk u ndërmor pa ankth e pa frikë. Feliçita i shkeli ligjet shqiptare sipas të cilave ajo nuk mund të shkonte në asnje vend tjetër përveç vendit të shënuar në vizen dalëse. Atë e brente frika se mos burgosej me tu kthyer në Shqipëri. Megjithëse frika ishte e justifikueshme, ajo nuk u dekurajua.

Me të arritur në Izrael ajo mori takim me organizata të ndryshme ndër to edhe me Agjensine Hebreje, e cila kishte përgatitur planin për eksodin e hebrejve të Shqipërise.

Ne zyrat e asaj agjensie, Feliçita hartoi një listë sekrete me emrat e hebrejve që ajo njihte në Shqipëri. Vizita e saj në Agjensine Hebreje,

.....

rezultoi në një aksion të koordinuar midis qeverive izraelite dhe italiane si dhe me Komitetin e Përbashkët Amerikan të Shpërndarjes.

Feliçita i kaloi 12 ditë në Izrael duke planifikuar eksodin e hebrejve shqiptare dhe kthimin e vet në Greqi e më pas në Shqipëri. Ambasada izraelite në Athine i bëri tëra veprimet për kthimin e saj. Çdo gjë u bë në fshehtësi të plotë pasi në atë kohë nuk kishte mardhënje diplomatike midis Shqipërise dhe Izraelit. Përpara se të kthehej, ajo pyeti edhe një hërë babain e saj i cili i dha garanci të plota së asgjë nuk do të ndodhte. Klima politike kishte ndryshuar me shpejtësi dhe Shqipëria po i hapte derën një emigracioni të kufizuar. Edhe pasi u kthye në Shqipëri, ajo prapëseprapë e ndjente nevojën për të mbajtur të fshehtë atë që kishte bërë, pasi nuk mund ta parashikonte se si do te reagonte qeveria.

Në kohën kur Feliçita ishte në Greqi dhe Izrael, në Shqipëri plasen protestat. 6.000 vetë hynë nëpër ambasadat e huaja në Tiranë, shumë prej tyre me force. Pas shumë hezitimesh e shumë diskutimesh, qeveria shqiptare vendosi të lejonte emigrimin e kësaj mase. Por prapëseprapë ishte e rrezikshme për Feliçitën të fliste hapur rreth udhëtimit në Izrael. Diktatura po jetonte ditët e saj të fundit, ndaj asnjë nuk donte që të sakrifikohej bashkë me te.

Kur Josef Jakoel mori lajmin e mirë nga vajza e tij, ai u nxit që të publikonte një njoftim në një gazetë shqiptare të titulluar: "Asgjë nuk duhet harruar" i cili përshkruante qëndrimin e mrekullueshëm të popullit shqiptar ndaj hebrejve gjatë Luftës së Dytë Botrore. Kjo ishte hera e parë që qeveria lejonte të botohej një artikull i tille. Artikulli bëri një përshtypje të madhe, duke sjellë kujtime dhe duke shkaktuar diskutime të pafund.

Hebrejtë shqiptar dinin shumë pak rreth Izraelit, bile aq më keq, ato që i dinin i kishin mësuar nga shtypi komunist. Për vite të tëra gazetat shqiptare kishin përdorur një gjuhë mohuese dhe fyese ndaj Izraelit. I vetmi burim alternativ që kishin hebrejtë ishin përkthimet e Jakoelit: artikuj, libra, informacione rreth Izraelit të cilat i shpërndante fshehtas.

.....

Feliçita mori me vete libra për emigracionin si dhe shumë spjegime për ata që donin të emigronin në Izrael.

Jakoeli nuk mund të shpallte në shtypin shqiptar ndonjë njoftim ku tu bëhej e ditur të interesuarve për mundësine që u ofrohej për të emigruar në Izrael. Por njoftimet rreth mundesive të tilla u përhapen shumë shpejt gojë më gojë. Jakoelët kontaktuan me hebrejtë në tërë vendin duke perfshirë edhe disa të cilët deri atëhere nuk njiheshin si të tillë. Përpara eksodit, rreth gjysma e hebrejve jetonin në Tiranë dhe gjysma në Vlorë. Kishte tek tuk prej tyre edhe në Shkodër, Fier, Lezhë dhe qytet të tjera të vogla. Përfaqësues të çdo familje hebreje erdhën në Tiranë në shtëpinë e Jakoelëve për të folur rreth emigracionit.

Ishin edhe ca hebrej "te veçuar" qe i vizituan Jakoelët. Pasi e deklaronin veten si hebrej ose "pjesërisht hebrej" ata dëshironin të mësonin për emigracionin. Jakoeli shfaqi një dozë cinizmi ndaj "jo-hebrejve" të cilët donin të emigronin në Izrael.

Ata dinin shumë pak për judaizmin. Mungesa e familjaritetit më gjërat hebreje i vishej politikes anti - fetare të qeverisë. Jakoel dyshonte se mos njerëz jo-hebrej paraqiteshin si të tillë më qëllim që të mund të dilnin nga Shqipëria.

Në Dhjetor të vitit 1990 fillun protestat masive kundër qeverisë të cilat përfunduan me rrëzimin e diktaturës, në fund të janarit dhe në fillim të shkurtit, 1991. Diktatura ra pikërisht në kohën kur grupi i parë i hebrejve emigroi për Izrael. Ky grup arriti pikërisht në ditën e fundit të Luftës së Gjirit, në janar 1991, por shumica arritën në maj të po atij viti. Kushtet politike dhe ekonomike u keqësuan edhe më shumë me mbajtjen e zgjedhjeve shumëpartiake dhe rënjen e diktaturës. Qeveria e re shqiptare nuk pat ndonjë kundërshtim ndaj hebrejve që po emigronin për Izrael. Ndërkohë që kjo u duk edhe në vendosjen e mardhënjeve diplomatike midis dy vendeve. Emigrimi u krye në marrëveshje të plotë me autoritetet shqiptare.

.....

Emigrantet hebrej - shqiptar, ndryshe nga emigrantët tjerë ishin të lumtur pasi kishin ku shkonin. Kostoja e vajtjes në Izrael paguhej prej agjensishë të ndryshme të qeverise izraelite dhe prej disa organizatash hebreje. Njëherësh me ta, gjashtë mijë shqiptarë që kishin emigruar, ishin në kërkim të vendeve të huaja ku u vendosen perfundimisht.

Jakoel vlerson se të paktën 10 % e këtyre emigrantëve nuk ishin hebrej por të martuar me bashkëshortë hebrej. Sipas një zëdhënësi për agjensite hebreje,

"bashkëshortët, fëmijet dhe nipërit e hebrejve shqiptar, mund të kërkonin shtetësine izraelite dhe të gëzonin të njejtat të drejta si dhe vetë hebrejt."

Hebrejt shqiptar të cilët shkuan në Izrael u trajtuan sipas "ligjit të kthimit" i cili i jep menjëhere shtetsine çdo hebrej i cili dëshiron të vendoset në Izrael. " Une e dua Shqiperine. Ajo është shtëpia ime e dytë" ishte përgjigja e Jakoelit, kur e pyetën për atë vend. Padiskutim, shumica e tyre janë pro-shqiptare por jo të gjithë hebrejtë e rinj mbajnë të njëjtin qëndrim dhe dashuri si ajo e Jakoelit. Ai e kuptonte se kjo pakicë nuk di të bëjë dallimin midis popullit shqiptar dhe ish - qeverisë komuniste shqiptare.

Si të gjithë emigrantët edhe ata shqiptar e kritikojnë Izraelin në pika të tilla si p.sh. ligji për martesen dhe divorcin, por i gëzon fakti që të gjithë izraelitet mund ta kritikojnë hapur qeverinë e tyre pa frikë se mos ndëshkohen prej saj.

Për familjen Jakoel, emigrimi ka qene ëndërr e jetës së tyre. Nuk dihet mirë se sa prej hebrejve shqipëtar ishin sioniste me damkë siç ishte Jakoeli (2) por duket të mos ketë qenë i vetëm. Me ribashkimin e emigrantëve dhe Fisnikëve ai si një gjysh krenar sillej nëpër dhomën ku rrinim duke treguar nipin tek secili. Fjala e vetme që përsëriste e përsëriste pandarë ishte: "Sabra, Sabra" (3) Ai kishte ardhur në vendin e tij në Izrael ndërkohë që lindja e nipit e bënte më të plotë këtë kthim.

.....

*Emigracioni, 199*1

Hebrejte nuk ishin te vetmit qytetarë shqipëtar të cilët kërkonin të shpëtonin nga uria dhe shtypja në vitin 1991. Sipas raporteve të gazetave më shumë se 10.000 shqiptarë ishin grumbulluar në Vlorë dhe në porte të tjera të vendit në një dëshpërim të plotë me synim t'i bashkoheshin ndonjë eksodi nga deti. Ata lakmonin Italine por vetëm disa mijëra prej tyre arritën t'i preknin brigjet e saj.

Shumica e atyre që synonin të emigronin kur arritën në portet e Durrësit e të Vlorës nuk gjetën anije për të hypur në to. Anijet dhe varkat e vogla e kishin marrë rrugën si një flotilje e çrregullt që rrezikonte jetën e çdonjërit prej atyre

që kishin ndërmarrë këtë aventurë. Rreth 600 prej tyre i shpëtoi pa u mbytur një anije peshkimi pak sa larg nga bregdeti i Durrësit.

Qeveria shqiptare i deklaroi portet kryesore të vendit, zona ushtarake si një mënyrë për të treguar se po përpiqej që ta shmangtte eksodin dhe turmat nga portet.

Por edhe në se arrije në Itali prapëseprapë puna nuk merrte fund. Në mars të vitit 1991, qeveria italiane njoftoi se do të kthente në Shqipëri më shumë se 12.000 refugjat shqipëtar të cilët mendonin se kishin arritur vendin e shenjtë. Ky ishte një kontrast i thellë midis asaj që kishin bërë shqiptarët ndaj hebrejve më atë që italianet po bënin ndaj tyre.

Rrjedhojat e të kthyerit mbrapsht në Shqipëri nuk ishin aq të tmerrshme sa të krahasohen me Holokaustin. Por ishte e trishtueshme të shihje se si i mohohej ketij populli një gjë e tillë kur ai kishte qenë aq bujar për t'i dhënë azil një populli aq të persekutuar siç ishin hebrejtë, vetëm një gjeneratë më parë.

Sapo arriti në Izrael, një shqiptar pyeti se në çfarë ore të ditës vinte uji. Duke mos ditur faktin se në Shqipëri uji vinte vetëm me orar, bashkëbiseduesit vendas vonuan më shumë se normalisht për të dhënë përgjigjen e duhur.

Një ngjarje tjeter ndodhi ne një nga restorantet më të mira të Jeruzalemit. Një Fisnik Shqiptar lëshoi thikën dhe pirunin dhe tha: "Unë nuk mund të ha kur e di se sa pak ka për të ngrënë familja ime sonte."

Konditat janë përmirsuar disi në Shqipëri. Uji është ende me orar ndërsa ushqimet të mjaftueshme, por Shqipëria vazhdon të mbajë ende shenjën e padëshirueshme e të qenit vendi më i varfër i Europes.

Hebrejtë e Shqipërisë ishin fatlume. Brenda vendit ata patën me vete një udhëheqës që i inspironte ndërsa nga jashtë agjensi të qeverisë izraelite që bënë aq shumë për ta. Nuk mund të mos vihet re fakti që ndërsa qytetarët e vet nuk i lejonte që të iknin jashtë vendit, qeveria shqiptare i lejoi hebrejtë që të merrnin udhët që dëshironin.

Kjo solli edhe përmirësimin e mardhënjeve midis dy popujve. Eksodi hebrej po bëhej në mirëkuptim të plote me qeverinë shqiptare gjë që kishte shumë rëndësi për arsye se kjo do të thoshte se hebrejtë mund të ktheheshin në Shqipëri për të vizituar familjet dhe miqtë pa patur frikë nga ndonjë lloj persekutimi. 300 hebrejë ishin punë e vogël për qeverinë shqiptare po të kihet parasyshë masa e madhe e refugjatëve që kishin marre rrugët e botës, por nga ana tjetër kjo nuk ishte çështje e vogël për hebrejtë shqiptare.

Agjensia e planifikoi me kujdes lëvizjen e 300 njerëzve të vet duke mënjeanuar publicitetin i cili mund ta shtynte qeverine që ta ndërpriste emigracionin. Hebrejtë shqipëtar erdhën nëpërmjet Italise dhe Greqisë në grupe të vogla në një kohëzgjatje disamujore. Eksodi u përgatit në mënyrë të zgjuar dhe u administrua profesionalisht.

Shqipëria Sot

Shoqata e Miqësisë Izrael - Shqipëri u formua në vitin 1993 me 300 antarë shqipëtar dhe ka për qëllim përmirësimin e mardhënjeve midis dy popujve. Ata kërkojnë që qeveria izraelite tu dërgojë materiale edukative më qëllim që të zevëndësojë përshtypjet e krijuara nga propoganda komuniste anti-izraelite e bërë me vite të tëra.

92

SHOQATA E MIQESISE

IZRAEL - SHQIPERI

I nderuar Zoti Harvey,

Në mbledhjen e fundit, kryetari i shoqatës së miqësisë Shqipëri - Izrael, diskutoi për menyrën se si ju e financuat dhe për pritjen e ngrohtë që i rezervuat grupit të parë të përbërë prej 16 vetësh të cilët e vizituan Izraelin.

Për më shumë se 50 vjetë, rregjimi i kaluar në Shqipëri jo vetëm që nuk lejoi asnjë kontakt me miqtë tanë në Izrael por bëri gjithçka që mundi për ta fyer vendin tuaj. Mbetet detyrë e shoqatës tonë si dhe shumë të tjerëve prej Izraelit dhe Shqipërise që t'ju bëjmë Ju të njohur këtu. Ne duhet të ndërtojmë urën e miqësisë midis dy popujve tane duke e forcuar atë dita dites.

Grupi që erdhi atje pa me syte e tij se çfarë mund të bëjë një popull punëtor e i talentuar si ai i juaji. Ishit ju që e bëtë të mundur vizitën e shqipëtarve duke na dhënë kështu mundësinë që jo vetëm të shohim me sytë tanë arritjet e popullit izraelit por edhe të ndjejmë miqësinë që ata njerëz na ofruan ne. Me këtë rast, kryetari i shoqates iu ka deklaruar ju "President Nderi" të shoqatës tonë çfarë përben një nder të madh për ne.

Në dëshirojmë që miqësia jonë, me sinqeritetin që e karktarezion të rritet çdo ditë për të bërë që dy popujt tanë të ndjehen vërtetë vëllezer.

Duke ju uruar jetë të gjatë e shëndet të plotë, në emër të kryesisë së shoqates si dhe të 16 pjesmarrësve në vizitën që bëmë në Izrael, ju falenderojmë dhe ju dërgojmë të falat tona më të përzemërta duke ju siguruar se keni shumë miq në Shqipëri.

Emri juaj i respektuar do të mbetet përgjithmonë në librin e historisë së shoqatës tonë.

Në emër të kryesisë së

Shoqatës Shqipëri - Izrael

Sekretari Kryetari

Henrik Prendushi Refik Veseli

.....

Koncerti i dhënë për nder të Fisnikëve jo-hebrej, ishte një hap i rëndësishëm ne drejtim të mardhenjeve kulturore midis Shqipërise dhe Izraelit.(4) Ka ende kaq shume për të bërë. Tashmë janë shkëmbyer vizitat e para midis Fisnikëve dhe hebrejve - shqiptar nga të dy vendet. Emigrantët shqiptaro - hebrej janë një urë e rëndësishme lidhëse midis dy vendeve e dy popujve. Le të prosperojnë të dya.

Janë disa probleme të mbetura nga e kaluara të cilat fatmirësisht mund të menjëanohen. Zelli i misionerëve në Shqipëri është i pashembullt dhe ne duhet të shpresojmë se feja do të kthehet (në se është zhdukur ndonjëherë) me qëllim që të trashëgojë tolerancen fetare dhe mirëkuptimin tradicional. Lufta që po afrohet përtej kufirit që njëherë e një kohë quhej Jugosllavi nuk duhet lënë në asnjë mënyrë që të zgjerohet drejt Shqipërisë.

Viti 1992 ishte viti i fundit i diktaturës komuniste, ndërsa vendi shkoi shpejt drejt erës moderne por mbetet përsëri një rrugë e gjatë për tu bërë. Le të shpresojmë se është vetëm çështje kohë derisa Shqipëria të marrë vendin e merituar midis kombeve të zhvilluara.

Shënime:

1.- Jo të gjithë shkuan në Izrael. Rreth 35 prej tyre shkuan në SHBA. Jakoel e spjegon këtë me faktin se ata kishin të afërm në Amerike.

2.- Ata emigruan për të përmirësuar konditat e jetës ose për të shpëtuar nga shtypja. Ishte diçka tërheqëse për disa t'ju jepte fëmijëve një rast më të mirë për të gjetur një bashkëshort hebre.Të jetuarit hapur si hebre inkurajonte edhe të tjerët për të bërë të njejtën gjë.

3.- Fjalë hebreje për kaktusin i cili është i fortë nga jashtë por i butë nga brenda e që përdoret për të përshkruar një hebre të lindur në Izrael.

4.- Koncert përkujtimor i Orkestrës së Kibbutzit, Izrael dhe Korit të Teatrit të Operas e Baletit, Tirarnë.

……

Nje bibliografi e shkurter

Libra:

Amery, Julian, *Sons of the Eagle*; Nje studim mbi luften partizane, 1948, Macmillan, London

Dalven, Rae, *Jews of Ioaninna*, 1990, Cadmus Press, Phila., PA.

Grunbaunn, Irene, *Escape Through the Balkans,* 1996, Universiteti i Nebraskes Linkoln NE.

Hoxha,Enver. *Rreziku Anglo-Amerikan për Shqipërinë.* Kujtime të Luftes Nacional Çlirimtare, 1982, Shtëpia botuese 8 Nëntori, Tiranë.

Kotani, Apostol, *Shqipëria dhe Hebrejte,* 1996, Shqipëri.

Marmullaku, Ramadan, *Shqipëria dhe Shqiptarët, 1975,* Anchor Books, London.

Newbigin, Marion I., *Geographical Aspects of the Balkan Problems*, 1915, Putman,NY

Sarner, Harvey, *The Jews of Albania,* 1992, Brunswick Press.

Shaw Stanford J., *The Jews of the Ottoman Empire and the Turkish Republic,* 1991, NYU Press, NY

Swallow, Charles, *The Sick Man of Europe - Ottoman Empire to Turkish Republic 1789 -1923*. Ernest Benn Ltd. London.

"Symmachos" Greece Fight On, n/d Lindsay Drommond, Ltd. London.

Vickers, Martha, *The Albanians,* 1995, I.B. Taurus London & New York.

Enciklopeditë

Enciklopedia Universiale Hebreje, Vëllimi 12, faqe 157.

Enciklopedia Judaike, Vëllimi 2, faqe 522-3 (Shqipëria) Vellimi 14, f. 231 (Romaniotët)

Artikuj:

Jeta shqiptare, *Hebrejtë në Shqiperi,* Farrel Patrick (1990)

Historia e Hebrejve në Shqipëri e në Ballkan.

Destani, D.B. (botues) *Çështja shqiptare* (1990), Qendra e Bashkësise Shqiptare ne Londer.

95

……

Parathënje, *Albanian Reach Holy Land before "Messiah",* 8 Janar 1993, New York, faqe 1.

Gushhee, David P., *"Përse i ndihmuan hebrejte"*

Puto, Artan, *Hebrejtë në Shqipëri ne prag të Luftes se Dyte Botërore*. 1996

Schwartz Stephen. *Një shënim mbi hebrejtë shqipëtarë të shekullit të XVII* - të. Buletini katolik shqiptar (1994) Vellimi XV - të faqe 154-156, San Francisko. Disa shënime rreth hebrejve shqiptarë., 1991 Vëll. XII - të Shqiptarët e të gjitha besimeve në solidaritet me pakicën hebreje të persekutuar . (1989) Vellimi X - të.

Trix Francis, *Rishfaqja e islamit në Shqipëri,* Janar 1995. East European Quartery XXVII, Nr. 4 faqe 533-547

Young, Antonia. *Deshifrimi i Kanunit, Illyria,* 1 Shtator 1995, f.6

New York Times. *Hebrejtë e lumtur nga "një planet" tjetër i quajtur, Shqipëri* 11 Prill 1991.

Jewish Chronicle, London, 29 Maj 1891 faqe 7; Mars 1894, faqe 9; 29 Janar 1909, faqe 8; 13 Mars 1953, faqe 36; 30 Maj 1958, faqe 1; 11 Gusht 1967, faqe 14; 8 Janar 1973, faqe 23.

Jewish Daily Bulletin; NY Vëllimi XI - të, nr. 2821 faqe 1, 17 Prill 1934. *Shënime të botuara prej Herman Bernshtain,* vazhdimi me 18 Prill faqe 1.

Liria: Harvey Sarner, *Njeriu më i pazakonshëm*, Tetor - Nëntor, 1995, faqe 7;

Koncert përkujtimor kushtuar shpëtimtarëve heroik shqiptar gjatë kohës së Holokaustit. Tetor - Nëntor, 1995, faqe 2.

Të pabotuara:

Letër dhe kujtime nga Johanna Jutta Neumann per Van Kriston e datuar 20 Mars 1995, *"Nje nderim për popullin shqiptar*"

Josef Jakoel, *Hebrejtë e Shqipërise,* (italisht)

Dokumente të qeverisë britanike

Pro File Fo 371/37138

Albania Basic Handbook: Pjesa e I - rë, Para pushtimit, Mars 1943; Pjesa e Dytë, Pas pushtimit, Gusht, 1943, "sekret"

96

.....

FO T O

Istruksione për pozicionet e faljes së muslimanëve.

97

.....

F O T O

Mihal Lakatari dhe Shyqyri Myrto

98

.....

Nje pjesë e Yllit të Davidit e gjetur në pazarin e vjetër të Elbasanit i cili mban emrin "Pazari i Heberejve"

99

.....

F O T O

(Nga e majta në të djathtë) Feliçita Jakoel me babain e saj, Josefin dhe nënën.

100

.....

FOTO

Fisniku Beqir Qoqja duke vizituar Betlehemin

101

.....

F O T O

(Nga e majta në të djathtë) Mihal Lakatari me një pjestar të një familje hebreje nga Jugosllavia të cilin e pat shpëtuar gjatë luftës.

102

.....

FOTO

Motra e Josef Jakoelit, Eftihia Matalia dhe dy femijet e saj të rritur në Shqipëri. Ajo u martua me një hebre - grek me të cilin shkoi në Korfuz. Të gjithë të zhdukur nga Holokausti.

.....

F O T O

Një familje e madhe hebrejsh në Janinë. Vetëm dy vajzat e vogla të ulura në dysheme nga ana e djathtë shpëtuan nga Holokausti. Njëra shpëtoi pasi mundi të futej në Shqipëri.

104

.....

F O T O

Johanna J. Neumann (shih faqen 58) duke qëndruar përpara murit ku gjenden emrat e fisnikëve.

105

.....

F O T O

(Nga e majta në të djathtë) Battino, Zonja Meçaj, autori dhe Zoti Meçaj.

106

.....

Faqja e brendshme e kopertines se pasme

FOTO

Autori ne Kopshtin e Fisnikëve te Yad Vashemit

Harvey Sarner e ka kthyer ne qëllim të jetës së vet nderimin dhe ndihmën ndaj Fisnikëve.

Sarner ka pritur në Izrael si miq te tij 400 Fisnike jo-hebrej bashkë me familjet e tyre, nga 10 vënde të ndryshme të botës me të gjitha nderimet dhe respektin që meritojnë.

* * * * *

Në kopertinën e pasme është fotografia e Fisnikëve Shqiptar dhe pjestarëve të familjeve të tyre të cilët e vizituan Izraelin si miq të ftuar nga Zoti Sarner